# VODAFONE ALBANIA Sh.A.

# OFERTA REFERENCE E INTERKONEKSIONIT (ORI)

*Versioni 3.0*

*(miratuar me Vendim te Keshillit Drejtues te AKEP nr.2179 date 29.10.2012, përditësuar në përputhje me VKD Nr. 5, datë 16.02.2024)*

# I- Permbledhje

a. Në zbatim të Ligjit 9918, Rregullores se Aksesit dhe Interkoneksionit dhe Vendimit te Keshillit Drejtues te AKEP Nr. 5, datë 16.02.2024, qe percakton Vodafone Albania si Sipermarres me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në tregun me shumice te terminimit te thirrjeve ne rrjetin e telefonise se levizshme, Vodafone Albania boton kete Ofertë Referencë të Interkoneksionit (ORI) të Vodafone Albania.

b. ORI percakton kriteret dhe procedurat per rregullimin e marredhenieve te interkoneksionit, perjashto terminimin e thirrjeve hyrese nderkombetare, ndermjet Vodafone Albania si Ofrues i Interkoneksionit dhe Operatorit Perfitues ne lidhje me sherbimet dhe fasilitetet shoqeruese, te interkoneksionit qe lidhet midis Vodafone Albania dhe Operatorit Perfitues.

c. ORI zbatohet per sipermarresit qe operojne ne Republiken e Shqiperise, te cilet jane te autorizuar sipas regjimit te autorizimit te AKEP dhe qe kane te drejte te interkonektohen, ne perputhje me Ligjin 9918, date 19.05.2008, “Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise” (Ligji 9918), Rregulloren per Akses dhe Interkoneksion, Rregulloren per Autorizimin e Pergjithshem dhe cdo akt tjeter rregullator, qe ka lidhje me kete Oferte Reference, ne fuqi te miratuar nga AKEP.

d. Vodafone Albania ofron sherbimet ne piken e interkoneksionit dhe lejon aksesin drejt ketyre sherbimeve dhe Operatori Perfitues, sipas Autorizimit leshuar nga AKEP, perdor sherbimet sipas percaktimeve ne kete ORI.

e. Kjo ORI sherben si baze per Marreveshjen e Interkoneksionit midis Vodafone Albania dhe operatorit perfitues, marreveshje e cila do te perfshije edhe sherbimet e ofruara nga Operatori Perfitues ne perputhje me Rregulloren per Autorizimin e Pergjithshem, se bashku me tarifat perkatese.

f. Vodafone Albania nuk mban pergjegjesi per permbajtjen e trafikut qe percillet nepermjet sherbimeve te tij te interkoneksionit.

g. Marreveshja e Interkoneksionit nuk do te permbaje detyrime shtese per Operatorin Perfitues, detyrime te cilat nuk jane parashikuar ne kete ORI.

h. Vodafone Albania si Ofrues i Interkoneksionit dhe Operatori Perfitues bien dakort qe te perdorin standartet teknike dhe te cilesise te pranuara nga AKEP dhe qe mbeshteten ne rekomandimet e organizatave nderkombetare, ITU, ETSI.

i. Kjo ORI hyn ne fuqi nga data e e miratimit te saj nga Autoriteti i Komunikimeve



C1 Public

Elektronike dhe Postare (AKEP) dhe vazhdon te mbetet ne fuqi deri ne shfuqizimin, ndryshimin apo zevendesimin e saj me ORI e re te miratuar nga ky institucion.

j. Vodafone Albania mund t'a perditesoje kete ORI periodikisht, me qellim marrjen ne konsiderate ndonje ndryshimi te nevojshem qe mund t'i behet kesaj ne zbatim te ndryshimeve te mundshme te legjislacionit dhe akteve rregullatore te AKEP ose ndryshimeve te Sherbimeve te Interkoneksionit te ofruara nga Vodafone Albania sipas kesaj ORI. Keto ndryshime do te hyjne ne fuqi vetem pas miratimit nga AKEP. Keto ndryshime apo perditesime te ORI do te publikohen brenda 1 (nje) jave nga data e miratimit te AKEP.

k. Tarifat e dhena ne kete ORI do te jene te disponueshme per te gjithe operatoret e interkonektuar ne baza jo-diskriminuese. Nese Vodafone bie dakort me marrveshje me nje Operator per tarifa te reja, me te favorshme per operatoret se tarifat e publikuara per çdo lloj sherbimi te perfshire ne kete ORI, atehere keto tarifa te reja do te jene te disponueshme per te gjithe operatoret e tjere te interkonektuar.

l. Vodafone Albania mund te refuzoje dhenien e interkoneksionit/sherbimeve te percaktuara ne kete ORI per nje operator perfitues, vetem per shkaqe qe parashikohen shprehimisht ne Ligjin 9918, "Rregulloren e Aksesit dhe Interkoneksionit", dhe akte te tjera te nxjerra nga AKEP per kete qellim, duke perfshire dhe pamundshmerine teknike apo nevojat per te ruajtur integritetin e rrjetit.

m. Në rast se Vodafone Albania refuzon dhenien e akses interkoneksionit atehere do t'i paraqese Operatorit Perfitues nje arsyetim gjithperfshires te shkaqeve te refuzimit dhe do te specifikoje afatin kohor te sakte, se kur kerkesa e Operatorit Perfitues do te permbushet. Nje kopje e arsyetimit do ti njoftohet AKEP.

n. Kjo ORI mbulon terminimin per thirrjet hyrese kombetare drejt pajtimtareve/abonentet e rrjetit Vodafone Albania, te cilet jane ata abonente qe:

- Kane numer celular qe i perket serive numerike (069 xx xxxx) te alokuar nga AKEP Vodafone Albania, numer i cili nuk eshte portuar ne rrjetin e nje operatori tjeter, ose
- Kane numer qe nuk i perket serive numerike te alokuar nga AKEP Vodafone Albania, por qe eshte portuar ne rrjetin e Vodafone Albania.

o. Kjo ORI nuk mbulon terminimin e thirrjeve hyrese nderkombetare drejt pajtimtareve/abonentet te rrjetit Vodafone Albania. Ky lloj sherbimi, do te trajtohet ne marreveshje te vecanta tregtare mes Vodafone Albania dhe partnereve te saj, rast pas



C1 Public

rasti.Vodafone Albania ka detyrimin te pranoje per teminim vetem thirrje telefonike te destinuara per abonentet/pajtimtaret e Vodafone Albania te cituar me siper. Eshte pergjegjesia e Operatorit Perfitues te rrugezoje thirrjet drejt rrjetit te duhur per numrat e portuar, duke bere analizen e thirrjeve ne perputhje me rregullat e vendosura nga AKEP per portabilitetin e numrave dhe rrugezimin e thirrjeve drejt tyre.



C1 Public

## PERMBAJTJA:


- QELLIMI DHE FUSHA E VEPRIMIT
- KUADRI LIGJOR
- PERKUFIZIMET DHE INTERPRETIMET
- AFATI, HYRJA NE FUQI DHE VLEFSHMERIA
- INTERKONEKTIMI I RRJETEVE
- SHERBIMET E INTERKONEKSIONIT
- TARIFAT PER SHERBIMET E INTERKONEKSIONIT
- KERKESA PER SHERBIM INTERKONEKSIONI
- MATJET E VOLUMIT TE TRAFIKUT
- FATURIMI DHE MENYRA E PAGESES
- PROJEKTIMI DHE PLANIFIKIMI I RRJETIT
- MODIFIKIMI I RRJETIT DHE NDRYSHIMET NE ADMINISTRIMIN E TE DHENAVE
- SIGURIA E PERSONELIT DHE INSTALIMEVE / RUAJTJA E INTEGRITETIT TE RRJETIT
- NUMERACIONI
- IDENTIFIKIMI I NUMRIT THIRRES
- CILESIA E SHERBIMIT
- DHENIA E INFORMACIONIT
- PERDORIMI ABUZIV I MARREVESHJES SE INTERKONEKSIONIT
- ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE
- SHKELJA, PEZULLIMI DHE ZGJIDHJA E MARREVESHJES SE INTERKONEKSIONIT
- GARANCIA BANKARE




C1 Public

- RUAJTJA E KONFIDENCIALITETIT
- TE DREJTAT E PASURISE INTELEKTUALE
- RISHIKIMI I MI
- FORCAT MADHORE
- KUFIZIMI I PERGJEGJESISE
- KALIMI I TE DREJTAVE DHE DETYRIMEVE TEK TE TRETET
- NJOFTIMET
- TERESIA E MARREVESHJES
- HEQJA DORE
- VLEFSHMERIA
- NDRYSHIMET
- MARREDHENIA MES PALEVE
- LIGJI I ZBATUESHEM DHE GJYKATA KOMPETENTE


***ANEKSET:***


ANEKSI 1: PERKUFIZIMET
ANEKSI 2: SHERBIMET DHE TARIFAT E INTERKONEKSIONIT
ANEKSI 3: FATURIMI DHE PAGESA
ANEKSI 4: KARAKTERISTIKA TE PERGJITHSHME TE INTERKONEKSIONIT
ANEKSI 5: PROÇEDURA E PARASHIKIMIT TE KAPACITETIT TE INTERKONEKSIONIT
ANEKSI 6: PROÇEDURA E SHFRYTEZIMIT DHE MIREMBAJTJES SE INTERKONEKSIONIT
ANEKSI 7: GARANCIA BANKARE
ANEKSI 8: PERSONAT E KONTAKTIT
ANEKSI 9: STANDARTET & REKOMANDIMET




C1 Public

## 1. QELLIMI DHE FUSHA E VEPRIMIT

1.1 Ne baze te Vendimit te Keshillit Drejtues te AKEP, Nr. 5, datë 16.02.2024, (ketej e tutje Vendimi 5) Vodafone Albania eshte sipermarres me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në tregun me shumice te terminimit per thirrjet hyrese kombetare dhe ka pergatitur kete Oferte Reference Interkoneksioni (ORI) në zbatim të Ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", Rregullores mbi Aksesin dhe Interkoneksionin dhe detyrimeve te vendimit te AKEP per FNT te Vodafone.

1.2 Qellimi i ORI eshte percaktimi i kritereve dhe procedurave per rregullimin e marredhenieve te interkoneksionit ndermjet Vodafone si Ofrues i Interkoneksionit dhe Operatorit Perfitues ne lidhje me sherbimet dhe fasilitetet shoqeruese, te interkoneksionit qe lidhet midis Vodafone dhe Operatorit Perfitues, per te siguruar zbatimin e detyrimeve te Vodafone ne perputhje me kerkesat dhe percaktimet e parashikuara ne Ligjin 9918, Rregullores per Aksesin dhe Interkoneksionin dhe Vendimin 5.

1.3 Palet bien dakort te interkonektojne rrjetet e tyre ne perputhje me parimet e percaktuara ne Ligjin 9918, Rregulloren e Aksesit dhe Interkoneksionit dhe Vendimin 5 dhe t'u sigurojne njera-tjetres sherbimet dhe facilitet sipas kushteve te paracaktuara ne kete ORI si dhe Marreveshjen e Interkoneksioni (ketej e tutje "MI")

1.4 Vodafone dhe Operatori Perfitues bien dakort qe te perdorin standartet teknike dhe te cilesise te mbeshtetura ne Rregulloret e AKEP dhe rekomandimet e organizatave nderkombetare si ITU apo ETSI.

1.5 Vodafone mund te refuzoje dhenien e interkoneksionit/sherbimeve te percaktuara ne kete ORI per nje Operator Perfitues, vetem per shkaqe qe parashikohen shprehimisht ne Ligjin 9918, "Rregulloren e Aksesit dhe Interkoneksionit", dhe akte te tjera te nxjerra nga AKEP per kete qellim, duke perfshire dhe pamundshmerine teknike apo nevojat per te ruajtur integritetin e rrjetit.

1.6 Në rast se Vodafone refuzon dhenien e akses interkoneksionit atehere do t'i paraqese Operatorit Perfitues nje arsyetim gjithperfshires te shkaqeve te refuzimit dhe do te specifikoje afatin kohor te sakte, se kur kerkesa e Operatorit Perfitues do te permbushet. Nje kopje e arsyetimit do te depozitohet AKEP.

## 2. KUADRI LIGJOR

Dispozitat e kësaj ORI janë hartuar në përputhje me:

2.1. Ligjin Nr.9918 datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë" (ketej e tutje "Ligji 9918"*);*

2.2. Rregulloret e nxjerra nga AKEP ne zbatim te ketij ligji, akteve te tjera ligjore e nenligjore ne fuqi te cilat jane te detyrueshme per t'u zbatuar si dhe cdo Vendim tjeter i nxjerre nga AKEP me ndikim ne kete ORI

2.3. Vendimin e Keshillit Drejtues te AKEP, Nr. 5, datë 16.02.2024, qe ka percaktuar Vodafone sipermarres me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) dhe masat rregulluese per kete status në tregun me shumice te terminimit te thirrjeve kombetare ne rrjetin Vodafone dhe cdo akt tjeter te nxjerre nga AKEP qe synon ndryshimin, plotesimin apo shfuqizimin e tij.

## 3. PERKUFIZIMET DHE INTERPRETIMET

3.1 Ne kete ORI, perveç rasteve kur konteksi e kerkon ndryshe, fjalet dhe shprehjet kane kuptimin e percaktuar ne Aneksin 1 (Perkufizimet) ose Aneksin II sherbimet.

3.2 Referencat qe i behet akteve ligjore dhe nenligjore i referohen ketij legjislacioni si dhe cdo amendimi te mundshem, apo akteve nenligjore te dala ne plotesim te ketij legjislacioni.

3.3 Termat e percaktuara ne aktet ligjore dhe nenligjore shqiptare, nese jane perdorur ne kete ORI do te kene te njejtin kuptim sipas atyre akteve.

3.4 Pa cenuar te drejtat e Vodafone Albania, ne rast te nje mosmarreveshje apo paqartesie mes termave te percaktuara ne ligjet dhe rregulloret e zbatueshme ne lidhje me kete ORI, do te zbatohet rendi i meposhtem i perparesise:

- Ligji i Komunikimeve Elektronike ne Republiken e Shqiperise
- Rregullorja per Aksesin dhe Interkoneksionin, si dhe
- Cdo rregullore apo Vendim tjeter i nxjerre nga AKEP me ndikim ne kete ORI

## 4. AFATI, HYRJA NE FUQI DHE VLEFSHMERIA

Marreveshja e interkoneksionit e lidhur ne zbatim te kesaj ORI, fillon efektet nga data e percaktuar ne te dhe do te vazhdoje deri:

1. Ne kohen qe Operatorit Perfitues i mbaron afati i autorizimit, i revokohet autorizimi dhe Operatori nuk ka marre autorizim tjeter zevendesues per ofrimin e rrjetit dhe ose sherbimeve te komunikimeve elektronike per ofrimin e rrjetit ose sherbimeve te komunikimeve elektronike;

2. Ne kohen qe Vodafone Albania i mbaron afati i autorizimit, i revokohet autorizimi dhe Vodafone Albania nuk ka marre autorizim tjeter zevendesues per ofrimin e rrjetit dhe/ose sherbimeve te komunikimeve elektronike per ofrimin e rrjetit ose sherbimeve te komunikimeve elektronike;

3. Zgjidhjen e marreveshjes sipas percaktimeve te kesaj RIO dhe MI e lidhur mes paleve,

perfshire midis te tjerave, mos-ndryshimin, mos-plotesimin apo mos-rinovimin e Garancise Bankare sipas percaktimeve ne nenet 20 dhe 21;

## 5. INTERKONEKTIMI I RRJETEVE

5.1 Interkoneksioni per sherbimin e thirrjeve ndermjet rrjetit te Vodafone Albania dhe Operatorit Perfitues do te realizohet nepermjet nje ose disa pikave te interkoneksionit per te cilat do te bihet dakord mes paleve. Cdo pike interkoneksioni do te identifikoje nje lidhje mes nje nyje transmetimi te Vodafone Albania dhe nje nyje transmetimi te Operatorit Perfitues. Detajet perkatese te realizimit pershkruhen ne Aneksin IV (Karakteristikat e Pergjithshme te Interkoneksionit)

5.2 Pika reale e Interkoneksionit duhet te jete aty ku Rrjeti i Vodafone lidhet me Rrjetin e Operatorit Perfitues dhe duhet te jete nje pike fizike ku lidhja te mund te shkeputet ne menyre qe te kryhen teste.

5.3 Aspektet teknike te lidhjes se interkoneksionit dhe ato funksionale jane te percaktuara ne Aneksin IV (Karakteristika te Pergjithshme te Interkoneksionit) te kesaj ORI

5.4 Vodafone dhe Operatori Perfitues do te jene pergjegjes per sigurimin e nje kapaciteti te mjaftueshem ne Piken e Interkoneksionit ne menyre qe te perballoje trafikun e parashikuar te rene dakord dhe qe permban Planifikimi i Rrjetit, siç pershkruhet ne Aneksin VI (Procedura e parashikimit te kapacitetit te interkoneksionit).

## 6. SHERBIMET E INTERKONEKSIONIT

6.1 Sherbimet e interkoneksionit qe palet ofrojne jane te percaktuara ne Aneksin II (Sherbimet dhe tarifat e Interkoneksionit) te Marreveshjes se Interkoneksionit

6.2 Palet bien dakord qe sherbimet e interkoneksionit te perfshira ne Aneksin II dhe qe jane objekt i rregullimit prej AKEP, te mos i ofrohen me kushte me te favorshme se ato te pershkruara ne kete ORI, rrjetit apo filialit te nje pale te trete te kontraktuar.

6.3 Afatet kohore per kryerjen e sherbimeve dhe standartet e cilesise se ketyre sherbimeve percaktohen ne Marreveshjen e Nivelit te Sherbimit (SLA), bashkengjitur Marreveshjes se Interkoneksionit

## 7. TARIFAT PER SHERBIMET E INTERKONEKSIONIT

7.1 Struktura e tarifimit dhe tarifat per çdo Sherbim Interkoneksioni pershkruhet ne Aneksin II (Sherbimet dhe Tarifat e Interkoneksionit) dhe Aneksin III (Faturimi dhe Pagesat) te kesaj ORI.



C1 Public

7.2 Tarifat e Sherbimeve te Interkoneksionit mund te ndryshohen ne perputhje me parashikimet e Ligjit nr 9918 dhe kuadrin rregullator perkates. Per tarifat e publikuara ne kete ORI dhe qe nuk jane objekt rregullimi nga AKEP, Vodafone Albania ka te drejte t'i ndryshoje duke bere publikimin ne ORI dhe njoftuar Operatorin Perfitues dhe AKEP te pakten 3 muaj para hyrjes ne fuqi te tarifes se re.

7.3 Koha e tarifueshme per çdo thirrje, perveçse kur specifikohet ndryshe, do te jete "Koha e Bisedes" ne perputhje me rekomandimin D.150 te ITU-T, i ndryshuar ne 1996, pra intervali kohor mes marrjes se nje sinjali pergjigje dhe marrjes se sinjalit perkates te leshimit, e matur nga Pala qe ofron te dhenat per tarifimin e interkoneksionit.

7.4 Asnje prej paleve nuk do aplikoje tarifim per percjelljen e thirrjes nese thirrja nuk eshte lidhur, kur ka:

1. ton "zile" pa pergjigje;
2. ton "i zene";
3. ton "numer i padisponueshem"
4. "Njoftim i rregjistruar informacion rrjeti"

Per te shmangur cdo dyshim, sistemet voice mail (poste zanore) te klientit apo rrjetit nuk konsiderohen "Njoftim i rregjistruar informacion rrjeti".

## 8. KERKESA PER SHERBIM INTERKONEKSIONI

8.1 Per lidhjen e marreveshjes se interkoneksionit Operatori Perfitues i ben nje kerkese Vodafone Albania sipas parashikimeve ne Ligjin 9918 dhe Rregulloren e Aksesit dhe Interkoneksionit. Nje kopje e kerkeses depozitohet ne AKEP.

8.2 Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues do te zbatojne parashikimet e Ligjit 9918 dhe Rregullores se Aksesit dhe Interkoneksionit ne lidhje me proceduren e negociatave, afatet dhe lidhjen e marreveshjes se interkoneksionit.

8.3 Vodafone Albania, nepermjet kesaj ORI, e cila gjendet e publikuar ne faqen zyrtare te Vodafone Albania, vendos ne dispozicion te Operatorit Perfitues, Informacionin e Pergjithshem te rrjetit qe operon si dhe informacionin lidhur me sherbimet e pershkruara ne kete ORI.

8.4 Operatori Perfitues, se bashku me kerkesen per interkoneksion, duhet t'i paraqese Vodafone Albania informacionin e nevojshem per te mundesuar vendosjen e zgjidhjes per anen teknike dhe ate komerciale se akses/interkoneksionit, si dhe dokumentacionin ligjor shoqerues te Operatorit Perfitues. Informacioni i lartpermendur eshte ne zbatim te Rregullores "Per akses dhe interkoneksion" dhe detajohet ne Aneksin IV (Karakteristika te Pergjithshme te Interkoneksionit). Informacioni i nevojshem per te mundesuar vendosjen e zgjidhjes teknike te akses/interkoneksionit eshte i domosdoshem qe Vodafone Albania te projektoje nje zgjidhje optimale interkoneksioni.



C1 Public

8.5 Ne rast se teresia e dokumentacionit te mesiperm eshte jo e plote dhe i pamjaftueshem, Vodafone Albania do te lajmeroje Operatorin Perfitues brenda 10 (dhjete) diteve nga data e marrjes se dokumentacionit. Lajmerimi duhet te permbaje nje liste te detajuar pyetjesh dhe kerkesash mbi te dhenat qe nuk jane siguruar ne dokumentacionin e paraqitur nga Operatori Perfitues.

8.6 Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues duhet te negociojne me mirekuptim me synimin per te arritur nje marreveshje mbi nje Planifikim Rrjeti te plote. Pasi palet te kene rene dakort per zgjidhjen teknike, kjo zgjidhje do te behet e ditur si Planifikim i Rrjetit dhe do te perfshihet ne Marreveshjen e propozuar te Interkoneksionit mes Vodafone Albania dhe Operatorit Perfitues.

## 9. MATJET E VOLUMIT TE TRAFIKUT

9.1 Pergjegjesia per matjet e volumit te trafikut do te jete e pales qe ben faturimin per ate sherbim te veçante Interkoneksioni.

9.2 Palet do te sigurohen qe te regjistrohet matja e volumit te trafikut ne detaje te mjaftueshme per te permbushur detyrimet siç jane dhene ne Aneksin II (Sherbimet dhe Tarifat e interkoneksionit) dhe Aneksin III (Faturime dhe Pagesa)

## 10. FATURIMI DHE MENYRA E PAGESES

10.1 Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues do te faturojne dhe rimbursojne njeri-tjetrin ne perputhje me tarifat dhe proçedurat e dhena ne Aneksin II (Sherbimet dhe Tarifat e Interkoneksionit) dhe Aneksin III (Faturimi dhe Pagesat).

10.2 Tarifat do te jene te pagueshme nga njera pale tjetres, vetem nese keto sherbimet me tarifat perkatese ne fjale jane te parashikuara shprehimisht ne Marreveshjen e Interkoneksionit bazuar ne kete ORI, si dhe ne rastin kur tarifa perkatese eshte vendosur me nje Vendim te AKEP.

10.3 Tarifat ne Marreveshjen e Interkoneksionit bazuar ne kete ORI nuk perfshijne TVSH. TVSH do te tarifohet ne faturat qe leshohen ne zbatim te kesaj ORI ne perputhje me Ligjin per TVSH ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

10.4 Faturat jane te pagueshme ne Leke dhe sipas menyres se percaktuar nga palet ne Marreveshjen e Interkoneksionit, ne perputhje me legjislacionin shqiptar per kete qellim. Ato do te datohen si per daten e leshimit te fatures (Daten e leshimit) dhe jane te pagueshme ne ose perpara Dates perkatese per pagese, e cila eshte tridhjete (30) Dite Kalendarike nga Data e Leshimit.

10.5 Secila pale do t’i siguroje dhe dergoje pales tjeter faturat me te gjithe shumat per te cilat ai i detyrohet, te llogaritura ne perputhje me dispozitat e Aneksit III (Faturimi dhe Pagesat).



C1 Public

## 11. PROJEKTIMI DHE PLANIFIKIMI I RRJETIT

11.1 Projektimi dhe planifikimi i interkoneksionit duhet te jete ne perputhje me Planifikimin e Rrjetit te rene dakord mes Vodafone Albania dhe Operatorit Perfitues. Planifikimi i Rrjetit do te jete i vlefshem per (2) vjet rradhazi dhe duhet te pergatitet nga te dyja Palet bashkarisht.

11.2 Planifikimi i Rrjetit duhet te rishikohet dhe te azhornohet nga Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues ne nje interval kohor te rene dakord nga perfaqesuesit teknike dhe komerciale te te dyja Paleve.

11.3 Perveç pergatitjes se Planifikimit te Rrjetit, Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues duhet te hartojne parashikimet per Lidhjet e Interkoneksionit. Proçedurat e Parashikimit te Nyjeve te Interkoneksionit jane pershkruar ne Aneksin VI (Kapaciteti dhe procedurat e parashikimit te kapacitetit te interkoneksionit) te kesaj ORI. Parashikimi i rene dakord mes Paleve do te konsiderohet si pjese e Planifikimit te Rrjetit.

11.4 Parashikimet e dhena nga Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues perfaqesojne pritshmerite ne mirebesim te seciles prej paleve ne lidhje me kerkesat per kapacitetin e Lidhjeve te Interkoneksionit.

11.5 Si Vodafone Albania, ashtu dhe Operatori Perfitues, gezojne te drejten qe te shlyhen nga njeri-tjetri per çfaredolloj kosto te pashmangshme qe ka ardhur si rezultat i ndonje mosperdorimi ne kapacitetin e porositur, ne perputhje me proçedurat e parashikimit te percaktuara ne Aneksin VI (Kapaciteti dhe procedurat e parashikimit te kapacitetit te interkoneksionit).

## 12. MODIFIKIMI I RRJETIT DHE NDRYSHIMET NE ADMINISTRIMIN E TE



C1 Public

**DHENAVE**




Diagrama e Procedures per Ndryshimin e Rrjetit

12.1 Secila pale mund te kerkoje Ndryshim te Rrjetit, duke derguar njoftim te pala tjeter te pakten tre (3) muaj kalendarike para dates se planifikuar per fillimin e implementimit te



C1 Public

ndryshimit te propozuar. Vodafone Albania, nese ndodhet ne poziten per te pranuar Ndryshimin e propozuar te Rrjetit, do te jape nje vleresim te kostove te perfshira ne ndryshim brenda nje (1) nje Muaji Kalendarik nga marrja e kerkeses per Ndryshim Rrjeti.

12.2 Operatori Perfitues, *perveç rastit kur Modifikimi i Rrjetit eshte miratuar ose kur eshte pjese e nje programi permiresimi te planifikuar*, do te paguaje shpenzimet e Vodafone Albania, ne ato raste kur ndryshimet detyrojne Vodafone Albania te ndryshoje sistemin e tij ne menyre qe te percjelle thirrjet. Ne ato raste kur Modifikimi i Rrjetit miratohet bashkarisht dhe eshte ne te mire dhe perfitim te te dy paleve, apo kur ka nje perfitim financiar qe mblidhet ne interes te Vodafone Albania, Modifikimi i Rrjetit do te kryhet duke u bazuar ne ndarjen e kostove te ngarkuara..

12.3 Ndryshimet e Rrjetit do te kryhen brenda shkalles kohore te paraqitur ketu ne Nenin 12. Nese Vodafone Albania nuk mendon se ndodhet ne poziten per te proçeduar me Ndryshimin e Rrjetit, qofte permes shkalles kohore se kerkuar apo ne çfaredo rrethane tjeter, do te njoftoje Operatorin Perfitues brenda dy (2) javesh nga marrja e kerkeses. Ne keto rrethana Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues do bejne gjithe perpjekjet e mundshme dhe te arsyeshme per te zgjidhur situaten, duke perfshire dhe adresimin e çeshtjes ne proçesin e zgjidhjes se mosmarreveshjeve sipas nenit 19 (Zgjidhja e Mosmarreveshjeve).

12.4 Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues do te perpiqen te minimizojne numrin e Ndryshimit te Menaxhimit te te Dhenave ne Rrjetin e njeri-tjetrit.

12.5 Ne menyre qe te sigurohet implementimi ne kohe i Ndryshimeve te Menaxhimit te te Dhenave, njoftimi per Ndryshimin e Menaxhimit te te Dhenave duhet te jepet nga Operatori Perfitues qe kerkon ndryshimin te pakten dy (2) Muaj Kalendarik para dates se kerkuar te implementimit.

12.6 Ndryshimet e Menaxhimit te te Dhenave do te kryhen brenda shkalles kohore te parashtruar ne kete Nen 12. Nese Vodafone Albania nuk mendon se eshte ne poziten per te proçeduar me Ndryshimin e Rrjetit, qofte permes shkalles kohore se kerkuar apo ne çfaredo rrethane tjeter, do te njoftoje Operatorin Perfitues brenda dy (2) javesh nga marrja e kerkeses. Ne keto rrethana Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues do bejne gjithe perpjekjet e mundshme te arsyeshme per te zgjidhur situaten, perfshi edhe adresimin e çeshtjes ne proçesin e zgjidhjes se mosmarreveshjeve sipas nenit 19 (Zgjidhja e Mosmarreveshjeve).

12.7 Ndryshimet e Menaxhimit te te Dhenave qe kerkojne aktivizimin e ri gjeografik apo te Serite Numerike te klientit, te shperndare ose ndryshuar nga AKEP, do te kryhet pa pagese.

12.8 Ne lidhje me kerkesat e tjera te Ndryshimeve te Menaxhimit te te Dhenave, kur miratohen bashkarisht dhe eshte ne interesin e perbashket te paleve, ose kur ka nje perfitim financiar qe mblidhet ne interes te Vodafone Albania, Ndryshimet e Menaxhimit te te Dhenave do te kryhen duke u bazuar ne ndarjen e kostove te ngarkuara.

## 13. SIGURIA E PERSONELIT DHE INSTALIMEVE / RUAJTJA E INTEGRITETIT TE RRJETIT



C1 Public

13.1 Secila Pale ne kuadrin e interkoneksionit mes rrjetit te saj dhe rrjetit te Pales tjeter, duhet te garantoje dhe te mbroje, duke marra masa praktike, integritetin e rrjetit te vet, ne menyre qe te ofroje funksionimin e pacenuar te rrjeteve te nderlidhura. Asnje nga Palet nuk do te kryeje, ose lejoje te kryhet, asgje qe mund te demtoje apo te ndikoje ne menyre te demshme rrjetin e vet.

13.2 Secila Pale do te garantoje funksionimin e sigurt te rrjetit te saj dhe do te ndermarre çdo mase te nevojshme dhe te arsyeshme per zbatimin e Interkoneksionit sipas kesaj ORI, ne menyre qe te siguroje se rrjeti:

a. Nuk perben asnje rrezik per sigurine e shendetit te personelit dhe klienteve te vet apo te Pales tjeter, dhe
b. Nuk sjell demtime, interferenca apo defekte ne funksionimin e rrjetit te Pales tjeter.

13.3 Asnje nga palet nuk do te lidhe apo do te lejoje me dijeni interkonektimin ne rrjetin e tij te ndonje pajisje, aparati, perfshire por jo vetem, me ndonje pajisje terminimi qe nuk eshte aprovuar, ne perputhje kjo me Ligjin 9918, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.331, datë 14.4.2011 “Per miratimin e Rregullit Teknik “Per kerkesat thelbesore dhe vleresimin e konformitetit te pajisjeve radio dhe fundore te telekomunikacioneve’ dhe aktet e tjera nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij dhe Rregulloren nr.48 date 22.04.2020 ‘Per zbatimin e rregullit teknik per pajisjet radio” miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 7, datë 22.04.2020.

13.4 Çeshtjet lidhur me mbrojtjen e interkoneksionit te nevojshem dhe instalimit te duhur nga fatkeqesi, katastrofa apo defekte do te trajtohen ne perputhje me rekomandimet perkatese nderkombetare te ITU-T dhe ETSI.

## 14. NUMERACIONI

14.1 Secili Operator i Autorizuar duhet te perdore per abonentet e rrjetit te tij serite numerike qe i jane caktuar ne perputhje me Planin Kombetar te Numeracionit te administruar nga AKEP.

14.2 Te dyja Palet jane te detyruara te respektojne dispozitat mbi Numeracionin dhe CLI, te cilat jane te percaktuara ne Aneksin V (Numeracioni dhe CLI)

## 15. IDENTIFIKIMI I NUMRIT THIRRES

15.1 Shfaqja e identitetit te numrit thirres (CLI) duhet te perputhet me te gjitha kerkesat e Ligjit 9918 dhe Rregullores per Aksesin dhe Interkoneksionin.

15.2 Ne momentin kur njera Pale percjell thirrjet ne rrjetin e Pales tjeter, eshte e detyruar te transmetoje Identitetin e Numrit Thirres, pa e ndryshuar ose fshehur ate, duke perdorur protokollin e sinjalizimit CCS Nr.7.



C1 Public

15.3 Te dyja palet jane te detyruara te respektojne dispozitat mbi identitetin e numrit thirres (CLI), sic jane specifikuar ne Aneksin V (Numeracioni dhe CLI)

## 16. CILESIA E SHERBIMIT

16.1 Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues kane detyrimin qe te kujdesen qe sherbimet e interkoneksionit te funksionojne ne perputhje me nenin 102 te Ligjit 9918, dhe aktet e tjera nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij; standartet e pranuara, siç percaktohet nga treguesit e Cilesise se Sherbimit te percaktuar ne seksionet 5, 6 dhe 7 te dokumentit te ETSI TR 101 949 V1.1.1 (2002-07) publikuar ne gjuhen shqipe ne faqen e internetit te AKEP dhe te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga Rregullorja ‘Per Treguesit e Cilesise se Sherbimit’, miratuar me Vendim te AKEP Nr.1256, date 16.04.2010.

16.2 Niveli i Cilesise se Sherbimit, afatet per mirembajtjen dhe shfrytezimin, treguesit dhe standartet e cilesise se sherbimit percaktohen ne Marreveshjen e Nivelit te Sherbimit qe nenshkruhet nga Palet ne momentin e nenshkrimit te Marreveshjes se Interkoneksionit, bazuar ne kete ORI.

## 17. DHENIA E INFORMACIONIT

17.1 Ne perputhje dhe me nenin 22 (Ruajtja e konfidencialitetit) te Marreveshjes se Interkoneksionit bazuar ne kete ORI, njera pale mund ti kerkoje pales tjeter informacion mbi protokollet ne perdorim nga pala tjeter, informacion i cili eshte i nevojshem per interkoneksion, percjellje thirrjesh apo sigurimin e sherbimeve te pershkruara ne marreveshjen e interkoneksionit bazuar ne kete ORI, gjithmone nese pala tjeter ka informacion te nevojshem dhe nese sigurimi i ketij informacioni eshte i domosdoshem si pasoje e mungeses dhe/ose pamjaftueshmerise te standarteve nderkombetare apo atyre te miratuara nga AKEP.

17.2 Pavaresisht detyrimeve qe rrjedhin nga marreveshja e interkoneksionit bazuar ne kete ORI, asnje nga palet nuk do jete e detyruar te siguroje informacion i cili eshte subjekt konfidencialiteti i detyrimeve ndaj nje pale te trete, pervecse kur kjo e fundit ka dhene miratimin per nje gje te tille.

17.3 Pala dhenese e informacionit do te beje te gjithe perpjekjet e arsyeshme qe te sigurohet se informacioni i dhene eshte me i sakti i mundshem sipas njohurive te saj, ne momentin e dhenies se tij.

17.4 Nese pala dhenese i jep informacion pales marrese, atehere pala dhenese do te marre paraprakisht te gjithe miratimet e nevojshme nga palet e treta.

17.5 Pala marrese e informacionit do te demshperbleje palen dhenese dhe do te garantoje demshperblimin kundrejt te gjithe pergjegjesive, padive, kerkesave, demeve te pretenduara, kostove apo shpenzimeve qe kane lindur si pasoje e deshtimit nga ana e pales marrese per te vepruar ne perputhshmeri me keto kushte, perfshire ato te permendura ne nenin 22 (Ruajtja e konfidencialitetit) te Marreveshjes se Interkoneksionit, nga pala dhenese apo nga ndonje pale e trete ne momentin qe informacioni eshte dhene.



C1 Public

17.6 Per te shmangur cdo dyshim, asgje ne marreveshjen e interkoneksionit bazuar ne kete ORI, nuk do te detyroje ndonje nga palet qe te veproje ne kundershtim me detyrimet kontraktuale te konfidencialitetit.

## 18. PERDORIMI ABUZIV I MARREVESHJES SE INTERKONEKSIONIT

18.1 Lidhjet e Interkoneksionit bazuar ne kete ORI, do te perdoren nga secila Pale eksluzivisht, sic eshte rene dakord paraprakisht, per sherbimet dhe menyren operative te tyre, sic jane parashikuar ne kete ORI.

18.2 Palet bien dakort qe te bejne te gjitha perpjekjet e nevojshme per zbulimin, identifikimin dhe eliminimin e çdo rritjeje artificiale te trafikut per shkak te ndonje veprimi abuziv nga pale te treta dhe per shkembimin e informacionit ne lidhje me bashkepunimin brenda masave te caktuara per parandalimin e shfaqjes se abuzimeve te tilla ne rrjetet perkatese te Paleve dhe eliminimin e tyre.

18.3 Shkelja e dispozitave te percaktuara ne pikat 18.1 dhe 18.2 te ketij neni konsiderohet si perdorim abuziv.

18.4 Me kerkese te Pales se cenuar qe identifikon nje ose me shume situata perdorimi abuziv, Pala tjeter eshte e detyruar te korrigjoje situaten dhe te jape nje pergjigje brenda nje afati 10-ditor nga marrja e pretendimit. Nese abuzimi vazhdon, Pala e cenuar do te ndjeke te gjithe procedurat per zgjidhjen e mosmarreveshjes sipas parashikimeve te Rregullores se Akses Interkoneksionit dhe nenit 19 (Zgjidhja e mosmarreveshjeve) te Marreveshjes se Interkoneksionit bazuar ne kete ORI.

## 19. ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

19.1 Dispozitat e ketij neni jane te zbatueshme ne rast te mosmarreveshjeve qe lindin mes Operatorit Perfitues dhe Vodafone Albania ne lidhje me, ose per shkak te Marreveshjes se Interkoneksionit, perfshire ketu lidhjen, implementimin, zbatimin, interpretimin, amendimin, perfundimin dhe zgjidhjen e Marreveshjes se Interkoneksionit, me perjashtim te ceshtjeve qe lidhen me faturimin dhe pagesat dhe CLI, te cilat trajtohen sipas Aneksit IV (Faturimi dhe Pagesat) dhe nenit 20 me poshte. Palet duhet te perpiqen te arrijne zgjidhjen e Mosmarreveshjes me mirekuptim mes tyre brenda nje periudhe prej 10 (dhjete) ditesh, pervec se kur palet kane rene dakord per nje afat ndryshe, nga marrja e njoftimit me shkrim per Mosmarreveshjen, i cili dergohet nga pala jo ne shkelje tek pala tjeter.

19.2 Ne rast te nje mosmarreveshje qe lind mes Operatorit Perfitues dhe Vodafone Albania ne lidhje me aksesin dhe interkoneksionin, si dhe me perdorimin e perbashket te faciliteteve dhe aseteve ndermjet sipermarresve, palet do te zbatojne dispozitat e ‘Rregullores per procedurat e zgjidhjes se mosmarreveshjeve’ miratuar me VKD te AKEP nr 1296 date 11.06.2010

19.3 Ne rast te nje mosmarreveshje qe lind mes Operatorit perfitues dhe Vodafone Albania ne



C1 Public

lidhje me modifikimin apo fshehjen e CLI te thirrjeve, palet do te zbatojne dispozitat e parashikuara ne Rregulloren per Akses dhe Interkoneksionin, perkatesisht neni 5 (i ndryshuar)

19.4 Per cdo rast tjeter ne lidhje me ose per shkak te Marreveshjes se Interkoneksionit, perjashto cfare parashikohet ne pikat 19.2 dhe 19.3, palet do t'i drejtohen AKEP per zgjidhjen e ceshtjes ne perputhje me nenin 120 te Ligjit Nr. 9918, Ligjin Nr. 8485, date 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative" si dhe aktet nenligjore ne zbatim te tyre

19.5 Pavaresisht procedurave per zgjidhje te mosmarreveshje te parashikuara ne kete ORI apo te rena dakort ne marreveshjen e interkoneksionit te lidhur midis paleve, secila nga palet ka te drejte qe ne cdo kohe t'ia adresoje çeshtjen AKEP per zgjidhje, ne perputhje me nenin 120 te Ligjit Nr.9918.

19.6 Secila nga palet ka te drejte t'i drejtohet per zgjidhje organeve gjyqesore perkatese pasi te jete ezauruar rekursi administrativ, perveç rasteve kur objekti i mosmarreveshjes lidhet me pagesat e percaktuara ne RIO dhe MI. Ne rast mosmarreveshje per çeshtje te pagesave te percaktuara ne kete RIO dhe MI e lidhur midis paleve, palet bejne perpjekje per zgjidhjen e tyre ne mirekuptim, ose mund te perdorin te drejtat e tyre per zgjidhje nepermjet arbitrazhit, ndermjetesimit ose shqyrtimit gjyqesor te saj, sipas zgjedhjes se seciles pale. Gjykata kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve eshte ajo e percaktuar ne dispozitat perkatese te Kodit te Procedures Civile te Republikes se Shqiperise.

## 20. SHKELJA, PEZULLIMI DHE ZGJIDHJA E MARREVESHJES SE INTERKONEKSIONIT

20.1 Ne rast se rrjeti i njeres Pale ndikon negativisht ne funksionimin normal te rrjetit te Pales tjeter, ose paraqet rrezik per sigurine e ndonje personi, Pala tjeter mund te pezulloje, ne masen qe gjykohet e nevojshme, detyrimet e saj te lindura nga Marreveshja e Interkoneksionit e lidhur ne baze te kesaj ORI, per ate periudhe kohe qe mendohet e arsyeshme per te siguruar funksionimin normal te sistemeve te saj ose per te ulur shkallen e rrezikut ndaj sigurise. Ne cdo rast, pala qe ndermerr masen e pezullimit njofton me shkrim edhe AKEP.

20.2 Nese nje Pale ka kryer shkelje te Marreveshjes se Interkoneksionit te lidhur ne baze te kesaj ORI, pervec rasteve te parashikuara ne pikat 20.11 deri 20.14, Pala jo ne shkelje mund t'i dergoje nje njoftim me shkrim Pales tjeter qe ka kryer shkeljen (Njoftimin per Shkelje) duke specifikuar shkeljen dhe duke kerkuar qe ajo te korrigjohet brenda:

20.2.1 Dhjete (10) ditesh nga dita e marrjes se njoftimit per shkelje. Perjashtim ben rasti kur shkelja ka te beje me modifikimin dhe/ose fshehjen e CLI te thirrjeve, rast ne te cilin palet do te zbatojne percaktimet e Rregullores per Akses dhe Interkoneksion dhe Aneksin V (Numeracioni dhe CLI) te kesaj ORI.

20.2.2 Ne raste emergjente, pervec detyrimeve financiare, brenda nje periudhe me te shkurter se 10 (dhjete) dite te cilen Pala jo ne shkelje do t'a percaktoje ne menyre te arsyeshme.

20.3 Nese Pala qe ka kryer shkeljen nuk arrin t'a korrigjoje kete shkelje brenda periudhes se percaktuar ne paragrafin 20.2, Pales tjeter i lind e drejta qe, derisa shkelja te jete korrigjuar, te pezulloje kryerjen e detyrimeve te saj, perfshire ofrimin e sherbimeve te interkoneksionit, te lindura nga Marreveshja e Interkoneksionit bazuar ne kete ORI, ne masen qe konsiderohet e arsyeshme ne rrethana te tilla.

20.4 Nese Pala qe ka kryer shkeljen nuk arrin t'a korrigjoje kete shkelje brenda periudhes se percaktuar ne njoftimin per shkeljen, Pales tjeter i lind e drejta per zgjidhjen e Marreveshjes se Interkoneksionit bazuar ne kete ORI me ane te nje njoftimi paraprak 3 mujor, me shkrim, te derguar tek Pala qe ka kryer shkeljen. Ne qofte se gjate periudhes 3 mujore te njoftimit Pala qe ka kryer shkeljen arrin t'a korrigjoje shkeljen dhe te shlyeje plotesisht demin e shkaktuar nga kjo shkelje, kjo Marreveshje nuk do te zgjidhet edhe pas dergimit te nje njoftimi te tille.

20.5 Secila nga Palet mund t'a zgjidhe Marreveshjen e Interkoneksionit bazuar ne kete ORI, duke i dhene pales tjeter njoftim me shkrim, nese pala tjeter ndodhet ne kushtet e:

20.5.1 Perfundimit te afatit, anullimi dhe raste te tjera te perfundimit te parakohshem te liçences ose autorizimit, kur nje liçense ose autorizim i tille kerkohet me ligj; ose,

20.5.2 Likuidimit te vullnetshem ose te detyruar (perveç se per qellime riorganizimi ose bashkimi te bizneseve); ose është deklaruar në falimentim; ose

20.5.3 Mbylljes se aktivitetetit para afatit te perfundimit te marreveshjes;ose

20.5.4 Njoftimit nga pala qe zgjidh marreveshjen, per ndërprerjen e Marreveshjes se Interkoneksionit në mënyrë të njëanshme për arsye të parashikuara në këtë ORI;

20.5.5 Mos-ndryshimit, mos-plotesimit apo mos-rinovimit te garancise financiare sipas percaktimeve ne seksionin 21 'Garancia Financiare'.

20.6 Me zgjidhjen ose perfundimin e rregullt te Marreveshjes se Interkoneksionit bazuar ne kete ORI, secila nga Palet gezon te drejten qe, pas dergimit tek Pala tjeter te nje njoftimi paraprak brenda nje afati te arsyeshem, te hyje ne ambientet e Pales tjeter me qellim kryerjen e proçedurave te nevojshme per çmontimin dhe rimarrjen ne dorezim te pajisjeve, impianteve ose aparaturave qe i perkasin kesaj te fundit (ose nje Pale te trete te instaluara nga ose per ate Pale), me kusht qe Pala qe kerkon te hyje ne keto ambiente te jape nje njoftim tjeter brenda nje afati te arsyeshem duke kerkuar qe Pala tjeter te kryeje çmontimin dhe kthimin e ketyre pajisjeve impianteve dhe aparaturave dhe te hyje ne keto ambiente vetem ne rast se vete ajo Pale nuk e ka bere kete. Pala, ne ambientet e se ciles jane instaluar keto pajisje, impiante dhe aparatura do te kompensoje Palen tjeter per çdo pajisje, impiant dhe aparature qe i perket Pales tjeter ose ndonje pale te trete, te cilat nuk dorezohen ne kushte te mira (nje shkalle e lehte amortizimi eshte e pranueshme). Pala ku jane montuar pajisjet nuk do te konsiderohet pergjegjese per ndonje demtim te pajisjeve, impianteve dhe aparaturave qe i perkasin Pales tjeter ose nje Pale te trete, demtim i cili eshte shkaktuar nga moskryerja e proçedurave te nevojshme te mirembajtjes nga Pala tjeter ose Pala e trete.

20.7 Pa cenuar te drejtat e Paleve, me zgjidhjen e Marreveshjes se Interkoneksionit bazuar ne



C1 Public

kete ORI, secila nga Palet do t'i rimbursoje Pales tjeter shumat e paguara (nese ka te tilla) per periudhen e kohes qe tejkalon afatin e vlefshmerise se Marreveshjes se Interkoneksionit.

20.8 Zgjidhja e Marreveshjes se Interkoneksionit bazuar ne kete ORI nuk do te nenkuptoje shkarkimin e pergjegjesise se njeres nga Palet e ketushme per shkeljen e ndonjeres prej dispozitave te Marreveshjes se Interkoneksionit bazuar ne kete ORI dhe do te behet pa cenuar te drejtat dhe detyrimet e asnjeres prej Paleve, te cilat kane lindur dhe jane akumuluar deri ne daten e zgjidhjes se kesaj Marreveshje ose perfundimit te saj te rregullt.

20.9 Pavaresisht zgjidhjes apo perfundimit te Marreveshjes se Interkoneksionit qe bazohet ne kete ORI, detyrimet qe lindin nga nenet 17, 20.6, 22, dhe 26 do te vazhdojne te mbeten ne fuqi per nje afat 10 (dhjete) vjecar, pervec se kur palet me shkrim kane parashikuar ndryshe.

20.10 Pavaresisht sa parashikohet ne kete nen per nderprerje apo zgjidhje te interkoneksionit, pala qe ka marre nje Njoftim per Shkelje, sipas pikes 20.2 ka te drejte te paraqese ceshtjen ne AKEP per zgjidhje mosmarreveshje sipas afateve te parashikuara nga ligjet dhe rregulloret ne fuqi. Ne kete rast, masat ne dispozicion te pales qe pretendon shkeljet e referuara ne kete nen, pervec rasteve te parashikuara ne pikat 20.11 deri 20.14 dhe nenin 21, ndaj pales tjeter nuk do te aplikohen per sa kohe AKEP nuk ka marre vendim per ceshtjen e referuar.

20.11 Ne rast se ndonje nga palet deshton te kryeje pagesat e sherbimeve sipas percaktimeve te dhena ne Aneksin III (Faturimi dhe Pagesat), neni 3.7.2, nje shkelje e tille do te konsiderohet Shkelje pagesash' dhe do te perbeje shkak per zgjidhjen e marreveshjes, sipas procedures ne vijim. Pala jo ne shkelje ka te drejte te veproje ne nje prej menyrave te meposhtme (20.11.1 ose 20.11.2), kjo sipas deshires se pales qe nuk eshte ne shkelje :

20.11.1 Te filloje ekzekutimin e menjehershem te Garancise Bankare te vendosur nga pala tjeter sipas percaktimeve ne nenin 21 (Garancia Bankare) dhe pas ekzekutimit te njoftoje me shkrim palen tjeter duke kerkuar qe brenda 10 (dhjete) diteve kalendarike:

a. te plotesoje vleren e Garancise Bankare, pas perdorimit nga pala jo ne shkelje, ne vleren e meparshme ose ne nje vlere te rivleresuar nga pala jo-ne shkelje;
b. te paguaje diferencen midis vleres se detyrimit financiar perkates dhe Garancise Bankare, ne rast se Garancia Bankare nuk mbulon vleren e ketij detyrimi.

20.11.2 Te pezulloje ofrimin e sherbimeve te interkoneksionit duke njoftuar 5 dite para palen ne shkelje per masen e marre, me te drejten per te zgjidhur marreveshjen e interkoneksionit sipas percaktimeve te pikes 20.13

20.12 Ne rast se pala ne shkelje korrigjon shkeljen brenda afatit kohor te percaktuar sipas 20.11, pala jo ne shkelje nuk do te zgjidhe marreveshjen e interkoneksionit, me kusht qe percaktimi ne piken 20.14 nuk aplikohet.

20.13 Deshtimi apo refuzimi nga pala ne shkelje per te korrigjuar 'Shkeljen e Pagesave' edhe pas pezullimit te percaktuar sipas 20.11.2 i jep te drejten pales jo-ne shkelje qe te zgjidhe marreveshjen e interkoneksionit, me njoftim paraprak 5 ditor me shkrim.



C1 Public

20.14 Ne rast se, nje pale qe eshte njoftuar per tre shkelje te pagesave te meparshem, jo detyrimisht te njepasnjeshme, ndodhet ne kushtet e nje shkelje pagesash per here te katert brenda nje periudhe 24 (njezet e kater) mujore, marreveshja e interkoneksionit mund te zgjidhet nga pala jo ne shkelje nepermjet nje njoftimi me shkrim derguar pales ne shkelje. Zgjidhja e Marreveshjes se interkoneksionit do te realizohet 30 (tridhjete) dite pas dates se dergimit te njoftimit. Zgjidhja e marreveshjes mund te kryhet pavaresisht nese ‘Shkelja e Pagesave’ eshte korrigjuar gjate kesaj periudhe kohore. Detyrimet per pagesa ngelen edhe pas zgjidhjes se marreveshjes se interkoneksionit.

20.15 Palet kane detyrimin të njoftojnë AKEP menjëherë në secilin prej këtyre rasteve te permendura nenin 20, perjashto rastet e shkeljeve te pagesave dhe Garancise Bankare, si dhe per rastet e nderprerjeve per shkak te forcave madhore dhe emergjences.

## 21. GARANCIA BANKARE

21.1 Ne momentin e nenshkrimit te Marreveshjes se Interkoneksionit, njera pale i siguron Garanci Bankare pales tjeter. Garancia Bankare do te jete sipas formatit te garancise percaktuar ne Aneksin VII (Garancia Bankare), per ofrimin e sherbimeve te interkoneksionit, ne perputhje me kete ORI.

21.2 Vlefshmeria e Garancise Bankare eshte per nje periudhe 12 (dymbedhjete) mujore, duke filluar nga dita e nenshkrimit te Marreveshjes, ne perputhje me kete ORI.

21.3 Nje muaj perpara dates se perfundimit te periudhes se vlefshmerise se garancise, pala qe ka siguruar Garancine, ka detyrimin te dorezoje nje Garanci bankare te re te pala tjeter. Pas dorezimit te Garancise Bankare te re, pala perfituese e Garancise Financiare do t’i ktheje pales tjeter Garancine Bankare pararendese. Deshtimi per te rinovuar apo dhene nje garanci te re brenda afatit, i jep pales tjeter te drejten te nderprese interkoneksionin dhe te zgjidhe Marreveshjen.

21.4 Pala qe depoziton Garancine Bankare do te jete e detyruar qe perpara nenshkrimit te Marreveshjes se Interkoneksionit, te kete derguar te pala tjeter Garancine Bankare sipas formatit te percaktuar ne Aneksin VII.

21.5 Garancia Bankare duhet te jete leshuar nga nje Banke e nivelit te dyte qe ushtron aktivitetin ne Shqiperi.

21.6 Shuma e Garancise Bankare do te perllogaritet ne menyre te tille qe te mbuloje detyrimin neto ndaj Vodafone Albania /Operatorit Perfitues per nje periudhe dy-mujore trafiku. Detyrimi neto perllogaritet si diference e detyrimit te Operatorit Perfitues ndaj Vodafone Albania me detyrimin e Vodafone Albania ndaj Operatorit Perfitues per trafikun e shkembyer. Vlera e periudhes dy mujore do te jete e barabarte me dyfishin e vleres mesatare 1 mujore te 12 muajve:



C1 Public

21.6.1 per operatoret qe kane interkoneksion ekzistues: (6 muajt e meparshem + parashikimi per 6 muajt ne vijim)/6, [1]

21.6.2 per operatore te rinj : (parashikimi per 12 muajt ne vijim)/6

21.7 Ne rast se detyrimi neto ndaj Operatori Perfitues eshte negativ, Vodafone Albania do te vendose nje Garanci Financiare sipas perllogaritjeve te mesiperme, ne rast se kjo do te kerkohet shprehimisht nga Operatori Perfitues.

21.8 Vlera e Garancise si rregull do te rishikohet 1 (nje) here ne vit, si dhe ne rastet e ndryshimeve te ndjeshme te volumeve te trafikut, te cilat konsiderohen ndryshim i detyrimeve neto te dy muajve te fundit nga vlera e Garancise Bankare minimalisht ne masen 30%

21.9 Ne çdo rast, shuma ne Garanci qe do te llogaritet si me siper dhe do t'i dorezohet Vodafone Albania /Operatorit Perfitues, nuk mund te jete me pak se detyrimi neto maksimal i nje muaji.

21.10 Mospermbushja e percaktimeve ne kete nen nga pala qe siguron Garancine Bankare, do te konsiderohet arsye per zgjidhjen e marreveshjes se interkoneksionit, sipas nenit 4 dhe dispozitave ne nenin 20, perkatesisht 20.11 - 20.15 (Shkelja, pezullimi dhe zgjidhja e marreveshjes se interkoneksionit) ne kete Oferte Reference Interkoneksioni.

21.11 Garancia Bankare, siç perkufizohet ne paragrafet e mesiperm, do te ekzekutohet pjeserisht apo teresisht ne raste mospagese ne kohe te shumave neto qe njera pale i detyrohet pales tjeter per sherbimet e interkoneksionit te ofruara ne perputhje me Marreveshjen e Interkoneksionit te lidhur sipas kesaj ORI.

21.12 Pas perdorimit te Garancise Bankare, ajo do te duhet te rikthehet ne shumen e meparshme nga pala qe ka siguruar Garancine. Moskthimi ne shumen origjinale i jep te drejten pales tjeter te nderprese sherbimet e interkoneksionit te ofruara me marreveshjen e interkoneksionit bazuar ne kete ORI, sipas dispozitave ne nenin 20., perkatesisht 20.11 – 20.15 (Shkelja, pezullimi dhe zgjidhja e Marreveshjes se Interkoneksionit)

21.13 Ne rastin e zgjidhjes apo perfundimit te Marreveshjes se Interkoneksionit mes paleve perpara perfundimit te afatit 12 mujor te garancise, Garancia Bankare do t'i kthehet pales e cila ka bllokuar shumen e caktuar, pasi kjo e fundit te kete bere nje kerkese me shkrim per zhbllokimin e kesaj Garancie. Ne kete rast garancia bankare do te zhbllokohet vetem pasi pala qe ka bllokuar shumen, te kete shlyer cdo detyrim sipas Marreveshjes se Interkoneksionit, subjekt i se ciles eshte kjo Garanci Bankare.

[1] Per operatore qe kane me pak se 6 muaj interkoneksion (N+P)/6, ku N-numri i muajve qe kane interkoneksion, dhe P=12-N, muajt e parashikuar.



C1 Public

## 22. RUAJTJA E KONFIDENCIALITETIT

22.1 Vodafone Albania, ne kuadrin e Marreveshjes se Interkoneksionit, ofron per Operatorin Perfitues informacion ne lidhje me strukturen e vet, organizimin dhe veprimtarine (ne vijim Informacioni Konfidencial). Informacioni i mesiperm, ne çdo forme dhe nese i eshte dhene Operatorit Perfitues, ka absolutisht karakter konfidencial dhe behet i ditur nga Vodafone Albania me qellimin e vetem te perfitimit te sherbimeve percaktuar ne Aneksin II. Operatori Perfitues garanton ruajtjen e karakterit konfidencial te informacionit te marre nga Vodafone Albania. Informacioni konfidencial do te konsiderohet ai qe jepet si “i tille”. Ne asnje rast Vodafone Albania nuk eshte pergjegjes ndaj Operatorit Perfitues per saktesine ose plotesine e Informacionit Konfidencial.

22.2 Operatori Perfitues do te perdore Informacionin Konfidencial vetem per qellimin e permbushjes se detyrimeve te kesaj Marreveshjeje, dhe po ne kete kuader do t’ua beje te ditur punonjesve te tij, bashkepunetoreve, nenkontraktoreve, te cilet me miratimin e Operatorit Perfitues do te kene akses per permbushjen e qellimit te mesiperm. Operatori Perfitues bie dakort te ndermarre te gjithe masatt e nevojshme, ne menyre qe fshehtesia e vendosur per Informacionin Konfidencial te zbatohet nga nenkontraktoret e tij. Operatori Perfitues nuk do t’u siguroje Informacion Konfidencial, qe mund te sillte avantazh ne konkurence, kompanive bija apo partnereve te tij.

22.3 Per arsyet e lartpermendura, Nenkontraktoret qe do te perdoren nga Operatori Perfitues, do te informohen dhe paraprakisht do te perkushtohen ne zbatimin e detyrimeve te mesiperme per sa i takon Informacionit Konfidencial. Perveç kesaj, Operatori Perfitues ka per detyre te informoje nenkontraktoret e vet ne lidhje me pergjegjesite morale dhe penale ne rast shkelje te ndonje detyrimi qe lind nga kjo Marreveshje Interkoneksioni. Informacioni Konfidencial i mesiperm do te manaxhohet nga Operatori Perfitues, ne masen e nevojshme lidhur zbatimin e Marreveshjes se Interkoneksionit.

22.4 Dispozitat e mesiperme ne lidhje me informacionin nuk do te jene te zbatueshme ne rastin kur:

22.4.1 Informacioni eshte perfituar nga nje pale e trete pa vendosjen e ndonje kufizimi ne lidhje me zbulimin dhe/ose perdorimin;
22.4.2 Informacioni perfitohet ne menyre tjeter ose behet i detyrueshem per t’ju dhene Institucioneve te Tjera sipas legjislacionit ne fuqi.

22.5 Operatori Perfitues do ti ktheje Vodafone Albania çdo Informacion Konfidencial dhe, nese ka te tilla, çdo kopje te ketij informacioni ne perfundim te Marreveshjes ose ne rastet kur kerkohet me shkrim nga Vodafone Albania.

22.6 Ne çdo rast, Operatori Perfitues eshte i detyruar t’i permbahet teresisht dispozitave te konfidencialitetit lidhur me informacionin dhe mos t’ua zbuloje (beje te ditur) ate, ne menyre te drejperdrejte ose jo, verbalisht apo me shkrim apo ne ndonje menyre tjeter personave te trete, pa marre me pare miratimin me shkrim te Vodafone Albania.

22.7 Operatori Perfitues eshte pergjegjes per çdo dem qe lind nga shkelja e detyrimeve Konfidencialitetit te Marreveshjes se Interkoneksionit. Ne rast shkelje te detyrimeve te

Konfidencialitetit nga ana e nenkontraktoreve te tij apo paleve te treta, Operatori Perfitues do te jete teresisht pergjegjes bashke me ta.

22.8 Informacioni Konfidencial, ne te cilin do te kete akses Operatori Perfitues, mund te permbaje gjithashtu te dhena personale te Abonenteve te Vodafone Albania. Per kete arsye ndalohet rreptesisht kalimi apo berja e ditur e ketij informacioni nga Operatori Perfitues drejt paleve te treta. Aksesi per te dhenat e mesiperme lejohet vetem per nevojat e zbatimit te Marreveshjes se Interkoneksionit dhe nga personat konfidenciale te Operatori Perfitues te cilet:

- Do te ofrojne garanci te mjaftueshme nga ana e njohurise teknike dhe integritetit personal ne zbatimin e ruajtjes se konfidencialitetit.

- Do te jene nen vezhgimin e drejteperdrejte te perfaqsuesve ligjore te Operatorit Perfitues ose te autorizuar nga ai.

- Do te jene informuar dhe kane rene dakort paraprakisht per konfidencialitetin e te dhenave ne fjale dhe per detyrimin per te zbatuar dispozitat e Ligjit nr 9887 date 10.03.2008 “Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale” dhe kuadrit nenligjor plotesues.

- Do te jene pergjegjes ndaj Vodafone Albania dhe paleve te treta per çdo shkelje te detyrimeve qe lindin nga dispozitat e Ligjit nr 9887, date 10.03.2008 Per Mbrojtjen e te Dhenave Personale dhe kuadrit nenligjor plotesues.

22.9 Operatori Perfitues garanton se te dhenat e Abonenteve te Vodafone Albania, te cilat ai perpunon apo u behen te ditura dhe u transmetohen nenkontraktoreve, nuk do te transmetohen, rishiten dhe as nuk do t’u komunikohen paleve te treta per qellime komerciale apo marketingu (si p.sh., promovimi i produkteve etj.) dhe as nuk do te perdoret nga vete Operatori Perfitues ose pale te treta per komunikime dytesore (ne menyre fonetike (me ze) ose permes SMS-ve) me Abonentet e Vodafone Albania ne çdo moment kohor.

22.10 Ekzistenca, permbajtja e Marreveshjes se Interkoneksionit, informacioni i dhene gjate kohezgjatjes se saj dhe diskutimet lidhur me te jane konfidenciale dhe nuk i jepen asnje pale te trete pa marre me pare miratimin me shkrim nga pala tjeter ne kete Marreveshje.

22.11 Shkelja e detyrimeve te mesiperme perben shkak per zgjidhjen e menjehershme te marreveshjes mes Operatorit Perfitues dhe Vodafone Albania ose zgjidhjen e menjehershme te çdo marreveshje tjeter te mundshme mes tyre sipas percaktimeve te kesaj ORI dhe kuadrit ligjor ne fuqi. Ne kete rast Vodafone Albania gezon te drejten te kerkoje çdo te drejte te parashikuar me ligj dhe ne menyre te veçante te drejten per demshperblim.

22.12 Kushtet e mesiperme qendrojne ne fuqi per palet kontraktuale edhe pas perfundimit te Marreveshjes se Interkoneksionit sipas afatit te percaktuar ne nenin 20.9 me lart.

22.13 Ne rast se ne Rrjetin e seciles pale rezulton nevoja per hetimin e thirrjeve keqdashese, Pala tjeter kontraktuale ka te drejten te kontribuoje ne keto çeshtje, sipas rendit te perparesise, legjislacionit perkates dhe mundesive teknike qe lidhen me sistemin e vet, duke marre parasysh dispozitat e parashtruara ne Nenin 22.8 me lart.



C1 Public

## 23. TE DREJTAT E PASURISE INTELEKTUALE

23.1 Perveç rasteve kur parashikohet ndryshe ne Marreveshjen e Interkoneksionit bazuar ne kete ORI, te Drejtat e Pasurise Intelektuale do t'i mbeten Pales qe ka krijuar ose zoteron çfaredo lloj materiali sipas kesaj ORI dhe asnje dispozite e Marreveshjes se Interkoneksionit nuk do te autorizoje ndonje kalim te se drejtes se pronesise, liçenses apo ndonje te drejte tjeter ne lidhje me Pasurine Intelektuale nga njera Pale tek tjetra, dhe asnje dispozite e Marreveshjes se Interkoneksionit nuk do te kufizoje te drejtat e asnjerit prej Operatoreve te Liçensuar per te zoteruar, perdorur, liçensuar, atribuar ose transferuar Pasurine e tyre Intelektuale.

## 24. RISHIKIMI I MI

24.1Njera nga palet mund kerkoje te modifikoje Marreveshjen e Interkoneksionit sipas kesaj ORI duke derguar nje njoftim per rishikim tek pala tjeter, ne qofte se:

24.1.1 Autorizimi i njeres nga palet modifikohet thelbesisht (me ane te nje modifikimi te autorizimit ose me zevendesim te tij); ose,

24.1.2 Detyrimet e Vodafone Albania sipas Rregullores per Akses dhe Interkoneksion modifikohen thelbesisht; ose,

24.1.3 Ligji, aktet nenligjore ne zbatim te tij, ose rregulloret per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise pesojne ndonje ndryshim thelbesor me ndikim ne kete Marreveshje; ose,

24.1.4 Marreveshja e Interkoneksionit permban dispozita te qarta per Rishikimin ose Operatoret e Autorizuar bien dakort me shkrim se do te kete nje Rishikim; ose,

24.1.5 Ndodh nje ndryshim thelbesor, qe perfshin nxjerrjen e akteve detyruese nga ndonje organ rregullator, gje qe ndikon ose pritet te ndikoje mjaftueshmerisht ne aspektin komercial ose teknik te Marreveshjes se Interkoneksionit; ose,

24.1.6 Ndodh nje ndryshim ne Sherbimet e Interkoneksionit te ofruara nga Vodafone sipas kesaj ORI

24.1.7 Te drejtat dhe detyrimet te parashikuara ne Marreveshjen e Interkoneksionit jane atribuar ose transferuar nga Operatori Perfitues.

24.2 Njoftimi per Rishikim paraqet ne menyre te detajuar çeshtjet qe do te diskutohen midis Vodafone Albania dhe Operatorit Perfitues. Pala qe kerkon modifikimet/shtesat do te njoftoje Palen tjeter ne lidhje me to brenda nje minimumi prej 30 ditesh kalendarike para dates se propozuar per rishikim.



C1 Public

24.3 Me dergimin/marrjen e nje njoftimi per Rishikim, Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues do te fillojne menjehere negociatat per zgjidhjen e çeshtjeve ne mirekuptim mes paleve me qellim renien dakort ne lidhje me modifikimet/shtesat perkatese te Marreveshjes se Interkoneksionit. Ben perjashtim rishikimi i Marreveshjes si rrjedhoje e ndryshime te kuadrit ligjor dhe rregullator, implementimi i te cilave eshte i detyrueshem per zbatim nga palet ne Marreveshje.

24.4 Nese Palet nuk arrijne nje marreveshje pas nje periudhe maksimale prej 2 muajsh nga data e marrjes se lajmerimit per shqyrtim, ne lidhje me objektin e njoftimit per Rishikim, atehere do te jene te zbatueshme parashikimet e nenit 19 (Zgjidhja e Mosmarreveshjeve) te kesaj Oferte Reference

24.5 Per te evituar ndonje keqkuptim te mundshem, Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues bien dakort se pavaresisht nga dergimi/marrja e njoftimit per Rishikim, Marreveshja e Interkoneksionit do te vazhdoje te jete ne fuqi.

## 25. FORCAT MADHORE

25.1 Palet nuk do te konsiderohen pergjegjes per ndonje shkelje te Marreveshjes se Interkoneksionit bazuar ne kete ORI shkaktuar nga “Forcat madhore”. Per kete arsye “Force madhore” do te kuptohet cdo ngjarje apo ndodhi pertej kontrollit te arsyeshem te paleve, perfshire ketu por pa u limituar ne kryengritje ose trazira civile, luftra ose nderhyrje ushtarake, situata te jashtezakonshme ne shkalle kombetare ose lokale, marrje masash ose mungesa e tyre nga Qeveria, ose organe te tjera kompetente, ndonje akt i nxjerre nga Qeveria ose ndonje autoritet tjeter, zbatimi i ligjit, rregulloreve ose urdherat e Qeverise ose ndonje institucioni qeveritar, mosmarreveshje industriale te çfaredolloji (qofshin ato te lidhura ose jo me Vodafone Albania ose Operatorin Perfitues), zjarret, rrufete, shperthimet, permbytjet, termetet, rreshqitjet e dheut, kushte atmosferike te jashtezakonshme, veprime ose mosveprime te personave per te cilet asnjera nga palet nuk eshte pergjegjes, ose ndonje shkak tjeter i ngjashem apo i ndryshem, jashte kontrollit te tyre te arsyeshem, me kusht qe keto shkaqe ose rrethana te jene klasifikuar si forca madhore.

25.2 Nese njera nga palet eshte prekur nga pasojat e nje force madhore, atehere ai do te njoftoje palen tjeter sa me pare qe te jete e mundur ne lidhje me situaten e shkaktuar nga kjo force madhore. Nese njera nga palet eshte prekur nga ndonje force madhore, ai duhet te beje me pas njoftimin ne lidhje me parashikimin mbi kohezgjatjen dhe masen ne te cilen ai do t’a kete te pamundur te permbushe detyrimet e tij ose se sa me vonese do t’i permbushe ato (njoftimi per forcen madhore).

25.3 Pas mbarimit te efekteve te forces madhore mbi sherbimin, secila nga palet e prekura nga nje force madhore do te njoftoje menjehere palen tjeter ne lidhje me mbarimin e ketyre efekteve.

25.4 Nese si rezultat i nje force madhore, njera nga palet do te kete pengesa ne permbushjen e detyrimeve te tij te parashikuara ne kete ORI, atehere kjo pale, do te permbushe ato detyrime qe mbeten te pacenuara nga forca madhore. Per permbushjen e ketyre detyrimeve te pacenuara nga forca madhore, pala e prekur nga forca madhore do t’i organizoje ose planifikoje burimet e tij ne menyre te tille qe (kur te marra se bashku me detyrimet e tjera kundrejt klienteve te tij dhe paleve te treta) nuk krijojne asnje diskriminim kundrejt pales tjeter.



C1 Public

25.5 Nese njeres prej paleve si rezultat e nje force madhore i jane krijuar pengesa ne nje mase te caktuar per ofrimin e sherbimeve ose faciliteteve qe duhet te ofrohen sipas kesaj ORI, pala tjeter do te çlirohet po ne te njejten mase nga detyrimet e tij per te kryer pagesa per keto sherbime ose facilitete, ose nga permbushja e detyrimeve te tij ne lidhje me çfare parashikohet ne kete ORI.

25.6 Pas njoftimit per nje force madhore dhe ne rast se efektet e kesaj force madhore vazhdojne per:

25.6.1 Nje periudhe prej jo me shume se gjashte (6) muajsh kalendarike ne menyre te panderprere duke filluar nga data e njoftimit per forcen madhore (pavaresisht nga fakti nese eshte dhene ose jo njoftim per mbarimin e efekteve te forces madhore, sipas nenit 24.3) çdo detyrim i prapambetur do te permbushet nga pala qe eshte prekur nga forca madhore, menjehere pasi kjo te jete e mundur pas mbarimit te efekteve te forces madhore, perveç rasteve kur nje permbushje e tille tashme nuk eshte e mundur ose nuk kerkohet me nga pala tjeter;

25.6.2 Nje periudhe prej gjashte (6) muajsh kalendarike ose me shume duke filluar nga data e njoftimit per forcen madhore (dhe kur akoma nuk eshte dhene njoftim per mbarimin e efekteve te forces madhore, sipas nenit 25.2), pala qe merr njoftimin per forcen madhore do te kete te drejte (por jo detyrim) te zgjidhe Marreveshjen e Interkoneksionit duke i dhene pales tjeter njoftim paraprak me shkrim brenda nje periudhe prej jo me pak se tridhjete (30) ditesh pune, me kusht qe ky njoftim te konsiderohet i pavlefshem ne rast se pala qe ka marre fillimisht njoftimin per forcen madhore merr edhe nje njoftim per mbarimin e efekteve te forces madhore, perpara se te kete skaduar afati tridhjete (30) ditor i njoftimit per zgjidhjen e marreveshjes. Nese Marreveshja e Interkoneksionit nuk eshte zgjidhur ne perputhje me dispozitat e ketij neni, cdo detyrim i prapambetur do te permbushet nga pala qe eshte prekur fillimisht nga efektet e forces madhore, menjehere pasi kjo gje te jete e mundur pas mbarimit te efekteve te forces madhore, perveç rasteve kur nje permbushje e tille tashme nuk eshte e mundur ose nuk kerkohet me nga pala tjeter.

## 26. KUFIZIMI I PERGJEGJESISE

26.1 Detyrimet e Paleve ne lidhje me interkonektimin e rrjeteve te tyre percaktohen nga legjislacioni ne fuqi, autorizimet e tyre dhe Marreveshja e Interkoneksionit bazuar ne kete ORI. Asnje nga palet nuk do te mbahet pergjegjese, pertej detyrimit per te ushtruar kujdes dhe vemendje te nje operatori kompetent telekomunikacionesh pergjate ushtrimit te detyrimeve te tij ne perputhje me Marreveshjen e Interkoneksionit bazuar ne kete ORI.

26.2 Palet nuk do te konsiderohen pergjegjese ne rast te ndonje kufizimi ose nderprerje te plote te interkoneksionit, nese kjo gjykohet e nevojshme nga nje organ kompetent i telekomunikacionit dhe/ose organ gjyqesor. Ne kete rast, secila nga Palet eshte e detyruar te njoftoje ne kohe Palen tjeter, duke i vene ne dispozicion te gjithe informacionin e mundshem.

26.3 Asnje nga palet nuk do te jete pergjegjese ndaj pales tjeter ne marredhenie kontraktore apo jashte saj, apo per humbje (direkte ose indirekte) te fitimeve, biznesit, fitimeve te paraprira, shpenzimeve te harxhuara, kostove apo per ndonje humbje indirekte apo te passjelle qe lind ne lidhje me operimin e Marreveshjes se Interkoneksionit bazuar ne kete ORI, sido qe kjo humbje te kete ndodhur/ardhur.

## 27. KALIMI I TE DREJTAVE DHE DETYRIMEVE TEK TE TRETET

27.1 Pervecse kur palet kane rene dakord me shkrim ndryshe, Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues nuk kane te drejte te transferojne asnje te drejte ose detyrim, qe rrjedh nga Marreveshja e Interkoneksionit, dhe qe percaktohet sipas kesaj ORI, tek palet e treta, pa marre me pare miratim me shkrim nga Pala tjeter.

27.2 Me njoftimin e Pales tjeter, por pa qene nevoja per miratimin e saj, secila nga Palet ka te drejte te transferoje te drejtat dhe detyrimet e saj konvencionale tek nje pale e trete si rezultat e transferimit te autorizimit perkates qe zoteron per ofrimin e sherbimeve te komunikimeve elektronike dhe/ose ndryshimit te kontrollit ne Kompanine e saj, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, me kusht qe pala e trete te marre persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet kontraktuale te Pales qe i transferon keto te drejta dhe detyrime. Çdo kosto e gjeneruar nga ky moment e ne vazhdim do te jete plotesisht ne pergjegjesine e kesaj pale te trete.

## 28. NJOFTIMET

28.1 Te gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera te çfaredo lloji te shkembyera mes Paleve ne baze te kesaj Marreveshje do te behen me shkrim

28.2 Te gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera te çfaredo lloji te shkembyera mes Paleve ne baze te kesaj Marreveshje do te jepen vetem:

28.2.1 dorazi;

28.2.2 me poste te rregjistruar tek adresa zyrtare e Pales marrese;ose

28.2.3 me faks, nese marrja e ketij faksi konfirmohet automatikisht

28.2.4 me poste elektronike, nese vertetohet dergimi i mesazhit dhe marrja nga pala tjeter

28.3 Ky njoftim ose komunikim do te konsiderohet i derguar siç duhet vetem kur merret ne kete menyre nga Pala tjeter.

## 29. TERESIA E MARREVESHJES

29.1 Marreveshja e Interkoneksionit qe do te nenshkruhet ne zbatim te kesaj ORI, perfaqeson teresisht kuptimin dhe interpretimin e paleve ne lidhje me objektin e kesaj Marreveshje, dhe pervec rasteve kur eshte rene dakord me shkrim ndryshe, zevendeson te gjithe marreveshjet e meparshme, angazhimet, detyrimet, apo perfaqesimet e cfaredo lloji, qofshin verbale apo ne forme te shkruar.



C1 Public

## 30. HEQJA DORE

30.1 Heqja dore nga ndonje shkelje, ose mospermbushja e ndonjerit prej afateve dhe kushteve qe rrjedhin nga pranimi i kesaj ORI nuk do te interpretohen si heqje dore nga cdo afat dhe/ose kusht tjeter i kesaj ORI. Heqja dore do te jete e vlefshme vetem nese behet me shkrim dhe nenshkruhet nga pala qe njofton heqjen dore.

## 31. VLEFSHMERIA

31.1 Pavlefshmeria, mungesa e forces detyruese te ndonjeres prej dispozitave ne Marreveshjen e Interkoneksionit nuk do te kete asnje ndikim mbi vlefshmerine ose forcen detyruese te dispozitave te tjera.

## 32. NDRYSHIMET NE RIO DHE MI

32.1 Ndryshimet ose shtesat e kesaj ORI, duke perfshire Anekset e saj, Amendamentet, Shtojcat dhe Listat e Sherbimeve, behen sipas percaktimeve ligjore dhe nenligjore dhe jane objekt i miratimit nga AKEP. Ndryshimi i tarifave qe nuk jane objekt rregullimi nga AKEP, hyjne ne fuqi pa miratimin e AKEP, per sa kohe AKEP nuk shprehet me vendim per mosmiratimin/pezullimin e ndryshimit te tyre.

32.2 Cdo amendim i ORI se Vodafone (pervec rasteve ne piken 32.3) qe kryhet ne perputhje me udhezimet/vendimet e AKEP e ka lidhje me percaktimin, rregullimin ose heqjen nga rregullimi te tarifave apo sherbimeve te perfshira ne ORI-n e Vodafone behet pjese e marreveshjes se interkoneksionit te lidhura nga Vodafone Albania me palet e tjera, me efekte nga data e percaktuar nga AKEP per hyrjen ne fuqi te tyre.

32.3 Cdo amendim i kesaj ORI per
- perfshirjen e sherbimeve te reja nga Vodafone ne ORI,
- ndryshimin e tarifave qe nuk jane nen-rregullim nga AKEP

do te duhet te materializohet me nenshkrimin nga te dy palet te nje amendimi te marreveshjes se interkoneksionit.

## 33. MARREDHENIA MES PALEVE

33.1 Marredhenia e interkoneksionit mes paleve do te jete ajo mes dy sipermarresve te pavarur nga njeri tjetri. Asgje ne kete ORI, qe do te sherbeje per lidhjen e Marreveshjes se Interkoneksionit, nuk do te konsiderohet se krijon nje marredhenie agjensie, joint venture, apo partneriteti mes paleve. Asnjeres prej paleve nuk i jepet ndonje e drejte autorizimi apo agjensie, ne menyre te shprehur apo te nenkuptuar, qe per llogari apo emer te pales tjeter, te detyroje ligjerisht palen e pare ne cfare do lloj menyre.Asnje nga palet nuk do te jete ligjerisht pergjegjese per shkak te ndonje prezantimi, akti apo veprimi te pales tjeter, i cili bie ne kundershti apo nuk ligjerohet nga dispozitat e marreveshjes se interkoneksionit, bazuar ne kete ORI.



C1 Public

## 34. LIGJI I ZBATUESHEM DHE GJYKATA KOMPETENTE

34.1 Interpretimi, vlefshmeria dhe zbatimi i kesaj ORI dhe marreveshjes se interkoneksionit bazuar ne te, do te udhehiqet ne te gjitha aspektet nga ligjet e Republikes se Shqiperise dhe organi gjyqesor kompetent per zgjidhjen e mosmarreveshjeve eshte ajo e percaktuar ne dispozitat perkatese te Kodit te Procedures Civile te Republikes se Shqiperise..



C1 Public

# ANEKSI I

# PERKUFIZIME DHE SHKURTIME

1.1 Fjalet dhe shprehjet e perdorura ne Marreveshjen e Interkoneksionit bazuar ne kete ORI, kane kuptimin e dhene ne kete nen:

*“Abonent/pajtimtar i rrjetit Vodafone Albania”:* abonentet/pajtimtaret qe:

1.Kane numer celular qe i perket serive numerike 069 XX XXXXX të alokuar nga AKEP Vodafone Albania, numer i cili nuk eshte portuar ne rrjetin e nje operatori tjeter, ose

2. Kane numer qe nuk i perket serive numerike 069 XX XXXXX te alokuar nga AKEP Vodafone Albania, por qe eshte portuar ne rrjetin e Vodafone Albania.

**“***Abonent/pajtimtar i rrjetit Operatorit Perfitues”:* abonentet/pajtimtaret e rrjetit te Operatorit Perfitues qe:

1. Kane numer qe i perket serive numerike të alokuar nga AKEP Operatorit Perfitues, numer i cili nuk eshte portuar ne rrjetin e nje Operatori tjeter, ose

2. Kane numer qe nuk i perket serive numerike te alokuar nga AKEP Operatorit Perfitues, por qe eshte portuar ne rrjetin e Operatorit Perfitues.

*“AKEP”* eshte Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare ne Republiken e Shqiperise.

*“Akses”* është bërja e disponueshme e lehtësive dhe/ose shërbimeve një sipërmarrësi tjetër, sipas kushteve të përcaktuara, në baza ekskluzive ose joekskluzive, për sigurimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike. Aksesi, ndërmjet të tjerash, përfshin akses në elementet e rrjetit dhe fasiliteteve shoqëruese, të cilat mund të përfshijnë lidhjen e pajisjeve në mënyrë fikse ose jofikse (në veçanti kjo përfshin akses të hapur në rrjetin lokal dhe akses në fasilitetet dhe shërbimet e nevojshme, për të ofruar dhe mundësuar shërbimet e bazuara në rrjetin lokal); akses në infrastrukturën fizike, përfshirë ndërtesat, tubacionet dhe kullat; akses në sistemet e *software-ve* përkatëse, përfshirë sistemet mbështetëse operacionale; akses në përkthimin e numrit (*number translation*) apo në sistemet, që ofrojnë funksionalitet të njëvlefshëm; aksesin në rrjetet fikse apo të lëvizshme, në veçanti për *roaming-un*; aksesin në shërbimet e rrjeteve virtuale

*“Autorizim i Pergjithshem”* është një akt i natyrës së përgjithshme, që përbëhet nga kuadri ligjor, i përcaktuar nga ligji 9918 dhe rregullat e nxjerra nga AKEP-i, në zbatim të tij, për të siguruar të drejtat për ofrimin e rrjeteve ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke vendosur edhe detyrimet specifike, të cilat mund të zbatohen ndaj të gjitha ose ndaj disa prej rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike

*“Bashkevendosja”* eshte sherbimi i cili mundeson vendosjen e pershtashme te pajisjeve te operatorit perfitues dhe lidhjen e tyre tek pajisjet korresponduese te operatorit ofrues.

"*Bashkëvendosje fizike*" është bashkevendosja e pajisjeve të Operatorit Përfitues në të njëjtat mjedise ku operatori, i cili ofron aksesin, ka të vendosur elementin e rrjetit të tij, në të cilin ofrohet aksesi .

"*Bashkëvendosje në distancë*" është bashkevendosja e pajisjeve të Operatorit Përfitues në mjedise të operatorit ofrues të aksesit, të ndryshme nga ato në të cilat ky operator ka të vendosur elementin e rrjetit të tij, në të cilin ofrohet aksesi.

"*Bashkëvendosje virtuale*" është vendosja e pajisjeve korresponduese të Operatorit Përfitues, përmes instalimit të tyre në të njejtin permutator, (distribution frame) pranë një elementi të rrjetit në të cilin ofrohet aksesi dhe që operohet nga operatori ofrues

*"CDR"*
Te dhena te detajuara per çdo thirrje.

*"CLI –* ***Identifikimi i linjës thirrëse****"*
është funksioni që, në bazë të numrit ose kodit të caktuar për pikën fundore të rrjetit, i mundëson pajtimtarit marrës të thirrjes të identifikojë pikën fundore të rrjetit, ku ka pikënisjen thirrja.

***Identifikimi i linjës së Thirrur***

është funksioni, që lejon dërguesin e thirrjes të identifikojë pikën fundore të rrjetit, ku përfundon thirrja, bazuar në numrin ose kodin që i është caktuar kësaj pike fundore të rrjetit.
*"Interkoneksioni"*
është lidhja fizike dhe logjike e rrjeteve publike të komunikimit, të cilat përdoren nga i njëjti operator apo operatorë të ndryshëm, në mënyrë që t'i lejojë përdoruesit e një operatori të komunikojnë me përdoruesit e të njëjtit operator ose të një operatori tjetër, ose të lejojë aksesin për shërbimet e ofruara nga një operator tjetër. Interkoneksioni është një lloj i veçantë aksesi, që zbatohet ndërmjet operatorëve të Rrjeteve Publike të Telefonise.

*"ITU"*
Bashkimi Nderkombetar i Telekomunikacioneve.

*"Kapaciteti i Lidhjes*"
Kapaciteti i shprehur ne nje ose me shume porta 2 Mbit/s ne Piken e Interkoneksionit.

*"Kodi i Zones"*
Perdoret ne Planin e Numeracionit. [Kodi i Zones identifikon nje zone gjeografike / jo-gjeografike te quajtur Zone Numeracioni].

*"Link interkoneksioni (interconnection link)"*
eshte kapaciteti (rruga-path) e transmetimit midis pajisjeve te transmetimit (te dy operatoreve) me te aferta me Piken e interkoneksionit, e cila perbehet nga nje numer specifik linkesh 2 Mbps (E1).

*"Lidhja e Interkoneksionit"*
Lidhja fizike mes pikave te aksesit te rrjetit te Operatorit Perfitues dhe VODAFONE ALBANIA-se, te perdorura per transportimin e trafikut te interkoneksionit mes dy Paleve.

*"Mesazhi"*



C1 Public

Perfshin te foluren, te dhenat dhe tingujt e tjere.

*“Metoda Elektronike”*
Mundesia per shkembimin e informacionit ne distance midis operatorit ofrues dhe operatorit perfitues duke perdorur mjete elektronike.

*“Ndryshim i Menaxhimit te dhenave”*
Ri-konfigurime te tilla te te dhenave te rrjetit te cilat jane te nevojshme per rrugezimin dhe tarifimin e thirrjeve

*“Ndryshim i rrjetit”*
Nje ndryshim fizik ne rjetin e njeres pale, i cili behet i nevojshem, per te siguruar vazhdimin e operimit eficient te interkoneksionit, ndryshim i cili vjen per shkak te ndryshimit te bere nga pala tjeter pa nje marreveshje bilaterale

*“NSPC”*
Kodi i Pikes se Sinjalizimit Kombetar (National Signalling Point Code)

*“Numer Gjeografik”*
është një numër kombëtar, i cili i përket një rajoni gjeografik të caktuar.

*“Numer jo-gjeografik”*
janë numrat kombëtarë, që nuk i përkasin një rajoni gjeografik të caktuar dhe përfshijnë:
a) numrat për akses në rrjetet publike të lëvizshme të komunikimit;
b) numrat për akses në shërbimet me vlerë të shtuar;
c) numrat për akses në shërbimet, për të cilat e gjithë tarifa për trafikun drejt këtyre shërbimeve paguhet nga ofruesi i shërbimeve, pra drejt numrave që janë pa pagesë për përdoruesit (numra pa pagesë, numrat jeshil);
ç) numrat për akses në shërbimet, për të cilat tarifa për trafikun drejt këtyre shërbimeve paguhet pjesërisht nga thirrësi dhe pjesërisht nga ofruesi i shërbimit, pra drejt numrave, të cilët i janë dhënë përdoruesit përkundrejt një marrëdhënie të paracaktuar (numra me ndarje të kostos, numer blu);
d) numrat për shërbim publik telefonik nomadik

*“Ofrimi i një rrjeti të komunikimeve elektronike”*
është ndërtimi, përdorimi, mbikëqyrja ose bërja e disponueshme e një rrjeti të tillë;

*“Operator”*
është një sipërmarrës, që ofron ose që është i autorizuar të ofrojë një rrjet të komunikimeve elektronike ose faciliteteve shoqëruese;

*“Operator i rrjetit të komunikimeve publike”*
është sipërmarrësi, i cili ka të drejtë të ndërtojë, të posedojë, të japë me qira dhe të shfrytëzojë një rrjet të komunikimeve publike dhe facilitetet shoqëruese, si dhe të ofrojë shërbime të komunikimeve publike

“*Operator ofrues*”



C1 Public

është operatori i një rrjeti të komunikimeve elektronike publike i cili është i detyruar të japë akses/interkoneksion sipas ligjit.

“*Operatori përfitues*”
është operatori i një rrjeti publik të komunikimeve elektronike dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, i cili ka aplikuar me shkrim për akses/interkoneksion.

*“Operator Origjinues”*
Operatori, ne rrjetin e te cilit eshte origjinuar mesazhi i telekomunikacioneve.

*“Operator Terminues”*
Operatori, ne Piken Fundore te Rrjetit te te cilit terminohet nje mesazh telekomunikacioni.

*“Operator Dergues”*
Operatori, nga rrjeti i telekomunikacioneve i se cilit eshte percjelle nje mesazh telekomunikacioni. Operatori Dergues mund te jete edhe Operator Origjinues.

*“Operator Marres”*
Operatori, ne rrjetin e telekomunikacioneve te te cilit eshte percjelle mesazhi i telekomunikacioneve. Operatori Marres mund te jete edhe Operator Terminues.

*“Operator i Trete”*
Nje operator i ndryshem nga palet e ketushme.

*“Pala”*
Vodafone Albania ose Operatori Perfitues, sipas kontekstit.

*“Palet”*
Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues te marra se bashku

“*Pika e interkoneksionit*”

është një pikë e përcaktuar gjeografikisht në rrjetin publik të komunikimeve elektronike të operatorit Ofrues, ku operatori Ofrues dhe operatori Perfitues janë të interkonektuar.

*“Pika Fundore e Rrjetit (NTP)”*
Jane te gjitha lidhjet fizike dhe/ose protokollet e aksesit, se bashku me specifikimet e tyre teknike, te cilat jane pjese e rrjetit publik te telekomunikacioneve dhe sherbejne per aksesin ne kete rrjet publik dhe realizimin e komunikimit nepermjet tij.

*“Pjesa e Sinjalizimit per Kontrollin e Lidhjes (SCCP)”*
Pjesa e Sinjalizimit për Kontrollin e Lidhjes, sipas perkufizimeve te rekomandimeve te ITU dhe ETSI

*“Përdorues”*
është cilido që përdor ose kërkon të përdorë shërbime të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun.

*“Përdorues fundor”*
është një përdorues, i cili nuk ofron rrjete komunikimesh publike ose shërbime komunikimesh elektronike, të disponueshme për publikun

*“Plani i numeracionit”*
është struktura e numrave dhe e serive të numrave, si dhe caktimi i tyre për sigurimin e aksesit në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve publike.

*“Plani kombëtar i frekuencave”*
është dokumenti, që përcakton brezat e frekuencave për shërbime të ndryshme dhe vendos kushtet bazë për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, për përdorimin me efektivitet të spektrit të frekuencave dhe shmangien e interferencave

*“Qark Interkoneksioni E1”*
është një kapacitet E1 transmetimi që kalon nga Pika e interkoneksionit midis dy centaleve të interkonektuar, përfshire portat E1 të centraleve (switch).

*“Rrjeti i Vodafone Albania”*
Rrjeti GSM dhe UMTS i telefonise se levizshme te Vodafone Albania

*“Rrjet Telefonik Publik”*
është një rrjet i komunikimeve elektronike, i cili përdoret për të ofruar shërbime telefonike të disponueshme për publikun. Ai mundëson përcjelljen ndërmjet pikave fundore të rrjetit të komunikimit zanor, si edhe të formave të tjera të komunikimit, të tilla si faksimile dhe të dhëna etj..

*“Rrjeti i Levizshem i Komunikimeve Publike”*
Rrjeti ne te cilin pikat fundore nuk jane te vendosuara ne vende te fiksuara.

*“Rrjeti i qendrueshme ( Fiks) i Komunikimeve Publike)”*
Rrjeti ne te cilin pikat fundore jane te vendosuara ne vende te fiksuara.

*“SS”*
Sistem Sinjalizimi.

*“STP”*
Pika per Transferimin e Sinjalit.

*“SPC”*
Kodi i pikes se sinjalizimit, ose ndryshe e quajtur SPC (signalling point code).

*“Sherbimet e Interkoneksionit”*
Sherbimet te cilat jane te percaktuara ne Aneksin II te Marreveshjes se Interkoneksionit.

*“Sherbimet ne lidhje me Trafikun”*
Sherbimet e terminimit kombetar ose tranzitimit kombetar, ose kombinimet e tyre.

*“Sherbimet e Lidhjes”*
Sherbimet e vendosjes dhe ndryshimit te pikave te interkoneksionit dhe sherbimet e vendosjes apo ndryshimit te kapaciteteve lidhese.

*“Sherbimi i Terminimit kombetar ne Vodafone Albania”*

Sherbimi nepermjet te cilit Vodafone Albania ne emer te Operatorit Perfitues percjell thirrjet kombetare te ketij te fundit, ose te tranzituara prej tij ne menyre te rregullt, nga Pika e Interkoneksionit per ne nje Pike Fundore te Rrjetit te tij ne Republiken e Shqiperise, te identifikuar nepermjet numrave te abonenteve /pajtimtareve te Vodafone Albania.

*“Sherbimi i Terminimit kombetar ne Operatorin Perfitues”*

Sherbimi nepermjet te cilit Operatorit Perfitues, ne emer te Vodafone percjell Thirrjet kombetare te ketij te fundit, ose te tranzituara prej tij ne menyre te rregullt, nga Pika e Interkoneksionit per ne nje Pike fundore te Rrjetit te tij ne Republiken e Shqiperise, te identifikuar nepermjet numrave te abonenteve /pajtimtareve te Operatorit Perfitues.

*“Sherbimi i Tranzitimit kombetar”*
Eshte percjellja e thirrjeve telefonike kombetare nga operatori tranzitues midis pikave te interkoneksionit me dy operatore te cilet nuk jane te interkonektuar direkt midis tyre.

*“Tarifat”*
Tarifat e sherbimeve te aksesit dhe/ose interkoneksionit apo fasiliteteve shoqeruese.

*“Thirrjet e dorezuara nga rrjeti i operatorit perfitues”*
Thirrjet kombetare te percjella nepermjet pikes se interkoneksionit nga rrjeti i operatorit perfitues per terminim ne rrjetin e operatorit Vodafone Albania, te cilat mund te jene:

1. thirrje te origjinuara nga abonentet e Operatorit Perfitues;
2. thirrje kombetare te tranzituara nga rrjeti i Operatorit Perfitues

*“Thirrje e suksesshme”*
Eshte nje thirrje me ane te se ciles pala thirrese ka marre nje sinjal pergjigjeje (koha e bisedes e tarifueshme llogaritet sipas percaktimeve ne pjesen kryesore te ORI)

*“Trafiku nga Interkoneksioni”*
Trafiku i mbartur permes lidhjeve te interkoneksionit. Trafiku i interkoneksionit i referohet sherbimeve ne lidhje me trafikun te pershkruara ne Aneksin II te kesaj ORI. Matja dhe regjistrimi i trafikut te interkoneksionit do te bazohet ne kohen e bisedes.



C1 Public

# ANEKSI II
# SHERBIMET DHE TARIFAT E INTERKONEKSIONIT

## 2.1 INDEKSI I SHERBIMEVE TE INTERKONEKSIONIT

| Numri i Sherbimit | Emri i Sherbimit |
|---|---|
| | **Sherbimet e rrjetit te Vodafone Albania** |
| 001 | Sherbimi i bashkevendosjes |
| | |
| | **Sherbimet e Vodafone Albania ne lidhje me trafikun** |
| 101 | Sherbimi i terminimit te thirrjeve kombetare te dorezuara nga Operatori Perfitues drejt abonenteve te rrjetit te Vodafone perfshire:<br><br>a. thirrje te origjinuara nga abonentet e Operatorit Perfitues;<br>b.thirrje te gjeneruara nga abonentet e rrjeteve te tjera publike telefonike ne Republiken e Shqiperise dhe qe rregullisht jane te tranzituara nga rrjeti i Operatorit Perfitues;<br>c.thirrje te origjinuara nga rrjete nderkombetare, te percjella me interkoneksion direkt tek Operatorit Perfitues me bartes nderkombetare(jo i autorizuar nga AKEP), drejt numrave te Operatorit Perfitues te portuar ne rrjetin e Vodafone. (i zbatueshem vetem per celular – celular) |
| 102 | |
| 103 | Sherbimi i terminimit te thirrjeve ne Numrat e Kujdesit per Klientin te Vodafone Albania |
| 104 | Sherbimi i terminimit te thirrjeve ne numrin e sekretarise telefonike |
| 105 | Sherbimi terminimit te thirrjeve ne numrin e rimbushjes se kreditit |
| 106 | Sherbimi i Implementimit te Numeracionit |
| 107 | Sherbimi i lidhjes fillestare te nje qarku 2 Mbit/s |
| 108 | Sherbimi i lidhjes prej nje qarku 2 Mbit/s |
| | **Sherbimet e Operatorit Perfitues ne lidhje me trafikun** |
| 201 | Sherbimi i terminimit te thirrjeve kombetare te dorezuara nga Vodafone drejt abonenteve te rrjetit te Operatorit Perfitues perfshire:<br><br>a. thirrje te origjinuara nga abonentet e Vodafone Albania;<br>b.thirrje te gjeneruara nga abonentet e rrjeteve te tjera publike telefonike ne Republiken e Shqiperise dhe qe rregullisht jane te tranzituara nga rrjeti i Vodafone Albania<br>c.thirrje te origjinuara nga rrjete nderkombetare, te percjella me interkoneksion direkt tek Vodafone Albania me bartes nderkombetar (jo i autorizuar nga AKEP), drejt numrave te Vodafone Albania te portuar ne rrjetin e Operatorit Perfitues. (operator rrjeti celular ne RSH) |

| | |
|---|---|
| 202 | Sherbimi per Implementimin e Numeracionit |
| 203 | Sherbimi i vendosjes fillestare te lidhjes |
| 204 | Sherbimi i lidhjes prej nje qarku 2 Mbit/s |
| 301 | Sherbimet e bashkevendosjes |
| 302 | |
| 303 | |
| | **Sherbime te perbashketa** |
| 401 | Ndryshimi i menaxhimit te te dhenave |

## 2.2 TE PERGJITHSHME

2.2.1 Palet ofrojne Sherbimet e Interkoneksionit percaktuar ne piken 2.4 te ketij Aneksi.Tabela e Indeksit te sherbimeve te Interkoneksiont (pika 2.1) paraqet gamen e sherbimeve qe ofrojne palet ne menyre skematike per lehtesi referimi

2.2.2 Ne vijim, terminologjia ne fjale eshte perdorur:

- tarife per minute (ndryshe tarifa per kohezgjatje thirrjeje)

2.2.3 Tarifat e dhena ne piken 2.5 (Lista e Tarifave) ne kete Aneks jane ne Leke.

2.2.4 Njoftimet ne lidhje me ndryshimin e sherbime dhe/ose tarifave sipas ketij Aneksi, do te komunikohen nepermjet pikave perkatese te kontaktit te dhena ne Aneksin VIII (Personat e Kontaktit)

## 2.3 LLOJET E SHERBIMEVE TE INTERKONEKSIONIT

### 2.3.1 Sherbimet e Vodafone Albania ne lidhje me trafikun

**2.3.1.1** *Sherbimi i terminimit te thirrjeve kombetare te dorezuara nga Operatori Perfitues drejt abonenteve te rrjetit te Vodafone perfshire:*

*a. thirrje te origjinuara nga abonentet e Operatori Perfitues;*

*b.thirrje te gjeneruara nga abonentet e rrjeteve te tjera publike telefonike ne Republiken e Shqiperise dhe qe rregullisht jane te tranzituara nga rrjeti i Operatori Perfitues*

*c.thirrje te origjinuara nga rrjete nderkombetare, te percjella me interkoneksion direkt tek Operatori Perfitues me bartes nderkombetare(jo i autorizuar nga AKEP), drejt numrave te Operatorit Perfitues te portuar ne rrjetin e Vodafone.*

a. Vodafone eshte e prirur brenda mundesive teknike qe disponon dhe kushteve te parashikuara ne kete MI te plotesoje maksimalisht kerkesen e Operatorit Perfitues per kapacitete E1 fillestare per



C1 Public

Sherbimin 101 dhe 201 dhe ne pamundesi teknike kapaciteti minimal fillestar i lidhur me Paleve per Sherbimin 101 dhe 201 deri ne afatin e plotesimit te kerkeses, i cili nuk mund te jete me i gjate se 3 muaj, do te jete nje (1) link E1, i konfiguruar me kanalet e nevojshme sipas parashikimit te trafikut dhe per te mbajtur Nivelin e Cilesise se Sherbimit sipas kesaj MI dhe SLA.

b. Sherbimi 101 dhe 201 do te kene ne dispozicion kapacitet (kapacitete) ekskluziv te dedikuar transmetimi, i ndryshem nga ai i sherbimeve te tjera te terminimit ose do te perfshihet ne te njejtin kapacitet (kapacitete) me sherbime te tjera te terminimit per qellim te perdorimit optimal te kapaciteteve

c. Pika e Interkoneksionit e parashikuar per Sherbimin 101 dhe 201 mund te jete e ndryshme nga pika e interkoneksionit per sherbimet e tjera te terminimit, kjo ne varesi te kapaciteteve interkonektuese qe disponon Vodafone ne secilen pike interkoneksioni.

d. Identifikimi i linjes thirrese do te jete disponibel ne masen 100% per Sherbimin 101

**2.3.1.2** *Sherbimi i terminimit te thirrjeve drejt Numrave te Kujdesit per Klientin te Vodafone Albania, respektivisht numrat "069 140" dhe "069 149" (Sherbimi 103)*

**2.3.1.3** *Sherbimi i terminimit te thirrjeve ne numrin e sekretarise telefonike, respektivisht numri "069100135" (Sherbimi 104)*

**2.3.1.4** *Sherbimi terminimit te thirrjeve ne numrin e rimbushjes se kreditit, respektivisht numri "069142" (Sherbimi 105)*

**2.3.1.5** *Sherbimi per Implementimin e Numeracionit (Sherbim 106)*

**2.3.1.6** *Sherbimi i vendosjes fillestare te lidhjes (Sherbimi 107)*

**2.3.1.7** *Sherbimi i lidhjes prej nje qarku 2 Mbit/s (Sherbimi 108)*

*Sherbimet 107 dhe 108, i referohen dhenies se kapaciteve te dedikuara, ne formen e linjave me qera 2Mbit/s, per te lidhur operatorin perfitues me piken e interkoneksionit te Vodafone Albania, kur interkoneksioni i realizuar eshte i ndermjetem ose ne anen e operatorit perfitues. Ofrimi i ketij sherbimi eshte i varur nga mundesite teknike te realzimit te tij, dhe vendodhja e pikes se lidhjes. Operatori perfitues do te paguaje tarife fillestare instalimi (sherbimi 107) dhe tarife mujore (sherbimi 108), sipas vlerave te percaktuara ne seksionin e tarifave. Tarifa e instalimit nuk varet nga vendodhja e pikes se lidhjes me operatorin perfitues dhe paguhet vetem nje here. Traifa mujore eshte ne varesi te gjatesise se kapacitetit te dedikuar 2 Mbit/s te ofruar (largesise nga Tirana apo*



C1 Public

*pika e interkoneksionit ne Tirane).*
*Per rastet kur operatori perfitues zgjedh formen e bashkvendosur te interkoneksionit ne piken e interkoneksionit te Vodafone (d.m.th deri ne kete pike operatori perfitues vjen me inrastrukturen e vet), operatori perfitues nuk ka detyrime per te paguar per sherbimet 107 dhe 108.*

### 2.3.2 Sherbimet e rrjetit te Vodafone Albania

#### 2.3.2.1 *Sherbimet e Bashkevendosjes (Sherbimi 001)*

### 2.3.3 Sherbimet e Operatorit Perfitues ne lidhje me trafikun

**2.3.3.1** *Sherbimi i terminimit te thirrjeve kombetare te dorezuara nga Vodafone Albania drejt abonenteve te rrjetit te Operatorit Perfitues perfshire:*

*a. thirrje te origjinuara nga abonentet e Vodafone Albania;*

*b.thirrje te gjeneruara nga abonentet e rrjeteve te tjera publike telefonike ne Republiken e Shqiperise dhe qe rregullisht jane te tranzituara nga rrjeti i Vodafone Albania*

*c.thirrje te origjinuara nga rrjete nderkombetare, te percjella me interkoneksion direkt tek Vodafone Albania me bartes nderkombetar (jo i autorizuar nga AKEP), drejt numrave te Vodafone Albania te portuar ne rrjetin e Operatorit Perfitues (operator rrjeti celular ne RSH).*

a. Operatori Perfitues eshte e prirur brenda mundesive teknike qe disponon dhe kushteve te parashikuara ne kete MI te plotesoje maksimalisht kerkesen e Vodafone per kapacitete E1 fillestare per Sherbimin 101 dhe 201 dhe ne pamundesi teknike kapaciteti minimal fillestar i lidhur me Paleve per Sherbimin 201 deri ne afatin e plotesimit te kerkeses, i cili nuk mund te jete me i gjate se 3 muaj, do te jete nje (1) link E1, i konfiguruar me kanalet e nevojshme sipas parashikimit te trafikut dhe per te mbajtur Nivelin e Cilesise se Sherbimit sipas kesaj MI dhe SLA.

b. Sherbimi 201 dhe 101 mund te kene ne dispozicion kapacitet (kapacitete) ekskluzive te dedikuar transmetimi, i ndryshem nga ai i sherbimeve te tjera te terminimit, ose do te perfshihet ne te njejtin kapacitet (kapacitete) me sherbime te tjera te terminimit per qellim te perdorimit optimal te kapaciteteve

c. Pika e Interkoneksionit e parashikuar per Sherbimin 201 dhe101 mund te jete e ndryshme nga pika e interkoneksionit per sherbimet e tjera te terminimit, kjo ne varesi te kapaciteteve interkonektuese qe disponon Vodafone ne secilen pike interkoneksioni.

d. Identifikimi i linjes thirrese do te jete disponibel ne masen 100% per Sherbimin 201.



C1 Public

#### 2.3.3.2 *Sherbimi per Implementimin e Numeracionit (Sherbimi 202)*

#### 2.3.3.3 *Sherbimi i vendosjes fillestare te lidhjes (Sherbimi 203)*

#### 2.3.3.4 *Sherbimi i lidhjes prej nje qarku 2 Mbit/s (Sherbimi 204)*

### 2.3.4 Sherbimet e rrjetit te Operatorit Perfitues

#### 2.3.4.1 *Sherbimet e Bashkevendosjes (Sherbimi 301)*

### *2.3.5* Sherbime te perbashketa

#### 2.3.5.1 *Sherbimi i Ndryshimit te menaxhimit te te dhenave (Sherbimi 401)*



C1 Public

## 2.4 TARIFAT E SHERBIMEVE TE INTERKONEKSIONIT

### *2.4.1 Tarifat e Vodafone Albania per sherbimet ne lidhje me trafikun*

| Numri | Sherbimi | Afati i Vlefshmerise se Tarifes | Afati i Vlefshmerise se Tarifes | Afati i Vlefshmerise se Tarifes | Afati i Vlefshmerise se Tarifes |
|---|---|---|---|---|---|
| | | **01.12.2019 – ne vazhdim** (sipas percaktimeve rregullatore VKD Nr.71 date 01.10.2018) | **01.10.2024 – ne vazhdim** (sipas percaktimeve rregullatore VKD Nr. 5, datë 16.02.2024) | **01.04.2025 – ne vazhdim** (sipas percaktimeve rregullatore VKD Nr. 5, datë 16.02.2024) | **01.10.2025 – ne vazhdim** (sipas percaktimeve rregullatore VKD Nr. 5, datë 16.02.2024) |
| **101** | Sherbimi i terminimit te thirrjeve kombetare te dorezuara nga Operatori Perfitues drejt abonenteve te rrjetit te Vodafone perfshire: | | | | |
| | **a.**thirrje te origjinuara nga abonentet e Operatorit Perfitues; | 1.11 Leke/min | 1.02 Leke/min | 0.89 Leke/min | 0.75 Leke/min |
| | **b.**thirrje te gjeneruara nga abonentet e rrjeteve te tjera publike telefonike ne Republiken e Shqiperise dhe qe rregullisht jane te tranzituara nga rrjeti i Operatorit Perfitues | 1.11 Leke/min | 1.02 Leke/min | 0.89 Leke/min | 0.75 Leke/min |
| | **c.**thirrje te origjinuara nga rrjete nderkombetare, te percjella me interkoneksion direkt tek Operatorit Perfitues me bartes nderkombetare (jo i autorizuar nga AKEP), drejt numrave te Operatorit Perfitues te portuar ne rrjetin e Vodafone. | Sipas dakordësisë mes palëve | | | |

| Numri | Sherbimi | Afati i Vlefshmerise se Tarifes per kohezgjatje |
|---|---|---|
| | | **01.12.2019 – ne vazhdim -** sipas percaktimeve rregullatore VKD Nr.71 date 01.10.2018 dhe qe nga data 1.10.2024 sipas percaktimeve te VKD Nr. 5, datë 16.02.2024. |
| **103** | Sherbimi i terminimit te thirrjeve ne Numrat e Kujdesit per Klientin te Vodafone Albania | 1.11 Leke/min |
| **104** | Sherbimi i terminimit te thirrjeve ne numrin e sekretarise telefonike | 1.11 Leke/min |
| **105** | Sherbimi terminimit te thirrjeve ne numrin e rimbushjes se kreditit | 1.11 Leke/min |
| **106** | Sherbimi i Implementimit te Numeracionit | Pa pagese |
| **107** | Sherbimi i lidhjes fillestare te nje qarku 2 Mbit/s per interkoneksionin e ndermjetem/ne anen e operatorit perfitues | 130,000 mije Leke (pa TVSH). Paguhet vetem nje here. |
| **108** | Pajtimi mujor per Sherbimi e lidhjes se linjes me qera pwr njw qark 2 Mbit/s per interkoneksionin e ndermjetem/ne anen e operatorit perfitues, ne varesi te vendodhjes se pikes se lidhjes me operatorin perfitues ku ofrohet kapaciteti i linjes me qera. | 195,000 lek/muaj pa TVSH (brenda Tiranes)<br><br>325,000 lek/muaj pa TVSH (jashte Tiranes deri ne 150 km)<br><br>390,000 lek/muaj pa TVSH (jashte Tiranes, 150-300 km) |

***Tarifat e mesiperme nuk perfshijne TVSH***

### 2.4.2 *Tarifat e Operatorit Perfitues per sherbimet ne lidhje me trafikun*

| Nmri | Sherbimi | Tarifa per kohezgjatje |
|---|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| **201** | Sherbimi i terminimit te thirrjeve kombetare te dorezuara nga Vodafone drejt abonenteve te rrjetit te Operatorit Perfitues perfshire:<br><br>a. thirrje te origjinuara nga abonentet e Vodafone Albania;<br>b. thirrje te gjeneruara nga abonentet e rrjeteve te tjera publike telefonike ne Republiken e Shqiperise dhe qe rregullisht jane te tranzituara nga rrjeti i Vodafone Albania<br>c. thirrje te origjinuara nga rrjete nderkombetare, te percjella me interkoneksion direkt tek Vodafone me bartes nderkombetare (jo i autorizuar nga AKEP), drejt numrave te Vodafone te portuar ne rrjetin e Operatorit Perfitues (operator rrjeti celular ne RSH). | Niveli i tarifës se terminimit të Operatorit përfitues<br><br>(i njëjtë për të tre llojet e thirrjeve të terminura) |

| Numri | Sherbimi | Tarifa |
|---|---|---|
| **202** | Sherbimi per Implementimin e Numeracionit | |
| **203** | Sherbimi i vendosjes fillestare te lidhjes | |
| **204** | Sherbimi i lidhjes prej nje qarku 2 Mbit/s | |

### *2.4.3 Tarifat e sherbimeve te rrjetit te Vodafone Albania*

| Numri | Sherbimi | Tarifa |
|---|---|---|
| **001** | Sherbimi i bashkevendosjes per marrje me qera per vendosjen e pajisjeve te interkoneksionit ne ambientet e Vodafone: | |
| | A: Brenda<br>Paisje Transmetimi | 21,300 Lek/vit |
| | B: Jashte<br>Kabina Paisjesh | 22,010 Lek/vit per kabine |
| | C: Ne kullat e antenave | |
| | Panel X-Polar / Dual Polar | 63,900 Lek/vit |
| | Omni | 50,126 Lek/vit |
| | Pjate 0.3 m | 121,026 Lek/vit |
| | Pjate 0.6 m | 92,300 Lek/vit |
| | Pjate 1.2 m | 99,684 Lek/vit |
| | Pjate 1.8 m | 109,752 Lek/vit |
| | Pjate 2.0 m | 131,703 Lek/vit |
| | Logarithmic or Yagi | 53,960 Lek/vit |
| | D. Disponibiliteti i burimeve te energjise (perfshin mirembajtje rrjeti dhe gjeneratoresh, konsum | |



C1 Public

| | | |
|---|---|---|
| | karburanti per gjeneratore dhe konsum energjie elektrike)<br><br>Antena Difuzioni (jo Radio-Ura)<br><br>Antena Radio-Ura | 213,000 Lek/vit<br><br>Perfshire ne cmimet e qirave te paisjeve respektive |
| | E. Furnizimi me energji elektrike | Tarifa sipas llojit te furnizimit, tarifes se ofruesit te energjise dhe llojit te pajisjes. |

### *2.4.4 Tarifat e Sherbimeve te rrjetit te Operatorit Perfitues*

| Numri | Sherbimi | Tarifa |
|---|---|---|
| **301** | Sherbimi i bashkevendosjes | |
| | | |
| | | |

### *2.4.5 Tarifat e Sherbimeve te perbashketa*

| Numri | Sherbimi | Tarifa |
|---|---|---|
| **401** | Sherbimi i Ndryshimit te menaxhimit te te dhenave | |
| | | |
| | | |

# ANEKSI III
# FATURIMI DHE PAGESAT

## 3.1 SHERBIMET E TARIFUESHME

3.1.1 Sherbimet e tarifueshme jane ato te perkufizuara ne Aneksin II (Sherbimet dhe tarifat e interkoneksionit)

3.1.2 Sherbimet e tarifueshme do te faturohen sipas parimeve te percaktuara ne Marreveshjen e Interkoneksionit bazuar ne kete ORI dhe proçedurat e pershkruara ne kete Aneks. Vlera e shumave do te llogaritet duke perdorur tarifat ekzistuese siç percaktohen ne Aneksin II (Sherbimet dhe tarifat e Interkoneksionit) dhe formulen e percaktuar ne kete Aneks.

## 3.2 FATURIMI

### 3.2.1 Faturimi i sherbimeve te rrjetit te Vodafone Albania

3.2.1.1 Vodafone Albania do ta faturoje Operatorin Perfitues per sherbimet e rrjetit te Vodafone Albania, perfshire ketu por pa u kufizuar ne, Bashkevendosjen, qirane e mjediseve per vendosjen e pajisjeve te interkoneksionit dhe Infrastrukturen, ne perputhje me tarifat perkatese sic percaktohen ne Aneksin II

3.2.1.2 Sherbimet dhe Tarifat perkatese jane ato te parashikuara ne Aneksin II

3.2.1.3 Faturimi do te kryhet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe sipas kesaj Marreveshje Interkoneksioni. Cdo fature do te paguhet sipas dispozitave te pikes 3.6.1 te ketij Aneksi.

### 3.2.2 Faturimi per Sherbimet e Lidhjes

3.2.2.1 Vodafone Albania do ta faturoje Operatorin Perfitues per Lidhjet e Interkoneksionit, perfshire ketu por pa u kufizuar ne, vendosjen e lidhjes fillestare, lidhjen e nje qarku 2 Mbit/s, ne perputhje me tarifat perkatese sic percaktohen ne Aneksin II

3.2.2.2 Sherbimet dhe Tarifat jane ato te parashikuara ne Aneksin II

3.2.2.3 Faturimi do te kryhet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe sipas kesaj Marreveshje Interkoneksioni. Cdo fature do te paguhet sipas dispozitave te pikes 3.6.1 te ketij Aneksi.

### 3.2.3 Faturimi per Sherbimet e Vodafone Albania ne lidhje me trafikun

3.2.3.1 Vodafone Albania do ta faturoje Operatorin Perfitues per sherbimet e

Vodafone Albania ne lidhje me trafikun, ne perputhje me sherbimet dhe tarifat perkatese sic percaktohen ne Aneksin II.

3.2.3.2 Thirrjet kombetare te origjinuara/tranzituara nga rrjeti i Operatorit Perfitues dhe te terminuara ne Rrjetin e Vodafone Albania, do te tarifohen per/sekonde ose per/minute dhe per/thirrje, kur eshte e aplikueshme, dhe do te faturohen çdo muaj per perdorimin deri ne fund te muajit kalendarik per te cilin do te leshohet edhe fatura.

3.2.3.3 Sherbimet ne lidhje me trafikun do te faturohen ne perfundim te çdo periudhe faturimi. Periudha e faturimit per trafikun eshte nje mujore (nga ora 00.00 e dites se pare te muajit deri me ora 23.59.59 e dites se fundit te muajit). Faturimi behet mbi bazen e te dhenave te regjistruara dhe te shkembyera te trafikut, sikunder pershkruhet ne kete Aneks. Tarifat e aplikueshme per sherbimet ne lidhje me trafikun qe do te faturohen jane ato te percaktuara ne Aneksin II te Marreveshjes se Interkoneksionit bazuar ne kete ORI.

3.2.3.4 Koha totale e pagueshme e nje periudhe faturimi do te llogaritet si numer total i minutave i te gjitha thirrjeve te realizuara gjate periudhes qe faturohet, per secilin nga sherbimet ne lidhje me trafikun.

3.2.3.5 Numri total i thirrjeve te pagueshme i nje periudhe faturimi do te llogaritet si numer total i te gjitha thirrjeve te suksesshme te realizuara gjate periudhes qe faturohet, per secilin nga sherbimet ne lidhje me trafikun.

3.2.3.6 Palet jane te detyruara te faturojne njera-tjetrin per trafikun e realizuar pas shkembimit te te dhenave te trafikut te interkoneksionit sic parashikohet ne piken 3.3 (Matja e Trafikut) te Aneksit III (Faturimi dhe Pagesat), por jo me vone se data kater (4) e muajit qe pason periudhen e faturimit per trafikun e interkoneksionit.

3.2.3.7 Faturimi per trafikun referuar pikes 3.2.3.6 do te behet sipas matjeve te operatorit ku terminon trafiku me kusht qe diferencat ne matje te jene brenda tolerancave prej 1% te rena dakord mes paleve ne Marreveshjen e Interkoneksionit bazuar ne kete ORI.

3.2.3.8 Ne rast se diferencat e trafikut te Paleve jane mbi 1% Pala e interesuar njofton Palen tjeter jo me vone se 2 (dy) dite perpara dates se fundit per leshimin e fatures per reklamimin e diferencave nga ana e saj sipas procedurave te ketij Aneksi.

3.2.3.9 Ne rast se Palet do te kene mosmarreveshje ne lidhje me ceshtjet objekt te pikes 3.2.3.7 me siper, atehere ato do te referohen per zgjidhje sipas procedures se parashikuar ne piken 3.5 (Mosmarreveshjet mbi trafikun qe do te faturohet) te ketij Aneksi

3.2.3.10 Nese njera nga Palet nuk respekton afatet e percaktuara mbi deklarimet e trafikut sipas pikes 3.4.5 te ketij Aneksi, atehere faturimi do te kryhet mbi bazen e te dhenave te trafikut te Pales qe i ka derguar ato zyrtarisht brenda ketyre afateve, dhe keto te dhena do te sherbejne si baze llogaritjeje.

3.2.3.11 Ne kete rast, Pala qe nuk i ka derguar te dhenat e trafikut brenda afateve se

percaktuar ne piken 3.4.5, nuk do te kete te drejte te refuzoje faturen e leshuar nga Pala tjeter, dhe ajo fature do te konsiderohet automatikisht e pranuar me marrjen e konfirmimit te sherbimit postar ose konfirmimit me shkrim te marresit. Ne rastin kur diferencat e matjeve te deklaruara nga Palet jane mbi limitet e percaktuara ne piken 3.2.3.7 te ketij Aneksi, atehere Pala e interesuar ka te drejte te inicioje proceduren per mosmarreveshjet e trafikut te percaktuar ne piken 3.5 te ketij Aneksi (Mosmarreveshjet mbi trafikun qe do te faturohet).

3.2.3.12 Tarifimet do te vazhdojne te mblidhen per çdo sherbim te ofruar sipas Marreveshjes se Interkoneksionit bazuar ne kete ORI, derisa nje njoftim per anullimin e nje apo me shume sherbimeve te jete marre ne baze te Marreveshjes se Interkoneksionit, si dhe veprimet anulluese si mosofrimi i sherbimit te jene zbatuar nga Vodafone Albania.

3.2.3.13 Per te shmangur cdo dyshim, anullimi i nje sherbimi nuk do te ndikoje ne vazhdimin e mbledhjes te tarifave per ndonje sherbim tjeter.

3.2.3.14 Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues do te mbledhin informacione te detajuara mbi faturimin (Informacioni i Faturimit), siç pershkruhet ne piken 3.2.3.15 me poshte ne kete Aneks.

3.2.3.15 Informacioni i faturimit, si me poshte pershkruar, do te regjistrohet per çdo "Thirrje" apo ndonje lloj tjeter sherbimi te Vodafone Albania, qofte ai i tarifueshem, dhe do te bazohet mbi te dhenat e detajuara te thirrjes:

- Identifikimi i komutimit te interkoneksionit
- Shifrat e formuara
- CLI
- data dhe ora kur sinjali i pergjigjes eshte marre pala qe siguron Informacionin e Faturimit.
- Kohezgjatja e tarifimit (qofte ajo e matur apo e vleresuar)
- Lloji i sherbimit i perfshire ne nivelin e detajimit
- Çfaredolloj informacioni tjeter qe mund te jete rene dakord paraprakisht mes paleve

3.2.3.16 Ne rast ndryshimi te personave te kontaktit, secila Pale ka detyrimin t'i njoftoje me shkrim menjehere Pales tjeter emrat dhe adresat e kontaktit te personave te rinj te kontaktit jo me vone se 10 (dhjete) dite pune nga data e ndryshimit.

3.2.3.17 Pala faturuese duhet t'i bashkangjise fatures informacion faturues mbeshtetes te pershtatshem ne formatin e percaktuar ne piken 3.4 te ketij Aneksi (Raporti mbi Perdorimin e Interkoneksionit), per t'i dhene mundesine pales tjeter te kontrolloje faturen.

3.2.3.18 Per te shmangur cdo dyshim, detyrimet e faturimit per sherbimet e Vodafone Albania sipas pikes 3.2.3 te ketij Aneksi do te lexohen dhe interpretohen ne teresi me Aneksin II, ne varesi te sherbimit qe do faturohet

3.2.3.19 Faturimi do te kryhet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe



C1 Public

sipas kesaj Marreveshje Interkoneksioni. Cdo fature do te paguhet sipas dispozitave te pikes 3.6.1 te ketij Aneksi.

### 3.2.4 Faturimi dhe pagesat per sherbimet e informacionit

3.2.4.1 Vodafone Albania do ta faturoje Operatorin Perfitues per sherbimet e infomacionit te percaktuara ne Aneksin II ne perputhje me tarifat perkatese sic percaktohen po ne ate Aneks

3.2.4.2 Tarifat jane ato te parashikuara ne Aneksin II

3.2.4.3 Secila nga palet te jete pergjegjese per pagesat e bera nga perdoruesit e tyre.

3.2.4.4 Secila nga palet mbulon shpenzimet e trafikut brenda rrjetit te saj.

3.2.4.5 Per te shmangur cdo dyshim, detyrimet e faturimit per sherbimet e Vodafone Albania sipas pikes 3.2.4 te ketij Aneksi do te lexohen dhe interpretohen ne teresi me Aneksin II, ne varesi te sherbimit qe do faturohet

3.2.4.6 Faturimi do te kryhet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe sipas kesaj Marreveshje Interkoneksioni. Cdo fature do te paguhet sipas dispozitave te pikes 3.6.1 te ketij Aneksi

## 3.3 MATJA E TRAFIKUT

3.3.1 Periudha e matjeve te trafikut te realizuar eshte nje (1) mujore dhe fillon nga ora 00.00 e dites se pare te muajit deri ne 23.59.59 te dites se fundit te muajit.

3.3.2 Matja e trafikut behet nga operatori ku terminon trafiku i sherbimit qe do te faturohet. Matjet e trafikut kryhen permes numratoreve te pajisjeve te komutimit te sinjalit (counters). Ne raste te vecanta, kur diferencat ne matje jane me te larta se 1% dhe nis procedura e verifikimit/rakordimit te matjeve, mund te perdoren dhe CDR (Call Details Records).

3.3.3 Matja e trafikut perbehet nga “Numri i thirrjeve te suksesshme” dhe “Koha per çdo thirrje te suksesshme”.

3.3.4 “Koha per çdo thirrje te suksesshme” konsiderohet periudha kohore, e cila fillon me marrjen e nje sinjali pergjigje dhe perfundon me marrjen e nje sinjali leshimi ne pikat e interkoneksionit. Koha totale e tarifuar (ashtu siç eshte pershkruar ne paragrafin e mesiperm) per çdo muaj kalendarik, llogaritet si me poshte:

3.3.4.1 Numri total i sekondave, per te gjitha thirrjet e suksesshme gjate ketij muaji kalendarik mblidhet dhe totali pjestohet me 60 (gjashtedhjete);

3.3.4.2 Rezultati i kesaj llogaritjeje rrumbullakoset me lart ose me poshte me minuten me te afert te plote (nje interval prej gjysem minute ose me shume rrumbullakoset me rend ngjites, ndersa nje interval prej me pak se gjysem



C1 Public

minute rrumbullakoset me rend zbrites).

3.3.4.3 Numri i thirrjeve te faturuara llogaritet si shume e “thirrjeve te suksesshme” te parashikuara ne piken 3.3.3 me lart, per intervalin kohor te matjeve te percaktuar ne piken 3.3.1 me lart.

3.3.5 Informacioni per te dhenat per trafikun total te terminuar ne rrjetin e pales terminuese per periudhen e faturimit, informacion ky i detajuar ne varesi te origjines (nese eshte nga abonentet e rrjetit te Operatorit Perfitues; nese eshte i tranzituar nga Operatori Perfitues por origjinuar nga operatore te tjere kombetare; apo nese jane thirrje nderkombetare) do te quhet “Raporti i Trafikut te Terminuar”**.** Ky informacion (Raporti) per qellim faturimi do te paraqiten sipas tabeles 1 me poshte

**Tabela 1**

| Muaji, Viti | | *Trafiku i terminuar nga________ deri me ________* | |
|---|---|---|---|
| | | Numri total i thirrjeve | Kohezgjatja e thirrjeve (ne minuta) |
| | | (A) | (B) |
| Thirrjet kombetare te origjinuara nga OP | Gjate kohes (00:00-23:59) | | |
| Thirrjet kometare tee tranzituara nga OP | Gjate kohes (00:00-23:59) | | |

## 3.4 RAPORTI MBI PERDORIMIN E INTERKONEKSIONIT

3.4.1 Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues do te perpunojne versionet e tyre perkatese te ‘Informacionit te Faturimit’ te specifikuar ne piken 3.2.3.15 me lart, ne menyre qe te pergatitet matrica e paraqitur ne Tabelen 2 me poshte, e cila do te referohet si ‘Raporti mbi Perdorimin e Interkoneksionit’. (Palet mund te bien dakort paraprakisht me shkrim per ndonje forme tjeter ‘Raporti mbi Perdorimin e Interkoneksionit’). (V) do te trajtohet sipas nenit 10 te trupit kryesor te ORI.

**Tabela 2**



C1 Public

| Numri total i thirrjeve | Kohezgjatja e thirrjeve (ne minuta) | Lek/ minute | Lek/ thirrje | Te pagueshme (Lek) | Te pagueshme (Lek) | TVSH | Te pagueshme me TVSH (Lek) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| (A) | (B) | (C) | (D) | (E)=(B)x(C) | (F)=(A)x(D) | (V) | (H)=(B)x(C)+(A )x(D)+V |

Ku A = Numri total i thirrjeve
Ku B = Kohezgjatja totale e tarifueshme e thirrjeve
Ku C = Tarifa per minute
Ku D = Tarifa per thirrje
Ku G = Te ardhurat totale nga tarifimi ku perfshihen
B x Tarifa per minute
A x Tarifa per thirrje

V: Vlera e TVSH.
H: Detyrimi total i operatorit me TVSH.

3.4.2 Per shmangien e ndonje dyshimi, Raporti mbi Perdorimin e Interkoneksionit do te pergatitet per te gjitha fashat kohore te tarifimit te aplikueshme.

3.4.3 Per qellime tarifimi, thirrjet do te konsiderohen brenda periudhes se tarifimit ne te cilen nisen.

3.4.4 Per qellime faturimi dhe llogaritjesh, thirrjet do te konsiderohen brenda periudhes se faturimit ne te cilen perfundojne.

3.4.5 Palet jane te detyruar t'i dergojne njeri-tjetrit me shkrim "Raportin e Trafikut te Origjinuar/Tranzituar", sipas pikes 3.3.5 te ketij Aneksi, jo me vone se data 4 (kater) e muajit qe pason Periudhen e Faturimit.

3.4.6 Palet jane te detyruar t'i dergojne njeri-tjetrit me shkrim "Raportin mbi Perdorimin e Interkoneksionit", sipas pikes 3.4.1 te ketij Aneksi, jo me vone se data 5 (pese) e muajit qe pason Periudhen e Faturimit.

3.4.7 Ne rast se rrjeti apo sistemi i faturimit i njeres prej paleve peson difekt dhe nuk mund te siguroje te gjithe informacionin faturues te nevojshem per te leshuar faturen, me kerkese te pales faturuese, pala tjeter, duke bere te gjitha perpjekjet e arsyeshme, do te siguroje informacionin e munguar faturues kundrejt nje pagese te arsyeshme.

## 3.5 MOSMARREVESHJET MBI TRAFIKUN QE DO TE FATUROHET

3.5.1 Ne rast te ndonje mosmarreveshjeje ne lidhje me trafikun e deklaruar (per diferenca me te medha se 1 %), secila nga Palet ka te drejte te filloje proceduren e zgjidhjes se mosmarreveshjes, siç pershkruhet ne menyre te detajuar ne pikat e meposhtme.

3.5.2 Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues duhet te krijojne nje Komision te Perbashket dhe te perhershem per zgjidhjen e mosmarreveshjeve per diferencat e trafikut te deklaruar. Secila Pale do te caktoje anetaret e saj ne komision dhe do t'ia



C1 Public

njoftoje me shkrim Pales tjeter jo me vone se nje muaj nga dita e nenshkrimit te Marreveshjes se Interkoneksionit.

3.5.3 Ne rast konstatimi te diferencave me te medha se ato te pershkruara ne piken 3.5.1 te ketij Aneksi, pala e interesuar njofton palen tjeter jo me vone se data 30 e muajit pasardhes te periudhes se faturimit. Pala tjeter duhet te pergjigjet dhe te caktoje nje date te mbledhjes se komisionit jo me vone se 5 (pese) dite kalendarike nga data e marrjes se njoftimit.

3.5.4 Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues duhet t'i sigurojne Komisionit te dhena te detajuara ditore te trafikut, si dhe per thirrjet ne se eshte e nevojshme (mbi baze CDRs) per te bere te mundur identifikimin e mosperputhjeve. Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues duhet t'ia dorezojne komisionit keto te dhena brenda 10 (dhjete) ditesh pune qe nga data e mbledhjes se Komisionit.

3.5.5 Ne rast se njera Pale nuk i jep keto te dhena Komisionit sipas afateve te percaktuara ne piken 3.5.4 me siper, atehere te dhenat e paraqitura nga Pala tjeter do te pranohen ne menyre automatike.

3.5.6 Pas zgjidhjes se mosmarreveshjes, e cila duhet bere me vendim me shkrim te Komisionit dhe brenda nje muaji nga data kur ka lindur kjo mosmarreveshje, faturimi do te behet vetem mbi bazen e vendimit te Komisionit.

3.5.7 Shuma e percaktuar per diferencat ne trafik te miratuara nga Komisioni i ngritur sipas pikes 3.5.2, do te faturohet duke leshuar nje fature tatimore shtese (Credit note) nga pala ne favor te te ciles rezulton diferenca. Fatura tatimore shtese (Credit Note) do te leshohet brenda 5 (pese) diteve pune nga dalja e vendimit te Komisionit.

3.5.8 Ne rast se Komisioni nuk arrin te marre nje vendim unanim, secila Pale do te faturoje mbi bazen e matjeve ne origjine, dhe mosmarreveshja ne lidhje me diferencat, do te zgjidhet sipas procedures se parashikuar ne nenin 19 te Marreveshjes se Interkoneksionit bazuar ne kete ORI.

## 3.6 KRYERJA E PAGESAVE

3.6.1 Palet kane detyrimin te paguajne te gjitha detyrimet perkatese per sherbimin ne lidhje me trafikun, dhe cdo sherbimi tjeter te faturuar sipas Marreveshjes se Interkoneksionit te lidhur bazuar ne kete ORI brenda 30 diteve nga data e leshimit te fatures**.**

3.6.2 Te gjitha taksat dhe detyrimet ligjore duhet te paguhen nga pala pergjegjese sipas ligjeve dhe rregullave qe jane ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

3.6.3 Secila Pale duhet t'i dergoje konfirmim pales tjeter per pagesen e kryer, duke specifikuar ne mandatin e pageses perkatese faturen ose faturat (ne rastin kur ka

vonesa) qe ai mandat pagese perfshin. Secila Pale duhet t'i pergjigjet pales se interesuar kerkuese per nje informacion te tille jo me vone se 15 (pesembedhjete) dite kalendarike nga kerkesa.

3.6.4 Ne rast mospergjigjeje brenda afatit te percaktuar ne piken 3.6.3 me siper, pala e interesuar do t'i referohet sanksionieve te percaktuara ne piken 3.7 te ketij Aneksi.

3.6.5 Shumat e faturuara nga te dyja Palet mund te balancohen me njera tjetren sipas periudhave perkatese te faturimit, dhe shuma neto e mbetur pas balancimit duhet te paguhet sipas pikes 3.6.1 me siper. Njoftimet ne lidhje me pagesat behen ne adresat e shenuara ne Aneksin VIII (Personat e Kontaktit) te Marreveshjes se Interkoneksionit objekt i kesaj Oferte Reference.

3.6.6 Pagesat do te kryhen ne llogarite bankare te shenuara ne Marreveshjen e Interkoneksionit bazuar ne kete ORI.

## 3.7 SANKSIONET

3.7.1 Ne rast se Pala debitore vonon pagesen e shumes neto pas balancimit, siç eshte percaktuar ne kete Aneks te Marreveshjes se Interkoneksionit, atehere ajo detyrohet të paguajnë kamat vonesë në masën 0.5% të vlerës së shumës së detyruar për cdo ditë vonese.

3.7.2 Nese deri ne perfundim te periudhes prej 10 (dite) kalendarike nga mbarimi i afatit te kryerjes se pagesave per trafikun e interkoneksionit sic percaktuar ne piken 3.6 te ketij Aneksi, nuk jane shlyer detyrimet e faturuara si dhe kamate vonesa, atehere Pala qe nuk eshte ne shkelje ka te drejte, kjo sipas deshires se vet, te vendose per nje nga masat me poshte:

a. pezullimin e menjehershem, e me pas, duke respektuar nje afat 5 ditor njoftimi paraprak, nderprerjen e interkoneksionit; ose
b. ekzekutimin e menjehershem te Garancise Financiare dhe ndjekjen e masave te metejshme ne perputhje me nenet 20 dhe 21, deri ne momentin e kryerjes se pagesave te detyrimit perkates se bashku me kamate vonesat.

3.7.3 Ne rast se Pala kreditore, nuk vendos per asnje nga modalitetet e percaktuar ne piken 3.7.2 me siper, atehere faturimi i kamate voneses si interes do te kryhet sipas pikes 3.7.1 te ketij Aneksi te Marreveshjes se Interkoneksionit objekt i kesaj ORI.

## 3.8 RUAJTJA E INFORMACIONIT TE FATURIMIT

3.8.1 Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues duhet te ruajne te gjithe informacionin e

faturimit per nje periudhe jo me pak se njezete e kater (24) muaj pas çdo periudhe faturimi, ne nje format, menyre dhe sasi te atille qe te mundesoje riperpunimin ne rast se do te jete e nevojshme rillogaritja e shumave qe nje pale i detyrohet tjetres, per te marre parasysh ndryshimet ne çmimet perkatese. Kjo periudhe eshte e pavarur nga ndonje kerkese staturore apo fiskale per ruajtjen e te dhenave.

## 3.9 MOSMARREVESHJET NE LIDHJE ME FATURIMIN DHE PAGESAT

3.9.1 Mosmarreveshjet ne lidhje me faturimin dhe pagesat mes Operatorit Perfitues dhe Vodafone Albania, do te zgjidhen fillimisht ne baze te ketij Aneksi IV (Faturimi dhe Pagesat) dhe ne çdo rast ne perputhje me nenin 19 (Zgjidhja e Mosmarreveshjeve) te Marreveshjes se Interkoneksionit bazuar ne kete ORI.



C1 Public

# ANEKSI IV

# KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME TË INTERKONEKSIONIT

## 4.1 TE PERGJITHSHME

4.1.1 Ky Aneks siguron informacionin e nevojshem per te mundesuar aspektin teknik dhe ate funksional te lidhje se interkoneksionit mes paleve. Ne kete Aneks percaktohet informacioni qe duhet te shkembehet midis paleve me qellim sigurimin e aksesit ne rrjetin e Vodafone Albania; informacioni paraprak i domosdoshem per t'u vendosur ne dispozicion nga Operatori Perfitues me qellim mundesimin e zgjidhjes teknike dhe komerciale te akses interkoneksionit, si dhe parimet dhe kerkesat teknike te interkoneksionit mes Vodafone Albania dhe Operatorit Perfitues.

4.1.2 Vodafone Albania do te siguroje dhe kerkoje perputhshmerine e plote te paisjeve dhe protokolleve perkates ne menyre qe te garantohet ofrimi i sherbimeve te interkoneksionit konform standarteve dhe normave te cilesise, pjese e ketij dokumenti ne Ankesin Rekomandime dhe Standarte.

## 4.2 INFORMACIONI I PERGJITHSHEM I VODAFONE ALBANIA

### 4.2.1 Te pergjithshme

4.2.1.1 Vodafone Albania i siguron Operatorit Përfitues informacionin e përgjithshëm të rrjetit që operon duke i paraqitur ketij te fundit një listë të detajuar të elementeve të rrjetit, sipas percaktimeve te Rregullores se Akses Interkoneksionit, qe te mund të sigurohet aksesi.

4.2.1.2 Ky informacion behet publik se bashku me kete ORI dhe perditesohet ne menyre qe te garantoje qe informacioni pasqyron kapacitetet dhe mundesite per te siguruar sherbimet e specifikuara ne kete ORI.

4.2.1.3 Te gjitha referencat teknike jane ne perputhje me rregulloret e AKEP dhe rekomandimet G700-G795 te ITU-se, me perjashtim te rastit kur eshte deklaruar ndryshe.

4.2.1.4 Vodafone Albania e paraqet informacionin e detajuar ne perputhje me afatet dhe formen e specifikuar ne Rregulloren per Akses dhe Interkoneksion.

### 4.2.2 Informacioni i Pergjithshem i Vodafone Albania

*I) Adresa*

Elementet e rrjetit me te cilat operon Vodafone Albania ndodhen respektivisht ne adresat e meposhtme:

Adresa : Autostrada Tirana-Durres, km 5, Tirana Albania

Adresa : Autostrada Tirana-Durres, km 6, Tirana Albania



C1 Public

*II) Topologjia e rrjetit të operuar në të cilin sigurohet aksesi*

Vodafone Albania operon me dy qendra komutuese (element rrjeti) te cilat realizojne nje topologji rrjeti plotesisht te mbrojtur. Keto elemente rrjeti jane vendosur ne dy territore te vecanta respektivisht sipas adresave te meposhtme dhe sherbejne si pika interkoneksioni per te realizuar interkoneksionin me Operatorin Perfitues. Ne varesi te kapaciteteve, Vodafone Albania ka te drejten te caktoje si pike interkoneksioni nje nga keto dy qendra komutuese te poshte permendura

1: Emri i qendres komutuese: MSCS1, MGW1 - Adresa : Autostrada Tirana-Durres, km 5, Tirana Albania
2: Emri i qendres komutuese :MSCS2, MGW2 - Adresa : Autostrada Tirana-Durres, km 6, Tirana Albania

*III) Territori i shërbyer nga elementi i rrjetit*

Elementet e rrjetit me te cilat sigurohet aksesi i interkoneksionit, te permendur ne piken II (Topologjia) me siper, i sherbejne te gjithe territorit ku operon Vodafone Albania.

*IV) Datat e skadimit të periudhës kohore të operimit të elementit të rrjetit dhe pjesëve përbërës të tij*

Periudha kohore e operimit te elementeve te rrjetit nepermjet te cileve realizohet aksesi i interkoneksionit kushtezohet nga cikli jetesor i teknologjise se operuar. Vodafone Albania operon me teknologji bashkekohore e cila me kalimin e kohes rinovohet para se te arrihet data e skadimit te operimit te elementit te rrjetit ose e pjeseve perberese te tij.

*V) Hapësirat e ambienteve, (në metër katror), në të cilat është vendosur elementi i rrjetit ku sigurohet aksesi dhe përshkrimet teknike të ambienteve*

Aksesi sigurohet ne nje kabinet (me gjeresi 44cm dhe thellesi 65cm) i pershtatur per instalimin e pajisjeve te transmetimit (me impendance terminimi 120 ohm) bashkengjitur me ambientet ku jane vendosur elementet e rrjetit.

*VI) Mundësitë e sigurimit dhe/ose instalimit të bashkëvendosjes fizike dhe/ose në distancë dhe/ose virtuale në ambientet e tij, siç përmendet në pikën V në ambientet e specifikuara apo në ambiente pranë tyre*

Vodafone Albania ofron mundësitë e sigurimit te instalimit të bashkëvendosjes fizike ne ambientet e percaktuara ne piken *V (Hapësirat e ambienteve)*. Vodafone Albania mund te ofroje dhe percaktoje mundësitë e sigurimit dhe/ose instalimit të bashkëvendosjes fizike dhe/ose në distancë, vetem pasi Operatori Perfitues te kete dhene paraprakisht nje informacion per specifikimet teknike te pajisjes qe do te perdor per te realizuar interkoneksionin si dhe sipas mundesive teknike te Vodafone Albania

*VII) Impedenca e terminacioneve dhe humbjet e kthimit*

Ne piken fundore te PLMN -ve, ne permutator, sistemi lidh hyrjet dhe daljet e linjave 2Mbit/s nepermjet kabllove simetrike me impendance 75 dhe 120 Ohms.



C1 Public

Impendanca per interkoneksionet e ardhshme do te vendoset rast pas rasti.
Humbjet e kthimit minimale do te jene te barazvlefshme ose me te larta se limitet e meposhtme.

- 18dB per frekuencat 102-2048 KHz.
- 12dB per frekuencat 51-102 KHz.

*VIII) Karakteristikat e nderfaqes*
Zbatohet rekomandimi CCITT Rec. 703, paragrafi 6.3.4

*IX) Shuarja*
Shuarja midis pikave fundore te dy permutatoreve (DDFs), duke perfshire dhe kabllot e interkoneksionit nuk do te jete me e madhe se 6dB ne 1024 KHz. Çdo ndryshim qe do te rezultoje nga kjo do te jete objekt i diskutimeve te veçanta midis paleve te interkonektuara.

*X) Struktura e multipleksimit*
Struktura e multipleksimit do te jete sipas rekomandimeve G.732 te CCITT dhe gjithashtu sipas rekomandimeve G.704, G.705.Q.511 ne lidhje me centralet numerike.

*XI) Wander dhe Jitter*

Do te zbatohen paragrafet 2 dhe 3 te rekomandimit G.823 te CCITT.

*XII) Intervali kohor Zero*

Zbatohet Rekomandimi G.704 paragrafet 2.3.1 dhe 2.3.2. Perdorimi i pajisjeve qe kane te bejne me shifren 8- binare ne menyren e pershkruar, do te jete objekt i marreveshjes se operimit.

*XIII) Kushtet e gabimeve dhe efekteve pasuese*

Zbatohen dispozitat e rekomandimit G.732.

*XIV) Kodimi i intervaleve kohore (kanaleve)*
Kanalet e intervaleve kohore me shpejtesi 64 Kbit/s te cilet formojne sekuencen prej 2048 Kbit/s do ta trasferojne informacionin e koduar sipas ligjit A siç percaktohet ne rekomandimin G.711.

*XV) Sekuenca e pozicionimit te biteve te kanalit ne qetesi*

Sekuenca e pozicionimit te bit-eve te kanalit ne qetesi ne te dy drejtimet do te jete 01010100 (shifra me e rendesishme ne ekstremin e majte) sipas paragrafit 2.12 te rekomandimit Q.522.

*XVI) Devijime nga Rekomandimet*

Ne qofte se gjate fazes se zbatimit ose ne te ardhmen vihet re nje devijim nga Rekomandimet



C1 Public

dhe/ose Standartet nga palet, te dy shoqerite duhet te bashkeveprojne sa me shume qe te jete e mundur per te zgjidhur problemin qe ka te beje me permbushjen e rekomandimeve te ITU.

### 4.2.3 Rrugezimi i Trafikut

4.2.3.1 Interkoneksioni mes Vodafone Abania dhe Operatorit Perfitues konsiston ne lidhjen e drejtperdrejte midis njerit prej 2 (dy) centraleve te Vodafone Albania, MSCTIR01 dhe MSCTIR02, dhe centraleve te Operatorit Perfitues.

4.2.3.2 Sa here te jete e nevojshme, Operatori dergues njofton Operatorin tjeter mbi planet e tij te rrugezimit. Permes konsultimit te perbashket, Palet do te vendosin nese do te vazhdojne te perdorin rruget aktuale te interkoneksionit apo do te vendosin lidhje ose nyje te reja.

4.2.3.3 Ne çdo rast, kur mes paleve ka dy ose me shume Pika Interkoneksioni, atehere dy operatoret do te miratojne marreveshje specifike rrugezimi. Plani i rrugezimit do te permbaje te dhena lidhur me zgjedhjen e pare dhe te dyte te rrugeve, si dhe zgjedhjet e rruges ne kushte anormale te rrjetit.

4.2.3.4 Rajoni te cilit do t'i sherbeje Pika e Interkoneksionit do te miratohet nga te dy Palet bazuar ne parimet e miratuara mes Paleve. Ne rast humbjeje te qarqeve qe formojne nje rruge trafiku interkoneksioni mes paleve, nese palet bien dakord dhe eshte teknikisht e mundur, lejohet ri-rrugezimi permes rrugeve te tjera te interkoneksionit duke u siguruar qe profili normal i trafikut dhe i karakteristikave ne rruget e tjera te interkoneksionit nuk paraqet shtremberim te tepruar te tyre.

4.2.3.5 Dergimi i thirrjeve nga Vodafone Albania ne rrjetin e Operatorit Perfitues dhe anasjelltas, do te behet sipas percaktimeve ne Aneksin V (Numeracioni dhe CLI).

4.2.3.6 Nese Pikat e Interkoneksionit mes Paleve ndryshohen, keto te fundit do te miratojne dhe pershtasin numeracionin e permendur me lart sipas serise numerike dhe dorezim thirrje/zone interkoneksioni.

4.2.3.7 Ri-rrugezimi i trafikut ne kushte jonormale do te behet ne perputhje me marreveshjet e paracaktuara. Operatori Perfitues do te njoftoje Vodafone Albania per ndermarrjen e nje rrugezimi te tille. Ne rast se nje pjese e nje rruge deshton, trafiku do te vazhdoje te ofrohet ne pjesen e mbetur si zgjidhje paresore dhe do te ri-rrugezohet nese nuk gjenden qarqe te lira. Ne rast se kapaciteti i mundshem ne rrugen alternative eshte i pamjaftueshem per te perballuar te gjithe sasine e trafikut, atehere secila Pale duhet te kontaktoje Palen tjeter per te kerkuar marreveshje per te rrugezuar pjesen e ngelur permes rrjetit te tij ne nje Pike Interkoneksioni alternative.

### 4.2.4 Sinjalizimi

4.2.4.1 Sinjalizimi mes Paleve do te jete CCS Nr.7, ne perputhje me standartet e vlefshme dhe te tanishme bazuar ne rekomandimet e ITU-T. Metoda e kapjes se qarkut do te miratohet nga palet gjate fazes se testimit. Te gjitha Pikat e Interkoneksionit do te perkufizohen si dy-drejtimeshe.

4.2.4.2 Kodet Korresponduese te Pikave te Sinjalizmit (SPCs) duhet te shkembehen mes Paleve si kusht paraprak per vendosjen e Interkoneksionit. TSL-16 nga çdo E1 do te perdoret per

SS7 (sinjalizimin ISUP). TSLs 1-15 dhe 17-31 do te perdoren per ofrimin e sherbimeve zanore. Ne rast te kundert Palet vendosin bashkarisht.

4.2.4.3 Standartet e cilesise aktualisht ne funksion dhe karakteristikat e link-eve te interkoneksionit/Pike Interkoneksioni do te perputhen me rekomadimet nderkombetare ITU-T dhe ETSI si me poshte:

ETS 300 008, ETS 300 009, ETS 300 287.
ITU-T rekomandimet :
Q.701 (1993), Q.702 (1988), Q.703 (1996), Q.704 (1996),
Q.705 (1993), Q.706 (1993), Q.707 (1988), Q.711 (1996),
Q.712 (1996), Q.713 (1996), Q.714 (1996), Q.771 (1997),
Q.772 (1997), Q.773 (1997), Q.774 (1997), Q.752 (1997)
ETSI-ISUP (1997) (specifikimet - ITU-T ISUP 97, Q.730-Q.737, Q.761 - Q. 764, Q.850)

4.2.4.4 Nderfaqet elektrike per furnizimin 2,048 Mbit/s do te perputhen me Rekomandimet e ITU, G.703 (HDB3). Rezistenca ne hyrje/dalje te linjave 2,048 Mbit/s do te jete ajo e paraqitur me lart ne paragrafin 4.2.2 te ketij Aneksi.

4.2.4.5 Struktura e 2,048 Mbit/s perfshin kanalet 64 Kbit/s, sipas rekomandimeve G.703 dhe G.704.

4.2.4.6 Ne rastet kur kerkohet nje ndryshim, qofte nga Vodafone Albania apo Operatori Perfitues, ne protokollin e sinjalizimit Pala kerkuese do te jape njoftim paraprak per Palen tjeter. Pala kerkuese do te njoftoje 6 (gjashte) muaj para dates qe do te ndodhe ndryshimi i kerkuar, ne menyre qe te caktohet linja kohore e kerkuar per planifikimin dhe implementimin e ndryshimeve te nevojshme ne rrjetet perkatese, duke perfshire perfundimin e suksesshem te proçedurave te duhura te testimit te interkoneksionit.

### 4.2.5 Pikat e Transferimit te Sinjalit (STP)

4.2.5.1 Linket sinjalizuese te Paleve nderlidhen ne Piken e Transferimit percaktuar nga te dy operatoret ne Zonat e Interkoneksionit te miratuar me pare.

4.2.5.2 Pikat e Sinjalizimit te Vodafone Albania percaktohen ne Marreveshjen e Interkoneksioni mes paleve

### 4.2.6 Kodet e Pikave te Sinjalizimit (SPC)

4.2.6.1 Seria e Kodeve Kombetare te Pikave te Sinjalizimit (SPC) te nyjeve te rrjetit te Vodafone Albania do te shkembehen mes paleve sipas pikes 4.4 ne kete Aneks.

4.2.6.2 Kodet e Pikave te Sinjalizimit dhe Kodet e Qendrave te Komutimit te Vodafone



C1 Public

Albania do te shkembehen mes paleve sipas pikes 4.4 ne kete Aneks.

#### 4.2.7 Kostot e Rrjetit te Sinjalizimit

4.2.7.1 Secila Pale eshte pergjegjese per mbulimin e kostove te sinjalizimit ne rrjetin e vet.

### 4.3 INFORMACION PARAPRAK I OPERATORIT PERFITUES

4.3.1 Bashkengjitur kerkeses per akses/interkoneksion Operatori Perfitues duhet ti siguroje Vodafone Albania informacionin e nevojshem per te mundesuar zgjidhjen teknike dhe komerciale te akses interkoneksionit.

4.3.2 Informacioni i nevojshem eshte si vijon:

- Kopje e Certifikates se Konfirmimit te Njoftimit leshuar nga AKEP ne perputhje me Rregulloren “Per Autorizimin e Pergjithshem”, miratuar me VKD nr. 1774 date 02.02.2012
- Kopje ekstrakti nga Qendra Kombetare e Regjistrimit (QKR)
- Propozim mbi vendodhjen e Interkoneksionit
- Struktura e Rrjetit
- Adresat e nyjeve të komutimit
- Menyra e lidhjes dhe infrastruktura qe do te perdoret per te arritur deri ne piken e interkoneksionit (ose hapesiren e bashkevendosjes)
- Karakteristikat e pajisjes së transmetimit të përdorur për Interkoneksion
- Karakteristikat e pajisjes së komutimit të përdorur për Interkoneksion
- Shërbimet e kërkuara, ne perputhje me kete ORI dhe kuadrin ligjor dhe rregullator: zanore, të dhëna, faks, etj dhe pershkrimin teknik per to, ne perputhje me Certifikaten e Konfirmimit te Njoftimit leshuar nga AKEP
- Seritë numerike që do të përfshihen ne Marreveshje sipas Autorizimit Individual per caktimin dhe perdorimin e numrave dhe serive numerike, leshuar nga AKEP;
- Vetedeklarimin lidhur me aftesine per te kryer rrugezimin e duhur te thirrjeve, sipas percaktimeve te Rregullores “Per Portabilitetin e Numrit”, e ndryshuar
- Parashikimi per trafikun qe do te shkembehet. Parashikimi per trafikun kombetar duhet te jete i detajuar per çdo pike interkoneksioni dhe sherbimi dhe duhet te perfshijne edhe parashikimin per ‘Perpjekjet per Thirrje’ gjate ‘Oreve te Pikut’ dhe ‘Trafikun e oreve te Pikut’ (ne Erlangs)
- Historikun e te dhenave per trafikun e gjeneruar nga abonentet e Operatorit Perfitues (origjinim/terminim) sipas raporteve te dorezuara ne AKEP periodikisht
- Informacionin lidhur me numrin e abonenteve ekzistues te Operatorit Perfitues ne momentin e paraqitjes se kerkeses per interkoneksion, te vertetuar nga evidencat perkatese



C1 Public

- Procedurat dhe sistemet e informacionit qe kane te bejne me trajtimin dhe matjen e treguesve te cilesise, sipas Rregullores per Treguesit e Cilesise se Sherbimit, perfshire ketu Manualin perkates dhe dokumentat perberes, sipas nenit 7 te kesaj Rregulloreje
- Vetedeklarimin mbi ekzistencen ose jo te sistemeve qe mundesojne lejimin e pergjimit nga autoritetet kompetente, sipas legjislacionit ne fuqi per pergjimin telekomunikimeve;
- Masat e marra nga Operatori Perfitues per sigurimin e aksesit pa pengese ne sherbimet e emergjences ne perputhje me seksionin 23 te Aneksit C te Rregullores per Autorizimin e Pergjithshem
- Operatori perfitues duhet te paraqese zgjidhje dhe sisteme qe zoteron te cilat duhet te garantojne rrugezimin e thirrjeve sipas sherbimeve te percakturara ne kete ORI.

4.3.3 Nese informacioni i paraqitur nuk eshte i plote, Vodafone Albania do te njoftoje Operatorin Perfitues per te plotesuar kete informacion sipas afateve dhe procedurave qe parashikon rregullorja per Akses dhe interkoneksion.

4.3.4 Dhenia e Informacionit paraprak te lartpermendur eshte kusht i detyrueshem per fillimin e negociatave te Marreveshjes se Interkoneksionit mes paleve

## 4.4 INFORMACION PARAPRAK PER TU SHKEMBYER MES PALEVE

4.4.1 Palet do te bashkepunojne me mirebesim dhe do te shkembejne informacionin e nevojshem me njeri tjetrin per te mundesuar vendosjen e zgjidhjes se akses/interkoneksionit, si per anen teknike dhe ate komerciale, brenda afateve ligjore.Informacioni i shkembyer do te perfshije te dhenat mbi tipin e sinjalizimit dhe informacionin lidhur me Kodin(et) Kombetar te Pikave te Sinjalizimit, caktuar nga AKEP sipas rekomandimeve te SS7.

4.4.2 Informacioni paraprak i lartpermendur ne kete pike 4.4 se bashku me informacionin e percaktuar ne piken 4.3 te ketij Aneksi eshte kusht i detyrueshem per fillimin e negociatave te Marreveshjes se Interkoneksionit mes paleve

## 4.5 BASHKEVENDOSJA

4.5.1 Vodafone Albania ka detyrimin t'i ofrojë mundësinë Operatorit Përfitues për instalimin e pajisjeve të nevojshme për sigurimin e shërbimeve të përmendura në kete ORI në një vend të bashkëvendosjes.

4.5.2 Vodafone Albania ka detyrimin të ofrojë të pakten nje nga mënyrat e implementimit të bashkëvendosjes të specifikuar në pikat 3, 4, dhe 5 të këtij Aneksi në secilën pikë të rrjetit në të cilën mund të sigurohet aksesi.

4.5.3 Vodafone Albania do te ofroje bashkëvendosje virtuale **vetem në rast se** nuk ka mundësi teknike për të alokuar bashkëvendosjen fizike apo ne distance (ne pikat e interkoneksionit te

Vodafone Albania te permendura ne kete Aneks) për të cilën Operatori Përfitues ka paraqitur një kërkesë. Në rastin e bashkëvendosjes virtuale, stafi i Vodafone Albania do të ekzekutojë instalimin dhe mbikqyrjen e të gjitha pajisjeve të Operatorit Përfitues.

4.5.4 Vodafone Albania alokon hapësirën e bashkëvendosjes fizike në të njejtat ambiente të tij ku ndodhet i instaluar elementi i rrjetit tek i cili sigurohet aksesi sipas prioritetit në vijim:

a) Pa instalime të ndarjeve apo të strukturave te tjera mbrojtëse;

b) Me instalime te një ndarje apo një tjetër strukturë mbrojtëse, e cila kryhet nga operatori ofrues në emër të operatorit përfitues dhe kundrejt një pagese.

4.5.5 Vodafone Albania alokon hapësirën e bashkëvendosjes në distancë në ambientet e tij sipas prioritetit në vijim:

a) Në një dhomë të veçantë, të ndryshme nga ajo në të cilën është instaluar permutatori kryesor apo i ndërmjetëm, ose;

b) Në dhoma të pa-pajisura të Vodafone Albania, instalimi kryhet nga Vodafone Albania me pagesë nga Operatori Përfitues, apo nga vetë Operatori Përfitues me shpenzimet e tij për të pajisur apo përshtatur këto dhoma. Kur Vodafone Albania refuzon të kryejë punët e sipërpërmendura, ai lejon Operatorin Përfitues t'i kryejë ato.

4.5.6 Kur Operatori Përfitues pajis një hapësirë të bashkëvendosjes në ambientet e tij, Vodafone Albania:

a) Ofron një kabëll lidhës të jashtëm. Në rastin kur Operatori Përfitues vendos ta blejë shërbimin prej një operatori tjetër apo ta vendosë kabllin vetë, Vodafone Albania e informon Operatorin Përfitues për mundësinë e përdorimit të tubacioneve të tij apo fasiliteteve të tjera shoqëruese, ose;

b) Ofron një mundësi për të instaluar një sistem antenë për lidhjen e pikës së aksesit me rrjetin, i cili vihet në punë nga Operatori Përfitues përmes radiokomunikimit.

4.5.7 Në rast se bashkëvendosja në pikën e aksesit, e zgjedhur nga Operatori Përfitues, instalohet në mënyrat e përmendura në pikën 4.5.4 b apo 4.5.5.b të këtij neni, Vodafone Albania:

a) Brenda 15 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, në rastet e përmendura në pikën 4.5.4.b apo 4.5.5.b të këtij neni përgatit dhe i paraqet operatorit përfitues vlerësimin e kostove të punimeve (preventivin), të nevojshme për instalimin e bashkëvendosjes;

b) Brenda një afati 36 ditor, në rastin e përmendur në paragrafin 4.5.4.b të këtij neni ose brenda një afati 60 ditor në rastin e përmendur në pikën 4.5.5.b këtij neni që prej momentit të marrjes së miratimit prej operatorit përfitues për vlerësimin e kostove të punimeve, Vodafone Albania e pajis plotësisht hapësirën e bashkëvendosjes.

4.5.8 Në rastet kur bashkëvendosja në një pikë të caktuar bashkëvendosjeje të instaluar me shpenzimet e Operatorit Përfitues në një prej mënyrave të përmendura në pikat 4.5.4.b) dhe 4.5.5.b) të këtij neni, i jepet një tjetër operatori përfitues, Vodafone Albania përcakton rregullat e kompensimit për shpenzimet e bëra nga operatori përfitues që kanë lidhje me procesin e mbushjes së hapësirës së bashkëvendosjes nga operatori i mëparshëm përfitues, në mënyrë që shpenzimet e punës të ndahen në mënyrë përpjestimore ndërmjet operatorëve përfitues sipas hapësirës së bashkëvendosjes së zënë.



C1 Public

4.5.9 Bashkëvendosja virtuale do të realizohet në të gjitha rastet në ambjentet e ofruesit të aksesit pa instaluar ndarje apo struktura të tjera ndarëse, në rast se nuk bihet dakort ndryshe për këtë mes Vodafone Albania dhe operatorit përfitues.

4.5.10 Në të gjitha rastet, përjashtuar ato të përmendura në pikat 4.5.4.b dhe 4.5.5.b të këtij neni, Vodafone Albania do të sigurojë një hapësirë bashkëvendosjeje brenda një periudhe kohore jo më të shkurtër se 15 ditë nga data e nënshkrimit të marrëveshjes se interkoneksionit.

4.5.11 Nëse operatorë përfitues të ndryshëm përdorin bashkëvendosjen në të njëjtat mjedise të Vodafone Albania, Vodafone Albania nuk do të ndalojë operatorët përfitues të vendosin një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet rrjeteve të tyre elektronike të komunikacioneve ose nga përdorimi i përbashkët i pajisjeve

## 4.6 LINK-ET DHE PIKA E INTERKONEKSIONIT

4.6.1 Pika e Interkoneksionit (POI) duhet te jete aty ku Rrjeti i Vodafone Albania lidhet me Rrjetin e Operatorit Perfitues, dhe duhet te jete nje pike fizike ku lidhja te mund te shkeputet ne menyre qe te kryhen teste.

4.6.2 Lidhja fizike midis rrjeteve bazohet ne lidhjen e centraleve perkatese te interkoneksionit te dy rrjeteve nepermjet linkeve dhe qarqeve te interkoneksionit.

4.6.3 Vendodhja e pikes se interkoneksionit per interkoneksionin e bashkevendosjes fizike ne Vodafone Albania, gjendet ne nje nga centralet respektive te Vodafone Albania, ashtu si parashikuar dhe ne Informacionin e Pergjithshem te Vodafone Albania (pika 4.2). Ne te ardhmen mund te caktohen Pika alternative Interkoneksioni te cilat duhet te lajmerohen te pakten 1 (nje) muaj perpara.

4.6.4 Pika e Interkoneksionit e parashikuar per sherbimet e ofruara sipas kesaj Marreveshje Interkoneksioni mund te jete e ndryshme nga pika e interkoneksionit per sherbime te tjera jashte rregullimit te kesaj ORI, kjo ne varesi te kapaciteteve interkonektuese qe disponon Vodafone Albania

4.6.5 Kapaciteti minimal per qarqet dhe linket e interkoneksionit per cdo pike interkoneksioni eshte 2 Mbps apo 1 E1.

4.6.6 Kapaciteti minimal per shtimin e kapaciteteve ne secilen pike interkoneksioni eshte 2 Mbps apo 1 E1

4.6.7 Te dy palet do bien dakord per zgjidhjen duke marre parasysh shtrirjen e interkoneksionit, projektimet e trafikut dhe numrin e linkeve te Interkoneksionit qe duhet te ofrohen ndaj implementimit te interkoneksionit. Operatori Perfitues duhet t'i paraqese Vodafone Albania gjithe faktet e nevojshme qe tregojne kostot e vendosura te linkeve te Interkoneksionit.

4.6.8 Interkoneksioni fillestar do te realizohet mes MSC (qendres se komutimit) se Vodafone Albania vendosur ne Tirane sipas adresave te lartpermendura, dhe qendres se komutimit te Operatorit Perfitues ne vendodhjen perkatese. Te dhenat perkatese do te konsolidohen dhe



C1 Public

pershkruhen ne tabelen e meposhtme.

| Nr. | Kalimi | Linjat me qera (2MBps) | Lloji i sherbimit (siç pershkruhet ne Aneksin II) | Data e Vendosjes |
|---|---|---|---|---|
| 1 | MSC e VODAFONE ALBANIA– SC e Operatorit | ….. | Sherbimi Sherbimi | Data e vendosjes Fillestare |
| | | | | |

4.6.9 Lidhja fizike midis rrjeteve bazohet ne lidhjen e centraleve perkatese te interkoneksionit te dy rrjeteve nepermjet linkeve dhe qarqeve te interkoneksionit.

4.6.10 Pike interkoneksioni do te konsiderohet vendi ku rrjeti i Vodafone lidhet me rrjetin e operatorit Perfitues dhe do te jete pika fizike ku lidhja mund te shkeputet me qellim kryerjen e testeve. Pika e interkoneksionit lidhet me centralet e interkoneksionit Vodafone dhe operatorit perfitues. Vendodhja e pikes se interkoneksionit varet nga forma e interkoneksionit. Per interkoneksionin e bashkevendosur ne Vodafone pikat e interkoneksionit ndodhen ne centralet respektive te Vodafone (MSC ne Tirane).

**4.6.11 Link interkoneksioni (interkonection link)** eshte kapaciteti (rruga-path) e tranmetimit midis pajisjeve te transmetimit (te dy operatoreve) me te aferta me Piken e interkoneksionit, e cila perbehet nga nje numer specifik linkesh 2 Mbps (E1).

Nje **qark interkoneksioni E1**, eshte nje kapacitet E1 tranmetimi qe kalon nga Pika e interkoneksionit midis dy centaleve te interkonektuar, perfshire portat E1 te centraleve(switch).

Kapaciteti minimal per qarqet dhe linket e interkoneksionit per cdo pike interkoneksioni eshte 2 Mbps apo 1 E1.

Kapaciteti minimal per shtimin e kapaciteteve ne secilen pike interkoneksioni eshte 2 Mbps.

4.6.12 VODAFONE ALBANIA ofron nje nga format e lidhjes se interkoneksionit te referuara me poshte.

### a. Interkoneksion i bashkvendosur ne ambientet e Vodafone

Per interkoneksionin e bashkevendosur ne Vodafone, operatori perfitues eshte pergjegjes per sigurimin dhe mirembajtjen e linjes se interkoneksionit deri ne piken e interkoneksionit te Vodafone. Operatori perfitues do te vendose pajisjet e transmetimit ne ambientet e Vodafone sipas kushteve te specifikuara ne marreveshjen e interkoneksionit. Vodafonedo te siguroje lidhjen e pikes se interkoneksionit me centralin e interkoneksionit me kapacitetet dhe portat e nevojshme E1, pa detyrime shtese per operatorin perfitues pervec tarifave te bashkvendosjes dhe sherbimeve



C1 Public

te lidhura me to si energjia elektrike.

**b. Interkoneksioni i bashkevendosur ne ambientet e operatorit perfitues dhe interkoneksioni i ndermjetem**

Per interkoneksionin ne anen e operatorit perfitues dhe interkoneksionin e ndermjetem Vodafone ofron sherbimet e qarqeve te interkoneksionit ne baze te negociatave me operatorin perfitues dhe sipas mundesive qe ka. Tarifimi dhe koha e realizimit vendosen ne negociata midis Vodafonedhe operatorit perfitues, dhe ky informacion i raportohet AKEP se bashku me marreveshjen e Interkoneksionit te lidhur midis paleve.

4.6.13 Te dyja Palet bien dakord qe numri i linkeve te Interkoneksionit qe do te perdoren dhe dimensionimi i interkoneksionit varet nga parashikimi i projektimit te trafikut, i analizuar ne Aneksin V.

4.6.14 Palet do te bashkepunojne ne mirebesim per vendosjen e zgjidhjes me fitimprurese te Interkoneksionit per te dyja Palet, si per anen teknike dhe ate komerciale.

4.6.15 Aneksi II (Sherbimet e Interkoneksionit) shpjegon ne detaje Sherbimet e Interkoneksionit te ofruara nga Vodafone ne kete marreveshje ne perputhje me ORI. Keto sherbime perfshijne perkufizimin dhe pershkrimin e çdo Sherbimi Interkoneksioni te ofruar nga Vodafone.

## 4.7 PLANIFIKIMI I RRJETIT

4.7.1 Vodafone Albania informon dhe informohet sipas procedurave te parashikuara ne kete ORI per planet lidhur me çeshtjet e meposhtme:

I) Vendosje ose nderprerje te Pikave te Interkoneksionit

II) Ndryshimet ne kapacitete e lidhjes ne Pikat e Interkoneksionit

III) Ndryshimet ne rrugezimin e trafikut, qe jane me rendesi per sherbimet e interkoneksionit

IV) Ndryshimet ne konfigurimin e sinjalizimit te rrjetit dhe sinjalizimit te rrugezimit te trafikut

V) Ndryshime te tjera te rrjetit, qe jane me rendesi per sherbimet e interkoneksionit

## 4.8 MATJET DHE TESTET



C1 Public

4.8.1 Testimi i pikave te interkoneksionit duhet te kryhet ne perputhje me matjet dhe kontrollet e bazuara ne standartet nderkombetare (ETSI, ITU-T) dhe specifikimet perkatese te marreveshjes se interkoneksionit bazuar ne kete Oferte Reference. Keto te fundit, te aprovuara nga te dyja Palet, do te jene te nevojshme ne menyre qe te monitorohet funksionimi sa me i mire i interkoneksioneve perkatese.

4.8.2 Matjet dhe testimet qe do te zbatohen ne pikat e interkoneksionit kane si qellim qe te sigurojne integritetin e rrjetit, nderveprimin e rrjetit dhe cilesine e duhur te sherbimit.

4.8.3 Matjet dhe testet duhet te kryhen ne rastet e meposhtme:

a. Interkonektimit te pare mes rrjetit te Vodafone Albania dhe rrjetit te Operatorit Perfitues.
b. Instalimi i nje nyje te re komutimi qe ka lidhje me interkoneksionin mes paleve
c. Rritje e kapacitetit komutues te transmetimit, sinjalizimit dhe STP-ve.
d. Per gjithçka tjeter te rene dakord nga te dyja Palet.

4.8.4 Proçedura e detajuar e testit dhe kohezgjatja e tij duhet te percaktohet bashkarisht nga Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues dhe duhet te perfshije:

a. Matjet dhe testet e nevojshme ne pikat e interkoneksionit,
b. Pikat e interkoneksionit ne te cilat duhet te kryhen matjet dhe testet, si edhe afatet kohore,
c. Linket e interkoneksionit qe duhet te perdoren,
d. Software-t qe duhen perdorur,
e. Kohezgjatja e testit dhe iniciatives per matje,
f. Numri i testeve qe do te kryhen,
g. Seria e testeve te kryera.
h. Matja dhe rakordimi i thirrjeve bazuar ky mbi te dhenat e CDR-ve te te dy paleve.
i. Rakordimi i fushave specifike te CDR-ve te seciles pale qe mbartin te njejtin informacion sic jane (A-party, B-party, kohezgjatja, koha e fillimit te bisedes, koha e perfundimit te bisedes)
j. Identifikimi dhe njohja nga secile pale e fushave respektive te CDR-ve qe mbartin informacionin e identifikimit te interkoneksionit sic eshte route name (Emri i linkut)

4.8.5 Matjet dhe testet e kryera do te regjistrohen ne qendrat e komutimit si te Vodafone Albania ashtu edhe te Operatorit Perfitues, ne menyre qe te bashkerendohen te dhenat e te dyja Paleve. Informacioni i duhur duhet t'i komunikohet Pales tjeter brenda 3 (tre) diteve pune pas perfundimit te testit.

4.8.6 Periudha e matjeve dhe kontrolleve nuk duhet te kaloje 5 (pese) dite per çdo pike interkoneksioni, duke e nisur numerimin nga data e perfundimit te instalimeve, deri atehere kur lidhjet perkatese te interkoneksionit te jene te disponueshme per funksionimin prove.

4.8.7 Funksionimi i interkoneksionit duhet te nise pasi dokumenti i duhur te jete nenshkruar mes Paleve dhe pas perfundimit me sukses te testeve dhe matjeve te

interkoneksionit, dhe vetem pasi te jete konfirmuar saktesia e matjes se trafikut ne piken e interkoneksionit.



C1 Public

# ANEKSI V
# NUMERACIONI DHE CLI

## 5.1 NUMERACIONI

5.1.1 Vodafone Albania dhe operatori perfitues do marrin masa per Implementimin e planit kombëtar të numeracionit në rrjetet e tyre respektive dhe kryerjen e të gjitha ndryshimeve në rrjet dhe punë të tjera të lidhura me implementimin e numrave, duke lidhur rrjetat e pa-interkonektuar dhe ato të interkonektuar (me shpenzimet e veta), jo më vonë se 45 dite nga marrja e kërkesës nga operatori përfitues/ Vodafone Albania për të siguruar vënien ne pune të serive numerike caktuar nga AKEP.

5.1.2 Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues duhet t'i sigurojne njeri-tjetrit, sa here t'iu kerkohet, detaje te serive numerike aktive dhe do te jene te detyruar ta keshillojne njeri-tjetrin here pas here per hapjen e serive te reja numerike ne perputhje me Planin Kombetar te Numeracionit te aprovuar nga AKEP dhe miratimit perkates te AKEP per secilen Pale.

5.1.3 Secila Pale do te perdore serite numerike per te cilen ka marre autorizimin perkates nga AKEP. Kodi i rrjetit dhene nga AKEP (69 per Vodafone Albania) dhe informacioni i perditesuar i databazes qendrore ne perputhje me Rregulloren per Portabilitetin do te perdoret per te mundesuar rrugezimin e thirrjeve drejt Vodafone Albania.

5.1.4 Plani Numeracionit – Detyrimet e Vodafone Albania

5.1.4.1 Vodafone Albania do te marre gjithe masat e nevojshme per rrugezimin korrekt te thirrjeve te rrjetit te Operatorit Perfitues. Kostot e perfshira ne kete rrugezim do t'i lindin eksluzivisht Vodafone Albania.

5.1.4.2 Vodafone Albania nuk do te lejoje thirrje hyrese nderkombetare, te rrugezohen nga rrjeti i Vodafone Albania ne rrjetin e Operatorit Perfitues nepermjet kapaciteteve qe jane objekt i Marreveshjes se Interkoneksionit lidhur sipas kesaj ORI, pasi thirrjet hyrese nderkombetare nuk jane objekt i ORI

5.1.4.3 Ne rast se thirrjet tranzit kombetare nuk mbulohen nga Marreveshja e Interkoneksionit bazuar ne kete ORI, Vodafone Albania nuk do te lejoje thirrje te ardhura nga Perdorues te Operatorit Perfitues te rrugezohen permes rrjetit te Vodafone Albania ne rrjete te tjera telefonike. Ky sherbim do te jete objekt i nje kontrate tjeter ose do modifikoje Marreveshjen aktuale.

5.1.4.4 Serite numerike te Vodafone Albania te perdorura per ofrimin e sherbimeve te interkoneksionit te Aneksit II jane paraqitur me poshte.

5.1.5 Plani Numeracionit – Detyrimet e Operatorit Perfitues

5.1.5.1 Operatori Perfitues do te marre gjithe masat e nevojshme per rrugezimin korrekt te thirrjeve te rrjetit te Vodafone Albania. Kostot e perfshira ne kete rrugezim do ti lindin eskluzivisht Operatorit Perfitues.



C1 Public

5.1.5.2 Operatori Perfitues nuk do te lejoje thirrje hyrese nderkombetare, te rrugezohen nga rrjeti i Operatorit Perfitues ne rrjetin e Vodafone Albania, nepermjet kapaciteteve qe jane objekt i Marreveshjes se Interkoneksionit lidhur sipas kesaj ORI, pasi thirrjet hyrese nderkombetare nuk jane objekt i ORI.

5.1.5.3 Ne rast se thirrjet hyrese kombetare tranzit nuk mbulohen nga kjo Marreveshje, Operatori Perfitues nuk do te lejoje thirrje te ardhura nga Perdorues te Vodafone Albania te rrugezohen permes rrjetit te Operatorit Perfitues ne rrjete te tjera telefonike. Ky sherbim do te perbeje objektin e nje kontrate tjeter ose modifikimin e Marreveshjes aktuale.

5.1.5.4 Serite numerike te Operatorit Perfitues te perdorura per ofrimin e sherbimeve te interkoneksionit te Aneksit II jane paraqitur me poshte.

5.1.6 Ne rast se AKEP ose nje autoritet tjeter kompetent vendos mbi disa modifikime te Planit Kombetar te Numeracionit, ose ne rast se ndonjera nga Palet ndryshon planin e saj te numeracionit, secila Pale do te mbarte shpenzimet lidhur me adaptimin e rrjetit te vet.

5.1.7 Vetem serite numerike te autorizuara nga AKEP dhe te njoftuara me shkrim paraprakisht nga palet formojne pjese te kesaj Marreveshje. Secila Pale merr persiper te mos dergoje ne rrjetin e Pales tjeter thirrje qe vijne nga seri te tjera numeracioni perveç atyre qe jane njoftuar me shkrim te pakten 45 dite para kohes se planifikuar per implementim, edhe nese ato jane pjese e Autorizimit te Numeracionit ne pronesi te Paleve perkatese. Kjo aplikohet edhe per serite numerike te autorizuara nga AKEP te operatoreve te trete, thirrjet e te cileve tranzitohen rregullisht ne rrjetin e Vodafone Albania nepermjet Operatori perfitues. Cdo njoftimi paraprak me shkrim per implementimin e serive te reja numerike, palet duhet qe ti bashkengjisin kopjen e Vendimit te AKEP per alokimin e serive te tilla ne perdorim operatorit ne fjale.

5.1.8 Serite numerike ne perdorim per sherbime te reja/shtese ne kete Marreveshje do te miratohen nga te dy Palet, sipas dispozitave te permbajtjes kryesore te kesaj Marreveshje. Atehere, Marreveshja do te modifikohet ne perputhje me rastin perkates.

5.1.9 Asnje nga Palet nuk do te perdore, pa marre me pare miratimin me shkrim nga Pala tjeter, serite numerike per nje sherbim interkoneksioni te veçante ne kete Marreveshje, per te patur akses ne sherbime te tjera te paperfshira ne kete Marreveshje. Secila Pale ka te drejten te kufizoje aksesin ne cdo kohe te Perdoruesve te vet ndaj numrave qe i perkasin Pales tjeter per sherbimet e pamiratuara ne kete Marreveshje.

5.1.10 Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues do te informojne njeri-tjetrin me shkrim te pakten 45 dite para implementimit te planifikuar lidhur me numrat apo serite numerike te akorduar, per te mundesuar pershtatjen rrjeteve perkates ne kohe.

5.1.11 Dergimi i thirrjeve nga Operatori Perfitues drejt rrjetit te Vodafone do te kryhet sipas serive numerike vijuese te Vodafone:

| Gjatesia<br>(Nr. i dixhiteve) | Serite Numerike | Lloji i numrit |
|---|---|---|



C1 Public

| | |
|---|---|
| I.<br>0 69 xx xxxxx<br>(pervec numrave te cilat jane portuar ne rrjetet e operatoreve te tjere)<br>II.<br>Numra te serive numerive te alokuar operatoreve te tjere celulare ne RSH, 06Y xx xxxxx, por te portuar ne rrjetin Vodafone Albania | Abonent/perdorues |
| 069 100 135 | Sekretaria telefonike |
| 069 140<br>069 149 | Kujdesi per Klientin |
| 069 142 | Rimbushja e kreditit (Rimbushja me Parapagim) |

Operatori Perfitues duhet te kryeje analizen e numrave dhe te dergoje thirrje drejt Vodafone Albania duke përfshirë kodin e rrugëzimit 9902 të alokuar nga AKEP për Vodafone, ne perputhje me rregulloren e portabilitetit te numrit.

5.1.12. Dergimi i thirrjeve nga Vodafone tek rrjeti i Operatorit Perfitues do te kryhet sipas serive numerike te Operatorit Perfitues si me poshte:

| Gjatesia<br>(Nr. i dixhiteve) | Serite Numerike | Lloji i numrit |
|---|---|---|
| I.<br>Serite numerike te operatorit perfitues te alokuar nga AKEP<br>(pervec numrave te portuar ne rrjetet te tjera)<br>II.<br>Numra qe nuk i perkasin serive numerike te alokuar nga AKEP Operatorit perfitues, por qe jane portuar ne rrjetin Operatori Perfitues. | | Numer Gjeografik – Rajoni XXXX |

Vodafone duhet te kryeje analizen e numrave dhe te dergoje thirrje drejt Operatorit Perfitues duke përfshirë kodin e rrugëzimit ________ të alokuar nga AKEP për Operatorin Perfitues, ne perputhje me rregulloren e portabilitetit te numrit.

5.1.13 Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues koordinojne, ne kohe, gjithe aktivitetet e nevojshme me organizatat e tjera te telekomunikacionit (ne nivel kombetar dhe nderkombetar) me te cilat ata bashkepunojne, ne menyre qe te sigurojne operim te rregullt te serive numerike te aktivizuara, duke respektuar daten e planifikuar te aktivizimit.

5.1.14 Rajoni gjeografik i çdo serie numerike te caktuar Operatorit Perfitues si dhe dergimi i thirrjeve/pike interkoneksioni nga Vodafone Albania te Operatori Perfitues eshte paraqitur ne tabelen e meposhtme:

| Serite numerike | Zona – Pika e Interkoneksionit |
|---|---|
| XXXX | |

## 5.2 IDENTIFIKIMI I NUMRIT THIRRES (CLI)

5.2.1 Shfaqja e identitetit te numrit thirres (CLI) duhet te perputhet me te gjitha kerkesat e Ligjit 9918 dhe Rregullores per Aksesin dhe Interkoneksionin (e ndryshuar).

5.2.2 Ne momentin kur njera Pale percjell thirrjet ne rrjetin e Pales tjeter, eshte e detyruar te transmetoje Identitetin e Numrit Thirres, pa e ndryshuar ose fshehur ate, duke perdorur protokollin e sinjalizimit CCS Nr.7.

5.2.3 Ne thirrjet kombetare, formati i numrit te Pales thirrese qe do te prezantohet ne ekranin e pajisjes fundore te abonentit do te jete Kodi Nderkombetar i Shtetit te Shqiperise, shoqeruar me Numrin Perkates Kombetar (siç percaktohet ne planin e numerimit) te abonentit thirres. Pra per thirrjet kombetare duhet te aplikohet formati +355+NDC+SN, ku NDC eshte Kodi i Drejtimit Kombetar (National Destination Code) ose Kodi i Drejtimit te Rrjetit (*Network Destination Code*) dhe SN eshte numri i perdoruesit thirres.

5.2.4 Per thirrjet e gjeneruara nga rrjeti i VODAFONE ALBANIA dhe te percjelle tek operatori perfitues, Vodafone Albania do te transmetoje gjithmone CLI e cila do te jete sipas serive numerike alokuar Vodafone Albania, perfshire ato te pajtimtareve te portuar ne rrjetin e Vodafone Albania..

5.2.5 Per thirrjet e gjeneruara nga rrjeti i Operatorit Perfitues dhe te percjelle tek Vodafone Albania, Operatori Perfitues do te transmetoje gjithmone CLI e cila do te jete ne formen +355+NDC+SN, ku NDC eshte Kodi i Drejtimit Kombetar (National Destination Code) ose Kodi i Drejtimit te Rrjetit (*Network Destination Code*) dhe SN eshte numri i perdoruesit thirres. CLI do t'i prezantohet rrjetit te Vodafone Albania edhe per thirrjet qe mund te tranzitohen rregullisht nga rrjeti i operatorit perfitues dhe te percjella per terminim ne rrjetin Vodafone Albania..

5.2.6 CLI duhet qe gjithmone te paraqese numrin korrekt te pikes fundore te rrjetit publik ne te cilin eshte origjinuar thirrja. Ky numer eshte nje numer i cili eshte alokuar nga AKEP.

5.2.7 Secila Pale garanton rrugezimin transparent te Informacionit te Identitetit te Numrit Thirres, pa e ndryshuar, modifikuar ose fshehur, permes rrjetit te saj dhe dergimin e Identitetit te Numrit Thirres ne rrjetin e Pales tjeter. Te dy Palet jane te detyruara te shkembejne trafikun ndermjet rrjeteve permes nje interkoneksioni te drejtperdrejte dhe te perjashtojne rrugezimin e thirrjeve permes zgjidhjeve anashkaluese/periferike, siç mund te

jene Portat-GSM apo pajisje te tjera qe mund te rezultojne ne demtime te cilesise, mbingarkese te rrjetit dhe probleme te sigurise.

5.2.8 Çdo ndryshim/modifikim apo fshehje te Identitetit te Numrit thirres perben nje shkelje te kushteve te marreveshjes ne fjale si dhe nje shkelje ligjore. Në rastet kur një nga palet në bazë të provave që disponon fakton se pala tjetër modifikon apo fsheh CLI e thirrjeve të përcjella nga kjo palë, pala jo ne shkelje ka të drejtë qe ne perputhje me Rregulloren per Aksesin dhe Interkoneksionin, të paralajmërojë me shkrim palen tjeter duke njoftuar njëkohësisht dhe AKEP-in, për pezullimin e ofrimit të shërbimeve të interkoneksionit, nëse në mënyrë të menjëhershme dhe në çdo rast jo më vonë se brenda një afati prej 24 orësh nga marrja e njoftimit, nuk ndërpritet shkelja e konstatuar. Në njoftimin e dërguar përfshihen provat që faktojnë shkeljen e pretenduar, seritë numerike të cilat janë keqpërdorur, si dhe masa e pezullimit që do të merret nga operatori ankimues nëse shkelja nuk ndërpritet brenda afatit të caktuar. Pala në shkelje duhet të ndërprese menjëherë shkeljen e njoftuar dhe në çdo rast jo më vonë se brenda një afati prej 24 orësh te njoftoje Palen tjeter. Nëse pala ne shkelje pretendon se nuk ka kryer asnjë shkelje, atehere duhet të paraqesi kundërshtimet dhe provat e saj pranë pales jo ne shkelje dhe AKEP, duke i njoftuar paraprakisht në rrugë elektronike dhe brenda 5 ditëve kalendarike të paraqesi provat që disponon.

5.2.9 Pala e njoftuar për shkeljen ka detyrimin që të përgjigjet kundrejt njoftimit të marrë menjëherë dhe ne cdo rast jo me vone se 24 ore nga njoftimi. Ne rast mos pergjigje pala jo ne shkelje pezullon ofrimin e shërbimeve të interkoneksionit ne perputhje me afatin ne njoftimin e bere

5.2.10 Në cdo rast, nese pala e njoftuar për shkeljen nuk e ndërpret shkeljen brenda afatit të caktuar në njoftim, atëhere pala jo ne shkelje pezullon ofrimin e shërbimeve të interkoneksionit ne perputhje me njoftimin e bërë

5.2.11 Nëse pala e njoftuar për shkeljen kthen pergjigje brenda 24 oresh duke pretenduar se nuk e ka kryer shkeljen, por nuk paraqet provat që vërtetojnë pretendimin e tij brenda afatit 5 ditor, atëhere pala jo ne shkelje pezullon ofrimin e shërbimeve të interkoneksionit ne perfundim te afatit 5 ditor nga njoftimi i dhene per shkeljen.

5.2.12 Nëse pala e njoftuar për shkeljen kthen pergjigje brenda 24 oresh duke pretenduar se nuk e ka kryer shkeljen, dhe paraqet provat per pretendimin e tij brenda afatit 5 ditor, atëhere do te veprohet sipas percaktimeve te Rregullores se Akses dhe Interkoneksionit.

5.2.13 Pala në shkelje është përgjegjës për shkeljen e kryer nëse provat e paraqitura prej operatorit të dëmtuar vërtetohen nga AKEP dhe për këtë me vendim të arsyetuar e ndëshkon atë me masa administrative në përputhje me përcaktimet ligjore për këtë qëllim

5.2.14 Pala që pretendon shkeljen është përgjegjës nëse pretendimet e tij për shkelje nuk vërtetojnë shkeljen e pretenduar. Në një rast të tillë AKEP me vendim të arsyetuar vendos masa administrative kundrejt kesaj pale;



C1 Public

5.2.15 Secila nga palët ka të drejtë që t'i drejtohet AKEP-it për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 120 të ligjit nr. 9918 dhe Rregullores "Për procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve" miratuar me Vendim të Këshillit drejtues te AKEP si dhe Gjykatës kompetente për të apeluar vendimin e AKEP-it.

5.2.16 Pala qe merr Identitetin e Numrit Thirres do ta perdore vetem per qellimet e meposhtme:

- Rrugezim / Faturim te thirrjeve dhe matjeve statistikore.
- Prezantim i Identitetit te thirresit – Prezantim i Identitetit te Numrit Thirres (CLIP) per aq kohe sa nuk eshte aktivizuar nga perdoruesi thirres Fshehja e Identitetit te Numrit Thirres (CLIR).

5.2.17 Ne rastet e aktivizimit te CLIR nga abonenti thirres, operatori i ketij abonenti duhet ti percjelle CLI operatorit te interkonektuar me te.

5.2.18 Te gjithe operatoret duhet te respektojne, per aq sa eshte teknikisht e mundshme, rekomandimet perkatese te ITU dhe Udhezimin (02)051 te ETP (European Telecom Platform) per CLI

# ANEKSI VI

## PROÇEDURA E PARASHIKIMIT TE KAPACITETIT TE INTERKONEKSIONIT

6.1 Palet ofrojne parashikimet e trafikut per qellime te planifikimit te rrjetit per te siguruar kapacitetet e duhura te komutimit dhe transmetimit.

6.2 Per planifikimin fillestar te kapacitetit, palet do te shkembejne çdo vit parashikimet e trafikut per piken e interkoneksionit dhe sherbimet e interkoneksionit sipas kesaj Marreveshje, te shkeputura gjate intervaleve 3 mujore.

6.3 Ne çdo rast, perpara lançimit komercial te interkoneksionit, duhet te kryhen proçedurat e matjes dhe testimit te paraqitura ne Aneksin IV (Karakteristikat e Pergjithshme te Interkoneksionit) te Marreveshjes se Interkoneksionit bazuar ne kete ORI.

6.4 Palet duhet te takohen rregullisht te pakten tre (3) here ne vit ne menyre qe t'i bejne te ditur njeri-tjetrit parashikimet vjetore per trafikun e interkoneksionit te shkeputur gjate intervaleve 3-mujore, ne menyre qe interkoneksioni te perballoje ne menyre efikase zgjerimet e mundshme te kapacitetit dhe dimensionimit.

6.5 Parashikimet do te analizohen ne menyre te vecante per çdo pike interkoneksioni dhe sherbimi, dhe duhet te perfshijne edhe parashikimin per 'Perpjekjet per Thirrje' gjate 'Oreve te Pikut', 'Trafikun e oreve te Pikut' (ne Erlangs) si dhe numrin e parashikuar te qarqeve 2 Mbit/sek.

6.6 Te gjitha parashikimet e trafikut do te vleresohen gjate takimeve te caktuara mes perfaqesuesve teknike te te dyja Paleve, ku do te bihet dakord bashkarisht rreth vendimeve per zbatimin e parashikimeve.

6.7 Qellimi i parashikimit/planifikimit te kapacitetit eshte mbajtja si nje perqindje mesatare e perdorimit te interkoneksionit mes 65%-75% ne oret e pikut ne nje dite te zakonshme (perveç rasteve te situatave emergjente dhe festave).

6.8 Secila nga Palet mund te inicioje nje kerkese per zgjerim te kapacitetit ekzistues apo vendosjen e nje pike te re interkoneksioni mes rrjeteve. Kushti paraprak per instalimin e Qarqeve te interkoneksionit eshte paraqitja e kerkeses se duhur per trafik mbi baza objektive dhe qe duhet te jete e provuar nga historiku i trafikut per nje periudhe kohe te arsyeshme, sic eshte rene dakord mes paleve. Ne te tilla raste perdorimi i zakonshem i kapacitetit te interkoneksionit gjate oreve te pikut duhet t'i kaloje 75%.

6.9 Kapaciteti i zgjerimit do te jete ai i negociuar midis paleve ne mirebesim dhe sipas kesaj ORI dhe MI se lidhur midis paleve dhe ne çdo rast kapaciteti minimal i zgjerimit nuk do te jete me pak se 2Mbps. Pala kërkuese ka detyrimin që bazuar në parashikimin për kapacitete të nevojshme shtesë dhe të rënë dakort midis palevë, të bëjë një **Kërkesë Porosi për Kapacitetet Shtesë** palës ofruese 3 muaj përpara afatit të implementimit, në rastin e



C1 Public

shtimit të portave E1 në POI e VODAFONE (për rastet e tjera palët vendosin në negociata për afatet e realizmit dhe kryerjes së porosisë). Porosia duhet të jetë e detajuar sipas pikave të interkoneksionit, dhe koha minimale për përdorimin e kapaciteteve shtesë do të jetë 12 muaj. Në rast se pala ofruese nuk bie dakort pjesërisht për parashikimet e palës kërkuese, pala ofruese realizon kërkesat për pjeset e rëna dakort, ndërsa pala kërkuese rishikon pjeset jo të rëna dakort. Në rast se palët nuk bien dakort me parashikimet, mosmarrëveshja raportohet në AKEP, brenda 15 ditëve.

6.10 Ne rastet kur perdorimi i kapaciteve te dhena operatorit nuk shfrytezohen ne optimum dhe ka mundesi per reduktim te numrit te E1-ve ne dispozicion, d.m.th trafiku total qe shkembehet ne kapacitetet e dhena (numri i E-1-ve) eshte me pak se 40% i kapacitetit total ne 3 (tre) muajt e fundit dhe/ose ky trafik mund te realizohet ne nje numer me te vogel kapacitetesh (E1), duke ruajtur nivelin e perdorimit 65-75% ne oret e pikut ne nje dite te zakonshme (perveç rasteve te situatave emergjente dhe festave), Vodafone do te njoftoje palen tjeter per t'i propozuar reduktimin e tyre pas 30 diteve. Palet do te zhvillojne nje takim brenda 10 diteve pas marrjes se njoftimit. Nese palet nuk bien dakort, secili operator ka te drejte t'i drejtohet AKEP per zgjidhje mosmarreveshje, brenda 10 diteve nga deshtimi i bisedimeve.

6.11 Kapacitetet e interkoneksionit mes paleve duhet te vendosen paraprakisht dhe ne menyre qe te lehtesohet implementimi i interkoneksionit, duhet te plotesohet tabela e meposhtme:

| ***Numri i portave te VODAFONE ALBANIA*** | ***SLC*** | ***Kanali i Transmetimit (Microvale, Fiber Optike etj)*** | ***Lloji i sherbimit*** | ***Numri i Portave te Operatorit Perfitues*** | ***CIC*** |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |

6.12 Shpjegimi per çdo pike te tabeles eshte si me poshte:

- *Numri i Portave te Vodafone Albania* - Numri i portave ne centralin e Vodafone Albania
- *SLC* - Kodi Lidhes i sinjalizimit
- *Kanali i Transmetimit* **-** Numri i kanaleve, vendndodhja dhe pershkrimi i pajisjes perkatese
- *Numri i portave te Operatorit Perfitues* **-** Numri i portave ne centralin e Operatorit Perfitues
- *CIC* - Kodi i Identitetit te Qarkut
- *Lloji i sherbimit* – Lloji i sherbimit te interkoneksionit dhe kapaciteti perkates i vendosur ne dispozicion

6.13 Palët do të aplikojne sanksionet e percaktuara ne SLA apo vendosin në negociata detyrimet respektive për kompensim të njera tjetrës për rastet kur:

**1.** kapacitetet shtesë të porositura nuk implementohen nga pala ofruese brenda afatit 3 mujor;
**2.** kapacitetet shtesë implementohen nga pala ofruese por pala kërkuese nuk i dëshiron më,
**3.** gjatë afatit 3 mujor porosia anullohet nga pala kërkuese.
**4.** Operatori kerkon reduktimin e kapaciteteve (numrit te E1-ve) para afatit minimal 12 mujor te perdorimit tyre.



C1 Public

# ANEKSI VII

# GARANCIA BANKARE

Data [sheno daten]

Per: **VODAFONE ALBANIA**
Autostrada Tirane-durres, Rruga "Pavaresia", nr.61, Kashar,Tirane, Shqiperi

Ne perputhje me dispozitat e Marreveshjes se Interkoneksionit lidhur ne date [sheno daten] (ketej e tutje *Marreveshja*) mes Vodafone Albania sha (ketej e tutje *Vodafone Albania*) dhe subjektit [sheno emrin e subjektit] me seli ne adresen _____________ (ketej e tutje *Operatori Perfitues*), dhe konkretisht me nenin 21 (Garancia Bankare) te kesaj *Marreveshje*;

*Operatori Perfitues*,

1. do te depozitoje prane *Vodafone Albania* nje Garanci Bankare per te garantuar permbushjen e detyrimeve ne lidhje me sherbimin e trafikut kombetar, subjekt i se cilit eshte kjo Garanci Bankare, nga ana e tij me korrektesi dhe perkushtim, ne baze te percaktimeve te *Marreveshjes* se mesiperme, ne vleren prej [sheno vleren ne Lek] Lek, qe cila perfaqeson pagesen qe do te kryhet nga *Operatori Perfitues*, ne perputhje dhe zbatim te nenit 21 (Garancia Bankare) te kesaj *Marreveshje*.

2. Ne, (Banka), ne baze te udhezimeve te *Operatori Perfitues* biem dakort pa kushte dhe ne menyre te pakthyeshme qe si detyruesi kryesor, dhe jo vetem si pale garante, te garantojme, ne rast shkelje nga ana e *Operatori Perfitues* te ndonjerit prej detyrimeve te tij qe rrjedhin nga kjo *Marreveshje*, pagesen kundrejt *Vodafone Albania* me kerkesen e saj te pare, pa patur asnje lloj te drejte per kundershtim nga ana jone dhe pa kerkuar miratim paraprak nga *Operatori Perfitues*, ne shumen prej [sheno vleren ne Lek] Lek.

3. Kjo Garanci Bankare do te jete e vlefshme per nje periudhe 12 (dymbedhjete) muaj duke filluar nga dita e nenshkrimit te Marreveshjes mes Vodafone dhe Operatorit Perfitues dhe do te rinovohet (do te dorezohet nje e re) nje muaj perpara afatit te vlefshmerise se saj, sipas percaktimeve ne MI.

4. Shuma ne Garancine Bankare do te rishikohet sipas percaktimeve te nenit 21 te *Marreveshjes*.

5. Ne rastin e zgjidhjes apo perfundimit te kontrates mes paleve para afatit te vlefshmerise se garancise, Garancia Bankare do 'ti kthehet *Operatori Perfitues*, pasi ky i fundit t'i kete bere nje kerkese me shkrim *Vodafone Albania* per lirimin e kesaj Garancie. Ne kete rast, Ne (Banka) garantojme qe Garancia Bankare do te zhbllokohet vetem pasi *Vodafone Albania* te n'a konfirmoje me shkrim se *Operatori Perfitues* ka shlyer te gjithe detyrimet qe rrjedhin nga *Marreveshja*, subjekt i se ciles eshte kjo Garanci Bankare.

Nenshkrimi dhe Vula:
Emri i Bankes
Adresa:



C1 Public

# ANEKSI VIII:

# PERSONAT E KONTAKTIT

| OPERATORI PERFITUES | PERSONAT E KONTAKTIT | VODAFONE ALBANIA |
|---|---|---|
| | | |
| | **Per ceshtjet e pergjithshme te Interkoneksionit** | **Esmeralda Korini** |
| | MOBILE | +355 69 222 3102 |
| | FAX | +355 4 228 3339 |
| | EMAIL | Oltion.xhezo@vodafone.com |
| | | |
| | **Per ceshtjet e vendosjes se interkoneksionit (set-up)** | **Nikoleta Dervishi** |
| | MOBILE | +355 69 222 3467 |
| | FAX | +355 4 228 3593 |
| | EMAIL | Nikoleta.dervishi@vodafone.com |
| | | |
| | **Per ceshtjet e Shfrytezimit dhe Mirembajtjes** | **Heraldo Menekshi** |
| | | +355 69 222 3312 |
| | FAX | +355 4 228 3509 |
| | EMAIL | Tirana.mtx@vodafone.com |
| | | |
| | **Per ceshtjet e Faturimit dhe Pagesave** | **Anila Celiku** |
| | MOBILE | +355 69 222 3375 |
| | FAX | +355 4 228 3337 |
| | EMAIL | Anila.celiku@vodafone.com |



C1 Public

# ANEKSI IX:

# STANDARTET & REKOMANDIMET

## 9.1 Manualet

Manuali CCITT mbi Cilesine e Sherbimit, Manaxhimit dhe Mirembajtjes se Rrjetit, ITU, Gjeneve, 1984.
Manuali CCITT mbi Cilesine e Sherbimit dhe Funksionimin e Rrjetit , ITU, Gjeneve, 1993.

## 9.2 Rekomandimet

E.421 Vezhgimet e cilesise se sherbimeve mbi baza statistikore.
E.422 Vezhgimet mbi telefonatat dalese per cilesine e sherbimit.
E.423 Vezhgimet mbi trafikun e vendosur nga operatoret.
E.424 Testim thirrjesh.
E.425 Vezhgime nderkombetare automatike.
E.428 Mbajtje lidhjeje.
E.430 Cilesia e struktures se sherbimit.
E.431 Vleresim i cilesise se sherbimit per vendosjen e lidhjes dhe kalimin e vonesave.
E.432 Cilesia e lidhjes.
E.433 Integriteti i faturimit.
E.451 Kryerja e nderprerjes se thirrjes Faksimile.
E.452 Reduktime te shpejtesise se modemit Faksimile dhe koha e proçesit te kryerjes.
E.505 Matje te performances se kanaleve te perbashketa te rrjeteve sinjalizuese.
E.525 Projektim rrjetesh per te kontrolluar shkallen/nivelin e sherbimit.
E.550 Shkalla/niveli i sherbimeve dhe kriteri i ri i kryerjes se veprimeve ne raste mospermbushjeje.
E.600 Termat dhe perkufizimet e projektimit te trafikut.



C1 Public

# MARREVESHJA E NIVELIT TE SHERBIMIT

# (SERVICE LEVEL AGREEMENT)

# Mes

# VODAFONE ALBANIA

# DHE

# OPERATORIT PERFITUES



C1 Public

# PERMBAJTJA

1. TE PERGJITHSHME
2. PERKUFIZIME
3. KUADRI LIGJOR
4. INDIKATORET E PERFORMANSES (perfshire ASR)
5. QENDRA E ADMINISTRIMIT TE RRJETIT
6. MATJE DHE TESTE
7. ADMINISTRIMI I DEFEKTEVE
8. PUNIME TE PLANIFIKUARA
**9.** KERKESAT DHE AFATET E DHENIES PER SHERBIMET E TRAFIKUT DHE QARQET E INTERKONEKSIONIT
10. SANKSIONE
11. FORCAT MADHORE

*ANEKSI 1 - KPI TARGETS*
*ANEKSI 2- FORMULAR I RAPORTIMIT TE DEFEKTEVE*
*ANEKSI 3 - PERSONAT PERGJEGJES*



C1 Public

## 1. TE PERGJITHSHME

1.1 Marreveshja e Nivelit te Sherbimit (ketej e tutje *SLA*) nenshkruhet mes Vodafone Albania dhe Operatorit Perfitues dhe i bashkangjitet Marreveshjes se Interkoneksionit te nenshkruar nga keto Pale, si pjese integrale e kesaj te fundit. Per te shmangur cdo dyshim, SLA do te lexohet dhe interpretohet se bashku me Marreveshjen e Interkoneksionit te nenshkruar mes Vodafone Albania dhe Operatorit Perfitues.

1.2 SLA pershkruan rregullat ne lidhje me shfrytezimin dhe mirembajtjen e interkoneksionit mes rrjetit te Vodafone Albania dhe rrjetit te Operatorit Perfitues, analizon proçedurat, kushtet dhe afatet qe duhet te aplikohen nga te dyja Palet per funksionimin e rregullt te interkoneksionit si dhe shkembimin e informacionit te nevojshem per matje, teste dhe administrim defektesh.

1.3 Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues garantojne qe cilesia e sherbimit te ofruar per sherbimet e Interkoneksionit qe pershkruhen ne Aneksin II te Marreveshjes se Interkoneksionit mes paleve do te jete e njejte me cilesine e sherbimit te ofruar abonenteve te tyre dhe ne perputhje me rregulloret e AKEP dhe rekomandimet e ITU-T-se dhe ETSI-se

1.4 Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues garantojne qe cilesia e sherbimit per thirrjet qe terminojne ne rrjetin e tyre, te dorezuara nga Pala tjeter, do te jete e njejte si çfaredolloj trafiku tjeter te krahasueshem dhe te origjinuar nga abonentet e saj, apo trafiku i dorezuar nga ndonje Pale tjeter te interkonektuar.

1.5 Me qellim bashkepunimin sa me te mire per shfrytezimin dhe mirembajtjen e rrjetit, Palet do te vendosin personat pergjegjes te kontaktit per administrimin e Marreveshjes se Interkoneksionit, te cilet jane te percaktuar ne Aneksin IV te SLA.

1.6 Pajisja fundore e telekomunikimit e cila do te lidhet me rrjetin, duhet te perputhet me kushtet e vendosura nga standartet ekzistuese te zbatuara.

## 2. PERKUFIZIME

*“Raporti i defektit”*
Nje defekt i dokumentuar, sipas formatit parashikuar ne Aneksin, ne network apo funksionalitetin, performances, ose disponueshmerine e sherbimeve te rena dakord mes paleve.

*“Shkallezimi”*
Fazat proceduriale qe duhen ndjekur, ne perputhje me tabelen kohore parashikuar ne SLA, ne rast te administrimit te nje defekti. Proçedura e shkallezimit fillon me dergimin e nje faksi apo e-maili qe analizon problemin dhe arsyen pse nuk ka ndodhur nje riparim i pranueshem bashkerisht nga Palet ne afatet kohore te percaktuara nga palet ne kete SLA.

*“NMC”*
Qendra e Administrimit te Rrjetit (Network Management Center)



C1 Public

*"Treguesit e cilesise se sherbimit" (ose Indikatoret e Performances – KPI)*
Jane treguesit e cilesise se sherbimit qe aplikohen per sherbimet e aksesit ne rrjetin e levizshem te komunikimeve publike sipas rregullores se AKEP, pavaresisht teknollogjive te perdorura, te cilet maten nga subjektet qe jane pergjegjes per sigurimin e tyre.

## 3. KUADRI LIGJOR

3.1 Kjo SLA eshte ne perputhje me Ligjin nr 9918 date 19.05.2008 "Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise" (ketej e tutje Ligji 9918) dhe te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga Rregullorja per Treguesit e Cilesise se Sherbimit miratuar me Vendim te AKEP Nr.1256, date 16.04.2010

3.2 Palet gjithashtu kane detyrimin qe te kujdesen qe sherbimet e interkoneksionit te funksionojne ne perputhje me standartet e pranuara, siç percaktohet nga treguesit e Cilesise se Sherbimit te percaktuar ne seksionet 5, 6 dhe 7 te dokumentit te ETSI TR 101 949 V1.1.1 (2002-07) (publikuar ne faqen e AKEP www.akep.al/legjislacioni/standarde).

3.3 Bashkepunimi mes Paleve per qellim te shfrytezimit dhe mirembajtjes te interkoneksionit dhe te te gjitha veprimtarive te ndermarra prej tyre duhet te jete ne perputhje me rekomandimet e pershtatshme te ITU-T-se, te cilat perfshijne, por nuk jane te kufizuara vetem ne to, si me poshte: G.821 (defektet ne performance), G.823 (jitter wander), G.703 (karakteristikat elektrike).

## 4. TREGUESIT E CILESISE (INDIKATORET E PERFORMANCES)

4.1. *Raporti i thirrjeve te deshtuara Q1-M*

- Raporti i thirrjeve te deshtuara percaktohet si raport i thirrjeve te deshtuara me numrin total te tentativave te thirrjeve per nje periudhe te caktuar kohore.

Nje thirrje e deshtuar eshte nje tentative thirrje ne drejtim te nje numri te vlefshem, brenda zones se mbulimit, kur thirresi nuk merr as pergjigjen as tonin e zene dhe as tonin e ziles nga ana e thirrur, brenda 40 sekondave nga momenti kur nga rrjeti eshte marre shifra e fundit e numrit te abonentit qe thirret.

4.2. *Raporti i renies se thirrjeve Q2-M*

- Raporti i renies se thirrjeve eshte Raporti i thirrjeve hyrese dhe dalese te cilat, mbasi jane vendosur ne menyre korrekte, pra iu eshte caktuar nje kanal trafiku, bien ose nderpriten perpara kompletimit te tyre normal nga perdoruesi, per shkaqe brenda rrjetit te operatorit.

4.3. *Koha per vendosjen e thirrjes* **Q3-M**

- Koha per vendosjen e thirrjes eshte periudha kohore qe fillon nga momenti kur eshte marre nga rrjeti informacioni i adreses se kerkuar per vendosjen e thirrjes dhe



C1 Public

mbaron ne momentin kur ana thirrese merr tonin e zene ose tonin e ziles ose sinjalin e pergjigjes nga ana e thirrur. Kur perdoret sinjalizimi i mbivendosur matja fillon nga momenti kur eshte marre informacion i mjaftueshem per adresen qe lejon rrjetin te filloje rrugezimin e thirrjes.

4.4. *Identifikimi i Numrit Thirres (Call line identification – CLI)*

Identifikimi i Numrit Thirres (Call line identification – CLI) eshte identifikimi i numrit te pales thirrese, i cili jepet nepermjet rrjetit origjinues, permes pikes se zbatueshme te interkoneksionit mes Paleve, dhe qe dergohet ne rrjetin terminues.

**4.5** *Numri i Thirrjeve Te Pergjigjura me Sukses (**Answer Seizure Ratio-ASR)***

ASR mat numrin e thirrjeve te pergjigjura me sukses pjestuar me numrin total te thirrjeve te bera (seizure).

ASR = (Seizures resulting in answer signal /Total seizures)*100

Matjet e ASR do te behen per thirrjet hyrese kombetare sipas sherbimeve te ofruara ne Marreveshje dhe te detajuara sipas kerkeses se secilit operator.

Palet do te shkembejne informacion cdo muaj per nivelin e ASR, per thirrjet e terminuara ne rrjetet respektive, duke detajuar ASR per thirrjet e terminuara ne rrjetin respektiv te thirrjeve te percjella nga:

- Per thirrjet hyrese kombetare:
  - Operatoret celulare (apo Secili Operator celuluar ne rast se dhe kur kerkohet)
  - Operatoret fiks (apo secili operator fiks nese dhe kur kerkohet)

Per te realizuar detyrimin e mos-diskriminimit midis sherbimeve te Vodafone te ofruara pajtimtareve dhe operatorit perfitues, Vodafone do te jape edhe ASR e thirrjeve brenda rrjetit. Ne rast se operatori perfitues eshte me status FNT per sherbimet e interkoneksionit, ai duhet te jap Vodafone ASR e thirrjeve brenda rrjetit te vet.

4.6 *Raporti i procedurave te bartjes e numrit me probleme Q8-M*

Eshte raporti i numrit te kerkesave per bartje te numrit qe shoqerohen me nje shmangie nga procedura normale e bartjes, qe aplikohet nga operatore, me numrin total te kerkesave per bartje te numrit

## 5. QENDRA E ADMINISTRIMIT TE RRJETIT(NMC)

### 5.1 Pergjegjesia

5.1.1 NMC-ja e seciles prej Paleve eshte pergjegjese per administrimin e çeshtjeve qe kane lidhje me shfrytezimin dhe mirembajtjen e interkoneksionit, duke monitoruar dhe kontrolluar disponueshmerine dhe cilesine e trafikut drejt interkoneksioneve te zbatueshme. Qendra e Administrimit te Rrjetit te seciles Pale duhet te punoje 24 ore ne 7 dite te javes / 365(6) dite ne vit.

5.1.2 NMC-ja eshte pergjegjese per evidentimin dhe shkallezimin e defekteve ne rrjetin e saj apo ne pikat e zbatueshme te interkoneksionit qe ndikojne ne cilesine e sherbimit qe i ofrohet Pales tjeter. NMC-se se te dyja Paleve i kerkohet qe te bashkepunojne me njera-tjetren.

5.1.3 NMC-ja e seciles prej Paleve ka detyrimin qe te:

- Zgjidhe apo te shkallezoje te gjitha defektet e raportuara ne qendrat e kujdesit te klienteve.
- Siguroje asistence teknike 24 ore ne dite, shtate dite ne jave.
- Koordinoje proçedurat per zgjidhjen dhe riparimin e defekteve ne rrjetet e tyre dhe te mbaje te dhenat e duhura.
- Komunikoje dhe te bashkepunoje me NMC-ne e Pales tjeter per ngjarje te cilat mund te ndikojne ne cilesine e sherbimeve te ofruara te interkoneksionit.
- Sigurimin e nivelit te duhur te cilesise se sherbimit te interkoneksionit, siç percaktohet ne Marreveshjen e Interkoneksionit.

5.1.4 NMC-ja pergjegjese kontakton personat e kontaktit te te dyja Paleve te percaktuara ne Aneksin IV te kesaj Marreveshje.

5.1.5 Riparimi i defekteve do te bazohet ne praktikat e mira te bashkepunimit mes stafit te NMC-se se te dyja Paleve.

5.1.6 NMC-ja e seciles nga Palet eshte e detyruar qe t'i raportoje menjehere NMC-se se Pales tjeter te gjitha problemet e rendesishme qe mund te lindin dhe kane lidhje me interkoneksionin.

5.1.7 NMC-ja e seciles Pale mund te aplikoje proçedurat e kontrollit ne rrjetin e tyre per qellime te zgjidhjes se problemeve qe mund te ndodhin ne rrjetin e Pales tjeter, pasi eshte informuar mbi komunikimin dhe aprovimin e duhur nga NMC-ja e Pales tjeter.

## 6. MATJE DHE TESTE

4.8.4 Testimi i pikave te interkoneksionit duhet te kryhet ne perputhje me matjet dhe kontrollet e bazuara ne standartet nderkombetare (ETSI, ITU-T) dhe specifikimet perkatese te Marreveshjes se Interkoneksionit bazuar ne ORI. Matjet dhe testimet, te aprovuara nga te dyja Palet, do te jene te nevojshme ne menyre qe te monitorohet funksionimi sa me i mire i interkoneksioneve perkatese.

4.8.5 Matjet dhe testimet qe do te zbatohen ne pikat e interkoneksionit kane si qellim qe te sigurojne integritetin e rrjetit, nderveprimin e rrjetit dhe cilesine e duhur te sherbimit.

4.8.6 Matjet dhe testet duhet te kryhen ne rastet e meposhtme:

e. Interkonektimit te pare mes rrjetit te Vodafone Albania dhe rrjetit te Operatorit Perfitues.

f. Instalimi i nje nyje te re komutimi qe ka lidhje me interkoneksionin mes paleve.
g. Rritje e kapacitetit komutues te transmetimit, sinjalizimit dhe STP-ve.
h. Per gjithçka tjeter te rene dakord nga te dyja Palet.

6.4 Proçedura e detajuar e testit dhe kohezgjatja e tij duhet te percaktohet bashkerisht nga Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues dhe duhet te perfshije:

- Matjet dhe testet e nevojshme ne pikat e interkoneksionit,
- Pikat e interkoneksionit ne te cilat duhet te kryhen matjet dhe testet, si edhe afatet kohore,
- Linket e interkoneksionit qe duhet te perdoren,
- Software-t qe duhen perdorur,
- Kohezgjatja e testit dhe iniciatives per matje,
- Numri i testeve qe do te kryhen,
- Seria e testeve te kryera.
- Matja dhe rakordimi i thirrjeve bazuar ky mbi te dhenat e CDR-ve te dy paleve.
- Rakordimi i fushave specifike te CDR-ve te seciles pale qe mbartin te njejtin informacion sic jane (A-party, B-party, kohezgjatje, koha e fillimit te bisedes, koha e perfundimit te bisedes)
- Identifikimi dhe njohja nga secila pale e fushave respektive te CDR-ve qe mbartin informacionin e identifikimit te interkoneksionit sic eshte route name (Emri i linkut)

4.8.8 Matjet dhe testet e kryera do te regjistrohen ne qendrat e komutimit si te Vodafone Albania ashtu edhe te Operatorit Perfitues, ne menyre qe te bashkerendohen te dhenat e te dyja Paleve. Informacioni i duhur duhet t'i komunikohet Pales tjeter brenda 3 (tre) diteve pune pas perfundimit te testit.

4.8.9 Periudha e matjeve dhe kontrolleve nuk duhet te kaloje 5 (pese) dite per çdo pike interkoneksioni, duke e nisur numerimin nga data e perfundimit te instalimeve, deri atehere kur lidhjet perkatese te interkoneksionit te jene te disponueshme per funksionimin prove.

4.8.10 Funksionimi i interkoneksionit do te nise pasi Marreveshja te jete nenshkruar mes Paleve dhe pas perfundimit me sukses te testeve dhe matjeve te interkoneksionit konfirmuar me shkrim respektivisht nga palet, dhe vetem pasi te jete konfirmuar saktesia e matjes se trafikut ne piken e interkoneksionit.

4.8.11 Matjet per treguesit e cilesise se trafikut te behen te ndara per trafikun e thirrjeve hyrëse me origjinë Kombëtare dhe trafikun drejt numrave te portuar.

4.8.12 Matjet per treguesit e cilesise se trafikut per sherbime te tjera qe nuk jane objekt i Marreveshjes se Interkoneksionit sipas ORI, do te rregullohen ne nje Marreveshje te vecante se bashku me ofrimin e sherbimeve perkatese.

# 7. ADMINISTRIMI I DEFEKTEVE

## 7.1 Te pergjithshme

7.1.1 Vodafone Albania dhe Operatori Perfitues marrin persiper qe te bejne te mundur çdo perpjekje ne menyre qe te riparojne ne kohen e duhur çfaredolloj defekti apo gabimi, ne perputhje me dispozitat e kesaj SLA.

7.1.2 Perqindja e defekteve ne lidhjet e dedikuara te interkoneksionit nuk duhet te kaloje standartet nderkombetare, siç percaktohet edhe ne Rekomandimin G.821 te ITU-T-se dhe dispozitat e tjera perkatese te ITU-T-se dhe ETSI-se.

7.1.3 Perqindja e defekteve ne lidhjet e dedikuara te interkoneksionit nuk duhet te kaloje standartet nderkombetare, siç percaktohet edhe ne Rekomandimin G.821 te ITU-T-se dhe dispozitat e tjera perkatese te ITU-T-se dhe ETSI-se.

7.1.4 Pikat e kontaktit te te dyja Paleve jane percaktuar ne Aneksin IV te kesaj Marreveshje.

7.1.5 Te gjitha raportet qe kane lidhje me defektet qe ndikojne ne sigurimin e sherbimeve te interkoneksionit duhet te komunikohen mes NMC-ve te Paleve. Informacioni i dhene duhet te jete i plote dhe qe t'i jape mundesine seciles Pale qe te marre masat e duhura dhe te monitoroje progresin e riparimit te defektit.

## 7.2 **Konstatimi i Defekteve**

7.2.1 Palet bien bashkerisht dakord qe defektet ndahen ne:

- defekte te rrjetit dhe
- defekte te linjave te zbatueshme te interkoneksionit.

Ne perputhje me kete klasifikim, proçedurat per riparimin e defekteve jane te percaktuara, si edhe koha e caktuar qe mund te duhet qe nga konstatimi i defektit deri ne riparimin e tij.

7.2.2 Defektet klasifikohen gjithashtu ne:

- defekte qe ndikojne ne shfrytezimin e sherbimeve te interkoneksionit (te Shkalles 1 dhe 2) dhe
- defekte te cilat nuk ndikojne ne shfrytezimin e sherbimit te interkoneksionit (Shkalla 3).

7.2.3 Ne rast te nje defekti ne rrjet apo tek lidhjet e interkoneksionit, Pala qe has defektin duhet te lajmeroje menjehere NMC-ne e pales tjeter ku e ka origjinen defekti apo ku mund te ndikoje ai.

7.2.4 Nese NMC-ja vendos qe ekziston vertet nje defekt, ajo duhet te informoje NMC-ne e Pales tjeter duke i derguar nje raport me e-mail apo me faks (Raporti i defektit) qe defekti eshte zbuluar. Ne kete rast, NMC-te e te dyja Paleve duhet te bashkepunojne ne menyre qe te percaktojne nese defekti ka ndodhur si rrjedhoje e nje defekti ne rrjetin e tyre apo ne rrjetin e Pales tjeter.



C1 Public

7.2.5 Pergjegjesia per te riparuar defektin i takon Pales ne rrjetin e te ciles ekziston ky defekt, e cila, ne rastin e nje defekti serioz, dhe nese kerkohet nga Pala tjeter, eshte e detyruar te dorezoje nje raport mbi riparimin e defektit brenda kater (4) ditesh pune nga data e zgjidhjes se problemit.

## 7.3 Vleresimi i defekteve

7.3.1 Ne rast se njera nga Palet i komunikon Pales tjeter qe ka nje defekt ne nje nga lidhjet e interkoneksionit, atehere palet duhet te bien dakord dhe te vleresojne bashkerisht nese defekti eshte i Shkalles 1, 2 apo 3, siç pershkruhet me poshte. Ne rast se nuk bihet dakord, shkalla e rendesise se defektit duhet te llogaritet sipas treguesve kryesore KPI, sipas nenit 4 per cilesine e komunikimit, kohes se defektit, dhe palet fillestare qe merren me shkallezimin e defektit duhet te vendosin kategorine te cilit ai i perket.

| Shkalla e Rendesise | Defekt Rrjeti |
|---|---|
| 1 | Humbje totale apo e kufizuar e trafikut (me shume se 50%) nga Vodafone Albania apo nga Operatori Perfitues dhe paaftesi per te percjelle thirrje mes dy rrjeteve. |
| 2 | Humbje e kapacitetit te interkoneksionit ne nje perqindje me te pakte se 50% dhe me te larte se 20%. Perkeqesim i cilesise se sherbimeve te interkoneksionit (ASR-ja, cilesia e komunikimit). |
| 3 | Çfaredo lloj defekti tjeter qe nuk ben pjese ne kategorite 1 dhe 2. |

## 7.4 Afatet kohore per riparimin e defekteve

7.4.1 Afatet kohore per riparimin e defekteve varen ne menyre direkte nga klasifikimi i mesiperm. Nese defekti eshte i Shkalles 1, atehere koha e duhur per riparim e perkohshem te tij nuk duhet te jete me shume se 2 (dy) ore nga momenti i konstatimit te tij dhe dhenies se lajmerimit te duhur (me shkrim, me ane te nje e-maili apo faksi) Pales tjeter, ndersa koha per riparimin perfundimtar nuk duhet te jete me shume se 4 (kater) ore, deri ne momentin kur te jete derguar njoftimi qe defekti eshte riparuar.

7.4.2 Kur defekti i perket Shkalles 2 te Rendesise, atehere riparimi i perkohshem nuk duhet te jete me shume se 4 (kater) ore nga momenti i konstatimit te defektit dhe dhenies se lajmerimit te duhur (Raporti i defektit) me shkrim me ane te nje e-maili apo faksi) Pales tjeter, nderkohe qe riparimi i plote duhet te ndodhe brenda 24 oreve.

7.4.3 Kur defekti eshte i Shkalles 3, riparimi i tij duhet te kryhet brenda 48 oreve.



C1 Public

| Shkalla e Rendesise se Defektit | Koha maksimale e nevojitur per riparimin e defektit nga subjektet pergjegjese te Paleve | | |
|---|---|---|---|
| | Lajmerimi(Raporti i defektit) | Riparimi i Perkohshem | Riparimi Perfundimtar |
| Shkalla 1 | 20 minuta nga konstatimi | 2 ore | 4 ore |
| Shkalla 2 | 30 minuta nga konstatimi | 4 ore | 24 ore |
| Shkalla 3 | Ne te njejten dite nga konstatimi nese ndodh brenda orarit te punes, ose diten tjeter te punes nese ndodh ne diten pararendese por jashte orarit te punes | 24 ore | 48 ore |

## 7.5 Proçedura e Shkallezimit

7.5.1 Proçedura e shkallezimit fillon me dergimin e nje faksi apo e-maili qe analizon problemin dhe arsyen pse nuk ka ndodhur nje riparim i pranueshem bashkerisht nga Palet, siç percaktohet ne piken e mesiperme per afatet kohore. Ne rast se nuk eshte e mundur qe te arrihet nje marreveshje e perbashket mbi nivelin e pare te shkallezimit (informimi), secila nga Palet mund te kaloje ne nivelin tjeter, duke dhene arsyen pse nuk ka mundur te arrihet nje marreveshje e perbashket mbi nivelin e meparshem.

7.5.2 Afatet per shkallezimin e defektit jane si me poshte:

| Shkalla e Rendesise se Defektit | Koha maksimale e nevojitur per shkallezimin e defektit nga subjektet pergjegjese te Paleve | | |
|---|---|---|---|
| | Niveli 1 | Niveli 2 | Niveli 3 |
| Shkalla 1 | 20 minuta | 3 ore | 4 ore |
| Shkalla 2 | 30 minuta | 8 ore | 24 ore |
| Shkalla 3 | Ne te njejten dite nese ndodh brenda orarit te punes ose diten tjeter te punes | 24 ore | 48 ore |

7.5.3 Nivelet e shkallezimit per Vodafone Albania

| | |
|---|---|
| Niveli I | NMC-ja |
| Niveli II | Menaxheri i NMC-se |



C1 Public

| | |
|---|---|
| Niveli III | Menaxheri teknik |

### 7.5.4 Nivelet e shkallezimit per Operatorin Perfitues

| | |
|---|---|
| Niveli I | NMC-ja (personeli i turnit) |
| Niveli II | Menaxheri i NMC-se |
| Niveli III | Menaxheri teknik |

## 8. PUNIME TE PLANIFIKUARA

8.1 Punimet e planifikuara jane ato punime qe kryhen ne rrjetin e njeres prej Paleve, te cilat mund te ndikojne ne interkoneksion apo ne cilesine e sherbimit te interkoneksionit. Keto punime jane si me poshte vijon:

**a.** Pajisja e transmetimit
**b.** Punime urgjente qe nevojiten si rezultat i nje gabimi apo defekti
**c.** Ndryshime ne transmetim, sinjalizimin, software-in apo hardware-in e centralit apo permiresim te software-it per sistemet e administrimit te rrjetit.
**d.** Ndryshime ne rrjetin SDH.
**e.** Aktivizim i serive te reja numerike
**f.** Punime te tjera ne rrjetin e njeres prej Paleve te cilat mund te kene pasoja direkte mbi funksionimin e interkoneksionit.

8.2 Te dyja Palet duhet te planifikojne dhe te kryejne punime te programuara ne rrjetin e tyre, me qellim qe t'i perfundojne ato sa me shpejt qe te jete e mundur dhe te minimizojne problemet ne rrjedhen normale te trafikut dhe sherbimeve te interkoneksionit.

8.3 Secila nga Palet qe ka planifikuar te kryeje punime ne rrjetin e saj, te cilat mund te ndikojne ne rrjedhen normale te trafikut, duhet t'i dergoje nje lajmerim (me shkrim, e-mail apo faks) Pales tjeter 2 (dy) dite pune perpara dates se fillimit te punimeve te planifikuara. Per sa i perket punimeve gjate nates, lajmerimi i mesiperm duhet te kryhet vetem atehere kur kohezgjatja e punimeve eshte me shume se 1 (nje) ore. Lajmerimi i mesiperm duhet te permbaje daten, oren e fillimit dhe zgjatjes se punimeve, llojin e punes, daten dhe oren e perfundimit dhe ndikimin e mundshem mbi funksionimin e interkoneksionit.

8.4 Nese Pala tjeter nuk eshte dakord per punimet e larpermendura, ajo duhet te informoje menjehere Palen tjeter, duke i propozuar ndonje zgjidhje alternative. Ne kete rast, Palet duhet te bien dakord per nje zgjidhje te pranueshme bashkerisht, duke aplikuar proçeduren e shkallezimit te percaktuar ne paragrafin 8.5 te ketij Aneksi.

8.5 Te rast se Palet nuk arrijne nje marreveshje ne lidhje me zbatimin e punimeve, aplikohet proçedura e shkallezimit ne menyre qe te gjendet nje zgjidhje e pranueshme nga te dyja Palet.Afatet per proçeduren e shkallezimit jane si me poshte vijon:

| Niveli I/II/III |
| --- |
| 1 dite pune pas lajmerimit fillestar |

## 9. KERKESAT DHE AFATET E DHENIES PER SHERBIMET E TRAFIKUT DHE QARQET E INTERKONEKSIONIT

Procedurat dhe koha e realizimit lidhur me ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve të përfshira në ORI janë si më poshtë:

1. **Vënia në punë e shërbimit dhe angazhimet:**

| Nr | Proçedura | Koha e realizimit |
| --- | --- | --- |
| **1**. | Operatori Përfitues dërgon një kërkesë me shkrim për Vodafone për aktivizimin e ndonjë prej shërbimeve të përshkruara në ORI dhe marrëveshje duke përfshirë gjithë detajet për kërkesën e tij. | Data e bërjes së kërkesës ____ |
| **2.** | Palët do të diskutojnë dhe të bien dakort për të gjitha çështjet teknike dhe ekonomike duke përfshirë cdo detaj lidhur me pikën e interkoneksionit, rrugëzimin e thirrjeve, dhe parashikimet për shërbimet e interkoneksionit. | Këto diskutime duhet të finalizohen brenda 45 (dyzete e pese) ditëve kalendarike nga data e kerkeses me shkrim sipas pikes 1. Në rast të mos rënies dakord brenda këtij afati, pala pretenduese ka të drejtë të raportojë çështjen në AKEP. |
| **3.** | Në vijim, pas përfundimit të bisedimeve Operatori Përfitues dhe Vodafone nënshkruajnë Marreveshjen e Interkoneksionit / një amendim të marrëveshjes së interkoneksionit | Hyrja në fuqi e amendimit të Marrëveshjes së Interkoneksionit duhet të jetë brenda pesë (5) ditëve kalendarike nga data e nënshkrimit, ose nje date e ndryshme e nga me siper e rene dakord bashkarisht mes paleve |
| **4.** | Vodafone do të implementojë shërbimet e përshkruara në Marrëveshje sipas proçedurave të mëposhtme: | |
| | **a**. Në rastin e ndonjë shërbimi të trafikut ose rrugëzimit të tij që përshkruhet në marrëveshje (përveç vendosjes së qarkut të interkoneksionit) | Implementim brenda dhjetë (10) diteve kalendarike nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes apo Amendimit të përmendura në pikën 3. |
| | **b.** Në rastin e vënies në punë të një qarku të ri dhe/ose shtimit te nje qarku te ri interkoneksioni. | Implementim brenda 3 muajve nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes apo Amendimit të përmendur në pikën 3. |
| | | |
| | | |



C1 Public

## 10. SANKSIONE TE TJERA

10.1 Mosrespektimi i dispozitave te kesaj SLA perben shkelje te saj dhe ORI dhe MI.

10.2 Per cdo shkelje te kesaj SLA do te aplikohen dispozitat e nenit 19 (Zgjidhja e Mosmarreveshjeve) dhe nenit 20 (Shkelja, pezullimi dhe zgjidhja e marreveshjes e interkoneksionit) te ORI dhe MI dhe dispozitat perkatese te Ligjit 9918.

**10.3** Ne rast se njera nga palet shkel detyrimet mbi Identitetin e Numrit Thirres (CLI) duke e ndryshuar ose fshehur ate, ne kundershti me parashikimet e Ligjit 9918 dhe Rregullores per Akses dhe Interkoneksion, pala jo ne shkelje do te aplikoje menjehere te gjithe dispozitat sipas nenit 15 (Identifikimi i Numrit Thirres) dhe Aneksit V (Numeracioni dhe CLI) te Marreveshjes se Interkoneksionit lidhur mes paleve bazuar ne ORI.

## 11. FORCAT MADHORE

11.1 Asnjera nga Palet nuk do te jete pergjegjese per ndonje vonese apo mospermbushje te detyrimeve te saj ne ate mase qe nje vonese apo mospermbushje e tille ka ardhur si rezultat i nje ngjarje te tipit “Force Madhore” (siç percaktohet ketu e ne vijim).

11.2 Per kete arsye “Force madhore” do te kuptohet cdo ngjarje apo ndodhi pertej kontrollit te arsyeshem te paleve, perfshire ketu por pa u kufizuar ne kryengritje ose trazira civile, luftra ose nderhyrje ushtarake, situata te jashtezakonshme ne shkalle kombetare ose lokale, marrje masash ose mungesa e tyre nga Qeveria, ose organe te tjera kompetente, ndonje akt i nxjerre nga Qeveria ose ndonje autoritet tjeter, zbatimi i ligjit, rregulloreve ose urdherat e Qeverise ose ndonje institucioni qeveritar, mosmarreveshje industriale te çfaredo lloji (qofshin ato te lidhura ose jo me Vodafone Albania ose Operatorin Perfitues), zjarret, rrufete, shperthimet, permbytjet, termetet, rreshqitjet e dheut, kushte atmosferike te jashtezakonshme, veprime ose mosveprime te personave per te cilet asnjera nga palet nuk eshte pergjegjes, ose ndonje shkak tjeter i ngjashem apo i ndryshem, jashte kontrollit te tyre te arsyeshem, me kusht qe keto shkaqe ose rrethana te jene klasifikuar si forca madhore.

11.3 Ne rastet e “Forcave Madhore”, Palet pervec njoftimit qe i bejne njera tjetres ne lidhje me cilesine e sherbimit te siguruar, duhet qe ti japin informacion AKEP mbi situaten e regjistruar per “Forcen Madhore”. Informacioni duhet te jete i vlefshem dhe i detajuar per treguesit reale dhe per treguesit ne kushtet e “Forcave Madhore” dhe njekohesisht i shoqeruar nga nje shenim shpjegues per ndryshimet e verejtura.

# ANEKSI I



C1 Public

# KPI TARGETS

| Treguesi | Vlera mesatare mujore | Vlera mesatare ne oren pik |
|---|---|---|
| 1.Raporti thirrjeve te deshtuara (Call Failure Rate) ne %. | 2 | 5 |
| 2.Raporti i renies se thirrjeve (Call Drop Rate) ne %. | 2 | 4 |
| 3.Koha per vendosjen e thirrjes (ne sekonda) (Call Setup Time in sec.) | 7 | 7.5 |
| 4.Identifikimi i Suksesshem i Numrit Thirres per thirrjet hyrese kombetare (Successful Call line identification for national incoming calls – CLI) ne %. | 100% | 100% |



C1 Public

# ANEKSI II
# FORMULAR I RAPORTIMIT TE DEFEKTEVE

| | |
|---|---|
| **Emri i Operatorit/Personi i kontaktit** | |
| **Sherbime te ndikuara** | Sherbimi i ofruar – Emri/Lloji i sistemit |
| **Koha (e fillimit dhe perfundimit)** | Koha kur u zbulua defekti dhe koha kur perfundoi riparimi i defektit |
| **Impakti** | Pershkrimi i impaktit ne biznes (p.sh cilet abonente ndikohen etj.) dhe pershkrimi teknik i çeshtjes |
| **Veprime te ndermara/Shkaku i defektit** | Cili ishte shkaku i defektit dhe si u zgjidh |
| **Statusi** | I pazgjidhur / I zgjidhur |



C1 Public

# ANEKSI III
# PERSONAT PERGJEGJES

| OPERATORI PERFITUES | PERSONAT E KONTAKTIT | VODAFONE ALBANIA |
|---|---|---|
| | | |
| | **Per ceshtjet e vendosjes se interkoneksionit (set-up)** | **Nikoleta Dervishi** |
| | MOBILE | +355 69 222 3467 |
| | FAX | +355 4 228 3593 |
| | EMAIL | Nikoleta.dervishi@vodafone.com |
| | | |
| | **Per ceshtjet e Shfrytezimit dhe Mirembajtjes** | **NMC** |
| | TEL | +355 4 228 3501 / 04 |
| | FAX | +355 4 228 3509 |
| | EMAIL | Tirana.mtx@vodafone.com |
| | | |
| | **Per ceshtjet e administrimit te defekteve** | **NMC** |
| | **Niveli I** | |
| | TEL | +355 4 228 3501 / 04 |
| | FAX | +355 4 228 3509 |
| | EMAIL | Tirana.mtx@vodafone.com |
| | | |
| | **Niveli II** | **Denisa Qordja** |
| | MOBILE | +355 69 222 3590 |
| | FAX | +355 4 228 3509 |
| | EMAIL | Denisa.qordja@vodafone.com |
| | | |
| | **Niveli III** | **Heraldo Menekshi** |
| | MOBILE | +355 69 222 3312 |
| | FAX | +355 4 228 3509 |
| | EMAIL | Heraldo.menekshi@vodafone.com |



C1 Public